

1 E martë, 28 maj 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes  
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare, paraqisni lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar  
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
14 Mirëmëngjesi të gjithëve.

15 Vërejt se të akuzuarit janë të pranishëm në sallën e  
16 Gjyqit sot, me përjashtim të z. Krasniqi, i cili merr pjesë në  
17 seancën e sotme përmes videolidhjes.

18 Tani do të fillojmë të marrim dëshminë e dëshmitarit të  
19 Prokurorisë W02144.

20 Znj. Sekretare, ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

21 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,  
23 z. Dëshmitar.

24 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

1 Asistente do t'ju japë tani tekstin e betimit solemn, i cili  
2 ju kërkohet që të bëni në pajtim me rregullin 141 të  
3 rregullave tona.

4 Ju lutem lexojeni me zë të lartë.

5 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e  
6 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj  
7 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe  
8 vetëm të vërtetën dhe se nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për  
9 të cilën kam dijeni.

10 DËSHMITARI: JAN KICKERT

11 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthyesit]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
13 Mund të uleni.

14 Dëshmitar, sot do të fillojmë marrjen e dëshmisë suaj që  
15 pritet të zgjasë rreth tetë orë e gjysmë. Siç e dini,  
16 Prokuroria do t'ju bëjë pyetje së pari. Pastaj Mbrojtja do të  
17 ketë mundësi të bëjë pyetje, po ashtu edhe anëtarë të Trupit  
18 Gjykues, mund të kenë pyetje.

19 Vlerësimi paraprak i Prokurorisë për marrjen tuaj në  
20 pyetje është një orë. Mbrojtja ka nevojë për shtatë orë e  
21 gjysmë, megjithatë, urojmë dhe shpresojmë që edhe avokatët dhe  
22 Prokurori të përdorin kohën në mënyrë të arsyeshme dhe Trupi  
23 Gjykues mund të lexojë -- mund të lejojë marrjen në pyetje pas  
24 marrjes së -- nga ana e Prokurorisë, në qoftë se plotësohen  
25 kushtet.

1 Dëshmitar, përpiguni t'iu përgjigjeni pyetjeve me  
2 përgjigje të shkurtra. Në qoftë se nuk e kupton një pyetje --  
3 nuk -- ndonjë pyetje, kërko që ajo të përsëritet. Gjithashtu,  
4 ju lutem theksoni bazën mbi të cilën mbështeteni për të folur  
5 për faktet apo ngjarjet që të cilat -- për të cilat ju bëhen  
6 pyetje. Nëse Prokuroria ju pyet të vërtetoni korrigjimet që  
7 të janë bërë gjatë leximit të deklaratave, ju kujtohet të  
8 konfirmoni në procesverbal se këto deklarata me shkrim, siç  
9 janë korrigjuar në listën e korrigjimeve, janë pasqyrimi i  
10 saktë i deklaratave tuaja.

11 Gjithashtu, flisni afër mikrofonit, dhe lejoni -- leni  
12 pesë sekonda hapësirë, me qëllim që përkthyesit të kenë  
13 mundësi të përkthejnë.

14 Gjatë dëshmisë suaj në Gjykatë, nuk keni të drejtë të  
15 diskutoni përmbajtjen e dëshmisë suaj në sallë të gjyqit me  
16 askënd. Nëse dikush jashtë sallës së gjyqit ju bën pyetje  
17 lidhur me dëshminë tuaj, na tregoni neve. Nëse ju kërkoj të -  
18 - në qoftë se ju kërkoj të ndërprisni fjalën tuaj, duhet të  
19 ndërprisni sepse kjo do të thotë që kam udhëzime për t'ju  
20 dhënë.

21 Nëse keni nevojë të merrni ndonjë pushim, na thoni, dhe  
22 ne do jua bëjmë të mundur.

23 Tani e dini se si funksion oraret e punës tonë. Do jemi  
24 këtu deri në orën 10.00. Pastaj do marrim një pushim të  
25 shkurtër rreth pesëmbëdhjetë minuta. Në vijim vazhdojmë deri

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 4

1 në orën 11.00, kur do bëjmë pushimin e mëngjesit, gjysmë ore.  
2 Pastaj një orë e gjysmë pushim -- pushimi i drekës, dhe do  
3 përfundojmë në orën 16.30 pasdite.

4 Fillimisht do të fillojmë me Prokurorinë, që janë të ulur  
5 në anën tuaj të majtë.

6 Fjalën e keni ju, z. Prokuror.

7 Z. CAPIN: [Përkthim] Faleminderit.

8 Pyetje nga z. Capin:

9 Z. CAPIN: [Përkthim]

10 PY. Mirëmëngjesi, të nderuar Gjykatës. Mirëmëngjesi,  
11 Dëshmitar. Unë quhem John Capin, dhe do ju parashtroj disa  
12 pyetje sot në emër të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Ju  
13 lutem, si e keni emrin?

14 PË. Quhem Jan Kickert.

15 PY. Datëlindja dhe vendlindja, ju lutem.

16 PË. Lindur më 19 shtator në -- kombësia austriak. Puna -  
17 profesioni -- i punësuar nga ministria e Punëve të -- e  
18 Çështjeve Evropiane dhe Ndërkombëtare të Austrisë, si  
19 diplomat.

20 PY. I keni dhënë deklaratë në janar të vitit 2020 ZPS-së?

21 PË. Po.

22 Z. CAPIN: [Përkthim] Do të doja t'i kërkoja z. Sekretare  
23 të shfaqim në ekran dokumentin 075993, 076009, që në anglisht,  
24 bashkë me versionin në shqip.

25 PY. E njihni këtë dokument në ekran, që shihni tani, sidomos

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 5

1 në anglisht?

2 PË. Po.

3 PY. A është kjo faqja e parë e deklaratës që i keni dhënë

4 ZPS-së në janar të vitit 2020?

5 PË. Po.

6 Z. CAPIN: [Përkthim] Znj. Sekretare, në qoftë se mund të  
7 kalojmë në pjesën e fundit të dokumentit që është 076009, dhe  
8 t'i tregojmë dëshmitarit pjesën e nënshkrimit.

9 PY. A e keni nënshkruar këtë në datë që është shënuar aty?

10 PË. Po.

11 PY. A e keni pasur mundësinë ta rishikoni dokumentin përpara  
12 se ta nënshkruani?

13 PË. Po, e kam bërë këtë. Janë bërë edhe disa ndryshime, por  
14 edhe pas këtyre ndryshimeve kam gjetur disa gabime të vogla.

15 PY. A keni dhënë dëshmi më parë në - përpara TNPJ-së në  
16 çështjen kundër Fatmir Limaj dhe të tjerëve?

17 PË. Po.

18 Z. CAPIN: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund të shfaqim në  
19 ekran dokumentin IT-0 vizë -- IT-03-66 T34 [Sipas përkthimit]  
20 deri në T66 [Sipas përkthimit] dhe krye -- në veçanti pjesën e  
21 transkriptimit ku tregohet fillimi i dëshmisë së dëshmitarit,  
22 në faqen 657.

23 PY. Zotëri, a mund ta -- kërkoj ndjesë. A mund të konfirmoni  
24 që dokumenti që shfaqet tani në ekran përpara jush --

25 Z. CAPIN: [Përkthim] -- ndoshta, znj. Sekretare duhet të

1 shkojmë në fund të faqes.

2 PY. A është kjo faqja e parë e dëshmisë suaj në çështjen  
3 kundër Limajt në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-  
4 Jugosllavinë?

5 PË. Po.

6 Z. CAPIN: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund të shfaqim në  
7 ekran dokumentin me numër IT-03-66 T667 deri në T767. Nëse  
8 mund të shkojmë pak më poshtë të shohim, mund të jetë faqja  
9 vijuese. Mund të kalojmë në faqen vijuese? Kjo është.

10 PY. A është ky vazhdimi i dëshmisë suaj në të njëjtën çështje  
11 që përmenda më herët?

12 PË. Po.

13 PY. A u është dhënë mundësia të rishikoni të dyja deklaratat  
14 që keni dhënë, atë që keni dhënë përpara ZPS-së dhe këtë që  
15 pamë, dëshminë që keni dhënë në çështjen Limaj, para një muaji  
16 ky rishikim?

17 PË. Po, më është mundësuar të shoh transkriptimin që nuk kam  
18 pasur mundësi të shoh pasi kam dhënë këtë deklaratën e  
19 dëshmitarit.

20 PY. Ju kujtohet që jemi takuar bashkë me mua dhe me një koleg  
21 timin përpara rreth tetë-dhjetë ditësh?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe kur jemi takuar ju është dhënë mundësia që t'i bëni  
24 sqarime dhe korri -- të bëni korrigjime deklaratave të  
25 ndryshëm të cilat do të -- që shikuar sot në mëngjes?

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 7

1 PË. Po, më është dhënë kjo mundësi.

2 PY. A e keni dhënë ju sqarime dhe, apo bërë ndryshime?

3 PË. Po, kam bërë, kam dhënë disa sqarime.

4 PY. Dhe ju kujtohet që këto ishin shë -- janë shënuar në një  
5 shënim përgatitor që ua kam lexuar juve pastaj?

6 PË. Po, më është lexuar dhe e kam nënshkruar atë, apo  
7 rishikuar në një -- këtë kuptim.

8 Z. CAPIN: [Përkthim] Të nderuar, Shënimi përgatitor  
9 pasqyron këto ndryshime dhe mban numrin ERN 121141 [Sipas  
10 përkthimit] deri në 121128, i redaktuar.

11 PY. Përveç korrigjimeve që keni bërë në deklaratat tuaja të  
12 mëparshme, a janë informacionet që keni dhënë në ato deklarata  
13 të sakta dhe të vërteta, për aq sa keni dijeni dhe besoni?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe përveç ndryshim -- këtyre korrigjimeve, informacionet  
16 në atë deklaratë, a reflektojnë, pasqyrojnë saktësisht atë që  
17 ju do të thoshit në Gjykatë për aq sa keni dijeni?

18 PË. Po.

19 Z. CAPIN: [Përkthim] Z. Gjykatës, ZPS-ja parashtrohet për  
20 praninë dy deklaratat e mëparshme të dëshmitarit dhe 15  
21 dëshmitë e asociuara me atë, të lidhura me të. Numrin relevant  
22 i ERN-së, të cilat janë në emailin -- i kemi shënuar në  
23 emailin tonë të datës 22 maj të vitit 2024, dhe Shtojcën 1 të  
24 Shënimit Përgatitor 1. Do t'i përsëris për procesverbal. Janë  
25 121121, 121128 e Rishikuar.

1 Vërej, të nderuar Gjykatës se dëshmitë e lidhura me të,  
2 të renditura në numrin 10 janë pranuar tashmë si P00836. Dhe  
3 për më tepër vërej se dëshmia e lidhur numër 1 është versioni  
4 shqip që mban ERN-në P00480.0 dhe parashtrojmë edhe Shënimin  
5 Përgatitor për pranim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
7 kundërshtim?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Me përjashtim të kundërshtimeve të  
9 shprehura sipas rregullës 154 më herët, nuk kemi kundërshtime.  
10 Dua të konstatojmë, për nevoja të procesverbalit, se -- dhe  
11 Sekretaren e Gjykatës se bëhet fjalë për Shënimin Përgatitor  
12 të redaktuar 1, dhe jo Shënimin Përgatitor origjinal.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra është me  
14 RED. Është e saktë?

15 Z. CAPIN: [Përkthim] Është RED, pra e Rishikuar.  
16 Faleminderit. Harrova të përmend RED. Faleminderit për  
17 korrigjimin.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
19 atëherë dokumenti 075993 deri në 076009 në anglisht dhe shqip  
20 pranohet. IT-03-66 T634 deri në T636 që fillon me 6 -- në  
21 faqen 657 pranohet.

22 IT-03-66 -- 67 dhe deri në T767 pranohet.

23 Shënimi me ERN 121121 deri në 121128 RED, pra i  
24 Rishikuar, pranohet.

25 Përveç numrit dhjetë që është, pra tashmë pranuar më parë



1 dhe dëshmitë e lidhura me të, në interes të përshpejtimit të  
2 procedurës, znj. Sekretare do t'i dërgojë listën e dëshmi -- e  
3 numrave që u caktohen dëshmime për të gjitha këto dokumente.  
4 Faleminderit.

5 Z. CAPIN: [Përkthim] Përmes diskutimeve, komunikimeve mes  
6 palëve, jemi pajtuar se dëshmia e këtij dëshmitari të --  
7 deklaratat e këtij dëshmitari, sipas rregullës 154, të  
8 pranohen me datën 32 maj [Sipas përkthimit], pra kemi biseduar  
9 me Mbrojtjen dhe Mbrojtësin e Viktimave. Me leje të Gjykatës  
10 dua të lexoj një përmbledhje tani.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
12 vazhdoni.

13 Z. CAPIN: [Përkthim] Nga fundi i vitit 1997 deri në mars  
14 të vitit 1999 Jan Kickert ka punuar në Beograd si diplomat  
15 austriak.

16 Në fillim të -- në vitin 1998 ka udhëtuar në Kosovë në  
17 raste të caktuara, për t'u takuar me udhëheqësit e partive  
18 ndërkombëtare dhe të tjerë. Udhëtimet e z. Kickert në Kosovë  
19 janë bërë më të shpeshta në pjesën e dytë të vitit 1998, pasi  
20 ai ishte udhëzuar që të krijojë një pikë kontakti me  
21 udhëheqjen e UÇK-së për t'i angazhuar ata në procesin politik.  
22 Me këtë qëllim, për të arritur këtë qëllim, ai ka marrë pjesë  
23 në disa takime me anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm,  
24 përfshirë Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe  
25 Rexhep Selimin.

1 Në korrik të vitit 1998 Kickert u takua me Hashim Thaçin,  
2 Kadri Veselin, pastaj ndarazi me Jakup Krasniqin.

3 Në janar të vitit 1999 Kickert mori pjesë për të  
4 negociuar lirimin në një mbledhje, takim për të negociuar  
5 mbledhjen -- lirimin e ushtarëve serbë.

6 Kickert ishte vëzhgues gjatë negociatave gjatë dhe pas  
7 dhe gjatë konferencës së paqes në Rambuje, duke ndërvepruar me  
8 udhëheqjen e UÇK-së, përfshirë Hashim Thaçin. Në mars të vitit  
9 1999 Kickert mori pjesë në një takim për të diskutuar  
10 marrëveshjen e Rambujesë me udhëheqësit e UÇK-së, përfshirë  
11 Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin.

12 Nga mesi i vitit 1999 dhe deri në fund të atij viti, në  
13 cilësinë e tij si këshilltari politik i UNMIK-ut, Kickert  
14 përpiloi raportin ku përshkruante gjendjen në Kosovë,  
15 udhëheqjen e UÇK-së dhe gjendjen në -- situatën e pakicave.

16 Kjo ishte përmbledhja.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
18 vazhdojmë.

19 Z. CAPIN: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
20 PY. Z. Kickert, në deklaratat tuaja të ZPS-së, paragrafi 29  
21 keni deklaruar se në vitin 1998 dhe në 1999 ju ka kontaktuar  
22 juve përmes një telefoni satelit. Ju kujtohet kjo?

23 PË. Kam supozuar që ai më kontaktonte me telefon satelit. Ai  
24 më thirr -- thirr me telefonin tim celular dhe kam menduar që  
25 po përdorte një telefon satelit sepse telefonat celularë në

1 atë kohë në Kosovë nuk funksionojnë në të gjithë territorin.

2 PY. A jeni në gjendje të na thoni nëse e keni parë ju

3 telefonin nga -- që ishte telefon satelitor, pra?

4 PË. Jo.

5 PY. A jeni në dijeni ju që pjesëtarë të UÇK-së gjatë kohës --

6 gjatë kohës që ju keni qenë në Kosovë, përdornin telefon

7 satelit -- satelitor?

8 PË. Ne e kemi përdorur satelit -- telefon satelitor vetë si

9 diplomatë. Ka qenë gjithashtu një masë sigurie që ne merrnim

10 sepse telefonat celularë normalë nuk funksionin mirë. Ishte

11 një shembull, për shembull, kur kemi qenë në Kleçkë dhe kam

12 përdorur telefon celular -- jo telefon celular normal por

13 telefon satelitor, për të treguar që jam në rregull. Dhe

14 pastaj ushtari i UÇK-së më pyetni në -- më kërkoi nëse mund ta

15 përdorte dhe ja dhashë atij dhe i dhashë lejen që ta përdorte.

16 PY. Dhe kur e përdori atë, a patë që ai kishte ndonjë

17 vështirësi teknike për të përdorur telefonin satelitor.

18 PË. Nuk është kaq e vështirë, është e thjeshtë. Në momentin

19 që ai është i ndezur dhe i bërë gati, është si telefon celular

20 normal. Telefon --

21 PY. Nuk është telefon celular normal. Është tamam telefon

22 celular normal apo ka ndonjë dallim mes përdorimit të

23 telefonit satelitor dhe telefonit celular normal?

24 PË. Për të bërë -- përgjigje -- për të bërë një thirrje

25 telefonike, është një telefon normal. Dallimi i vetëm është që

1 duhet të bëhet gati që të lidhet me satelitin, me qëllim që të  
2 bëhet, të vendoset lidhja.

3 PY. Në rregull. Në deklaratat tuaja të mëparshme, përfshirë  
4 deklaratat dhënë ZPS-së, z. Kickert, keni përshkruar një takim  
5 me z. Jakup Krasniqi me 30 korrik të vitit 1999 në Kleçkë.  
6 Tani do t'ju kërkoj që të shikoni këtë dokument, të cilin e  
7 keni rishikuar kur jemi ritakuar kohëve të fundit.

8 Z. CAPIN: [Përkthim] Dhe [e pakuptueshme] Znj. Sekretare  
9 e Gjykatës, mund të shfaqni në ekran dokumentin me numër  
10 U01758743 [Sipas përkthimit], U115-ën [Sipas përkthimit] -  
11 8935.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Ndërsa po shfaqim këtë dokument,  
13 mendoj që është viti 1998, jo 1999.

14 Z. CAPIN: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Më korrigjoi Avokati i Mbrojtjes, z. Kickert, që takimi  
16 për të cilin po flasim është në fakt 30 korrik i vitit 1998, e  
17 thashë gabimisht. A është e saktë?

18 PË. E saktë. Faleminderit për korrigjimin.

19 Z. CAPIN: [Përkthim] Znj. Sekretare e Gjykatës, në qoftë  
20 se mund të kalojmë te faqja 8842, dhe në qoftë se është e  
21 mundur pastaj edhe te 8843, edhe pse mund të jetë zhvilluar në  
22 dy segmente. Në qoftë se mund të kthehemi dy faqe më parë. Kjo  
23 është.

24 PY. A ju kujtohet që keni lexuar një pjesë në dokumentin që  
25 është përpara jush kur jemi takuar përpara dhjetë ditësh? Tani

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 13

1 po ua -- e kam fjalën për pjesën ku lexon "Ofensiva e armikut  
2 dhe faktori ndërkombëtar" trajton ngjarjet në korrik të vitit  
3 1998 dhe shohim emrin tuaj në rreshtin 7 bashkë me David - e  
4 shihni këtë pjesë?

5 PË. Po e shoh, por nuk më keni dhënë faqen e parë të librit  
6 nga vjen ky tekst. Tani e kuptoj se për cilin libër bëhet  
7 fjalë.

8 PY. Pra, kur jemi takuar, ju kam treguar këtë paragraf, ua  
9 kam vënë përpara jush, dhe paragrafin e faqes në vijim. A  
10 është e saktë, ua kam treguar këtë gjë, dhe ju në fakt keni  
11 lexuar këtë paragraf, duke filluar nga rreshti i shtatë, ku  
12 thotë:

13 "Me qëllim që të arrihet kjo, David Slinn dhe Jan Kickert  
14 udhëtuan në Kosovë më 31 korrik 1998."

15 E lexoni -- e keni lexuar këtë deri në fund këtë  
16 paragraf, dhe në faqen në vijim?

17 Z. CAPIN: [Përkthim] Znj. Sekretare, në qoftë se mund ta  
18 orientojmë pak dëshmitarin, që të kalojmë te faqja -- te 843  
19 [Sipas përkthimit].

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Besoj që e shoh.

21 Z. CAPIN: [Përkthim]

22 PY. E keni lexuar atë që është shkruar në krye të faqes? E  
23 lexon -- e lexuat?

24 PË. Po, e lexova.

25 PY. Ky pasazh a është pasqyrim i saktë i takimit që keni

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 14

1 mbajtur me z. Jakup -- me z. Krasniqi me 30 korrik të vitit  
2 1998?

3 PË. Po, pak a shumë. Pothuajse. Por mendoj që kam -- dallimi  
4 është në raportin tim -- me raportin është aty kisha shënuar  
5 kushtet për t'u angazhuar. Janë shkruar në libër pak ndryshe  
6 nga ajo që kam shkruan në raportin tim.

7 PY. Po flisnit për -- pyetje -- po flisni për tre kushtet e  
8 përcaktuara në fillim -- pra në faqen paraprake që përfundojnë  
9 me "heqjen e të gjitha pikave të kontrollit apo të  
10 postblloqeve, tërheqjen e policisë dhe të forcave të  
11 armatosura dhe se bisedimet duhet të mbahen në vend neutral,  
12 në vend neutral". Është e saktë?

13 PË. E saktë.

14 Z. CAPIN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ZPS-ja  
15 parashton për pranim si provë U0115-8411 [Sipas përkthimit]  
16 deri në U015 -- përpara 9035, si provë publike, dëshmi  
17 publike.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë  
19 kundërshtim?

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime për këto dy  
21 faqe. E kuptoj që vetëm këto po dorëzohen, po paraqiten për --  
22 si dëshmi për momentin.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kështu është.

24 Z. CAPIN: [Përkthim] Kështu - konfirmojmë këtë gjë.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 15

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'ka  
2 kundërshtime të tjera. U015-8743 deri në U015-8935, faqet 8842  
3 deri në 8843 pranohen. Ju lutem znj. Sekretare, caktoni një  
4 numër dëshmie.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të marrë numrin  
6 e dëshmisë P12277 [Sipas përkthimit] dhe klasifikohet si  
7 publike.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.  
9 Capin.

10 Z. CAPIN: [Përkthim]  
11 PY. Z. Kickert, në deklaratën tuaj dhënë ZPS-së përshkruani  
12 një seri takimesh, një sërë takimesh që janë mbajtur në korrik  
13 të vitit 1998 me Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Jakup  
14 Krasniqin dhe të tjerët. Cili ishte qëllimi i organizimit të  
15 këtyre takimeve?

16 PË. Qëllimi jonë ishte të identifikonim një person në UÇK që  
17 do të ishte në gjendje të përfshihej në procesin politik dhe  
18 të fliste me autoritet në emër të UÇK-së.

19 PY. Ishte pjesë e qëllimit tuaj mbledhja e informacionit mbi  
20 strukturën ushtarake të UÇK-së?

21 PË. Jo.

22 PY. A kishit ju ndonjë ekspertizë në çështjet ushtarake në  
23 atë kohë?

24 PË. Nuk kam pasur asnjë, kurrë.

25 PY. Përpara mbajtjes së marrë -- së -- në takimin e parë --

1 marrjes pjesë në takimin e parë në korrik të vitit 1998, çfarë  
2 informacioni kishit ju lidhur me strukturën e UÇK-së, në qoftë  
3 se kishit ndonjë informacion?

4 PË. Ne nuk dinim asgjë për UÇK-në. Në atë kohë kuptuam se  
5 duhej të angazhoheshim me atë për të arritur në një  
6 marrëveshje, zgjidhje politike dhe morëm informacion, u  
7 përpoqëm të merrnim informacion, gjë që ishte -- atë  
8 informacion që ishte e mundur të merrnim dhe kishim burim  
9 informacioni me gazetarët, apo informacione publike në media,  
10 dhe pastaj natyrisht me Sekretarin e Përgjithshëm mori --  
11 Sekretari i Përgjithshëm mori vendim që ne duhet të hynim në  
12 kontakt të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e UÇK-së.

13 PY. Burimi i informacionit që përshkruat, pjesëtarët e  
14 mediave dhe të tjerë, nga i merrni ata këto informacione, nëse  
15 e dini ju, lidhur me UÇK-në?

16 PË. Ata kanë shkuar në terren edhe vetë aty. Kishte artikuj  
17 lidhur me UÇK-në në gazetatat shqiptare të Kosovës, dhe pastaj  
18 më vonë edhe intervista. Por për mua ishte interesante që të  
19 flisja me ta jo në formë zyrtare, për të marrë pak më shumë  
20 edhe përshtypjet e tyre. Pra --

21 PY. Pyetja ishte, a kishit ndonjë informacion se në çfarë --  
22 në informacione konkrete bazohej ndjenja e tyre?

23 PË. Jo detyrimisht. Kishte shumë fjalë që thuheshin,  
24 shkëmbime që bëheshin, dhe sa më shumë që dëgjohej e njëjta  
25 gjë, më shumë edhe e besonim.



Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 17

1 PY. Tani do të kaloj në janar të vitit 1999, ose në  
2 deklaratën tuaj dhënë ZPS-së në paragrafët 53-54, ju diskutoni  
3 përfshirjen në përpjekjet në atë -- gjatë atij muaji, për të  
4 siguruar lirimin e ushtarëve serbë që ishin marrur të burgosur  
5 nga UÇK-ja dhe ju deklaroni që keni negociuar me Jakup  
6 Krasniqin dhe pjesëtarë të tjerë të Shtabit të UÇK-së dhe doja  
7 që t'ju tregoja një dokument tjetër që e keni rishikuar kur  
8 jemi takuar për herë të parë.

9 Z. CAPIN: [Përkthim] Znj. Sekretare, nëse mund të shfaqim  
10 në ekran P09 -- P9091 ET [Sipas përkthimit] dhe do kalojmë në  
11 faqen -- numri i faqes përfundon me 10 - 1063, ju lutem.

12 PY. Do të doja të përqendroheshit në faqen pra që ju shikoni  
13 në ekran, për nevoja të procesverbal është 00231063. Fillojmë  
14 poshtë numrit 26, në pjesën e siç -- në mesin e sipërm të  
15 faqes. Ju kujtohet që e keni parë këtë paragraf, apo këtë  
16 pjesë të kësaj faqeje? Do të doja të përqendroheshit  
17 konkretisht te fjalia që fillon me:

18 "Në fillim të takimit, pjesa ndërkombëtare ishin  
19 ambasadori amerikan...", etj.

20 PË. Po, më kujtohet kjo pjesë.

21 PY. Tani do t'ju pyes nëse keni nevojë ta lexoni atë përsëri  
22 vetë. Pjesa tjetër e faqes përfundon me paragrafin vijues, dhe  
23 lexon:

24 "Vendet që përfaqësoheshin."

25 PË. Po.

1 PY. A është ky një përshkrim i takimit ku keni marrë pjesë  
2 edhe ju?

3 PË. Po. Kam marrë pjesë edhe unë por nuk kam negociuar.  
4 Domethënë, kam qenë i pranishëm po ambasadori Hill dhe  
5 Petritsch janë ata që biseduan.

6 PY. Data ka qenë 11 janar i vitit 1999?

7 PË. Po.

8 PY. Krahas Ambasadorit Hill, a ka pasur -- dhe Petritsch, a  
9 ka pasur ambasadorë, diplomatë të tjerë të pranishëm?

10 PË. Po. Tina Kaidanow, ajo ka qenë krahu i djathë i  
11 Ambasadorit Hill.

12 PY. Teksti që kemi përballë, a është një përshkrim i saktë i  
13 takimit?

14 PË. Po.

15 PY. Takimi a zgjati disa orë?

16 PË. Po, ka qenë një takim i gjatë.

17 PY. A ju kujtohet, për çfarë arsyeje zgjati kaq shumë ky  
18 takim?

19 PË. Sepse mendoj që nuk po merrnin dot vendimin menjëherë.

20 PY. A pati ndërprerje gjatë takimit?

21 PË. Po.

22 PY. Për çfarë arsyeje?

23 PË. Për t'u konsultuar mbase.

24 PY. Me kë do bëheshin konsultimet në atë takim?

25 PË. Përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës. Në atë takim

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 19

1 konsultoheshin me të tjerët. nuk ishte e pazakontë diçka e  
2 tillë. Gjatë gjithë angazhimeve që kemi pasur me UÇK-në, nuk  
3 mund të themi që ka pasur që mund të merrte vendimin vetëm. Ne  
4 kishim përshtypje që vendimmarrja ishte kolektive.

5 PY. Gjatë këtyre shkëputjeve për konsultime, ju dhe  
6 Ambasadori Petritsch, a u konsultuat me ndokënd? A kontaktuat  
7 ju ndonjë person?

8 PË. Ka të ngjarë të jemi -- të kemi kontaktuar Misionin  
9 Verifikues, sepse zëvendësi, zëvendësi Dominique Keller i  
10 këtij misioni, ishte pika e kontaktit me palën serbe.

11 Z. CAPIN: [Përkthim] Ju lutem kam nevojë për një çast të  
12 konsultohem.

13 I lutem Sekretares së Gjykatës që të nxjerrë në ekran  
14 materialin me ZPS SPOE00224991-SPOE00224991.

15 PY. Dëshmitar, e njihni ju këtë fotografi?

16 PË. Ma ke treguar para dhjetë ditësh.

17 PY. I njihni personat?

18 PË. Po.

19 PY. Kështu? njihni prej tyre?

20 PË. Xhavit Halitin, Skënder Hysenin, Ibrahim Rugovën, Ramë  
21 Bujën, Brem [Sipas përkthimit] Shalën, Veton Surroin, Feikm  
22 [Sipas përkthimit] Agani -- Fehmi Agani, më falni. Është  
23 dikush tjetër nga opozita këtu, dhe krejt në të majtë është  
24 Jakup Krasniqi, Hidet Hyseni -- Hydajet Hyseni.

25 PY. Mund t'i thoni Trupit Gjykses ku është Ibrahim Rugova?

1 PË. Është personi të cilin -- të cilit i është gërvishtur  
2 fotografia.

3 PY. Pra personi që i është gërvishtur fotografia.

4 PË. Po.

5 Z. CAPIN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja kërkon  
6 që të pranohet dokumenti me numër 00224991, pra që është  
7 dokumenti që kemi përballë.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] E kundërshtojmë. E kundërshtojmë për  
9 shkak se nuk ka relevancë dhe nuk ka asnjë vlerë provuese.  
10 Sipas nesh, ky nuk është një dokument që shërben për të  
11 identifikuar anëtarët e delegacionit të Rambujesë sepse Trupi  
12 Gjykses ka shumë materiale në lidhje me Rambujenë. Por kjo  
13 është paragjykses si dokument sepse është gërvishtur  
14 fotografia e Ibrahim Rugovës, kjo është e vërtetë, por  
15 Prokuroria nuk është në gjendje ta thotë kush e ka gërvishtur  
16 fotografinë e tij, kur është gërvishtur fotografia e tij, dhe  
17 jam i bindur që Prokurori do të thotë që ky është një dokument  
18 që është gjetur gjatë bastisjes së shtëpisë së z. Krasniqi,  
19 por nuk ka asnjë provë që të vërtetohet se si ka përfunduar  
20 kjo fotografi në shtëpinë e z. Krasniqi. Në këto rrethana  
21 mendojmë që relevanca është shumë e vogël dhe ka një efekt  
22 paragjykses nëse pranohet kjo fotografi pa u vërtetuar se kush  
23 e ka bërë këtë dëmtim të fotografisë dhe në ç'kushte është  
24 gjendur kjo fotografi në shtëpinë e z. Krasniqi.

25 Megjithatë ne mendojmë që efekti cenues apo paragjykses

1 që ka fotografi -- kjo fotografi është tepër i dëmshëm edhe ka  
2 -- nuk ka asnjë vlerë provuese.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni  
4 kundërshtime? Në rregull, përmbushen kriteret e rregullës 138  
5 *prima facie*, sa i takon rëndësisë. Është e vërtetë që nuk ka  
6 asnjë deklaratë apo as ndonjë provë se kush e ka bërë dëmtimin  
7 e fotografisë, por ne do ta marrim kështu siç është dhe ja  
8 japim ne peshën e duhur kur të vijë momenti.

9 Z. CAPIN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne kemi  
10 sugjeruar që prova materiale me numër P1227 të shtohet ose të  
11 bashkëlidhet me një provë materiale që tashmë është e pranuar  
12 në provat gjyqësore, që është konkretisht prova me numër  
13 P00189, në vend të që t'i jepni një numër të ri.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, kjo  
15 fotografi do të marrë një numër të ri dhe do ta pranojmë me  
16 numër më vete.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull, materiali  
18 me numër SPOE00224991 deri në SPPOE00224991 do të pranohet me  
19 numrin P01228. Klasifikimi aktual është konfidencial.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
21 Mettraux ka diçka për të thënë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam nevojë për një sqarim.  
23 Ju do të mbështeteni në faktin që kjo fotografi është e  
24 gërvishtur? Dhe nëse po, këtë mendoni që këtë gërvishtje e ka  
25 bërë ndonjë person që ka lidhje në këtë çështje gjyqësore?

1 Z. CAPIN: [Përkthim] Me sa kam unë dijeni, kjo është  
2 marrë nga një album fotografik, siç e tha edhe Mbrojtja, që  
3 është marrë nga shtëpia e Jakup Krasniqit. Është një prej  
4 shumë fotografive, por asnjë nga fotografitë e tjera nuk është  
5 e gërvishtur dhe nuk është e dëmtuar, siç kjo fotografi. Ne  
6 mendojmë që kjo fotografi është dëmtuar sepse reflekton  
7 ndjesinë që ka pasur ky i akuzuar kundrejt këtij personi,  
8 armiqësinë apo --

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju po thoni që këtë  
10 gërvishtje, dëmtim të fyt -- të fotografisë e ka bërë z.  
11 Krasniqi?

12 Z. CAPIN: [Përkthim] Po.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Pikërisht për këtë po flisja unë dhe  
14 ky është efekti paragjykses. Mbi ç' baza mund ta thotë  
15 Prokuroria këtë? Nuk ka asnjë provë. Nuk ka asnjë provë për ta  
16 vërtetuar që e ka bërë z. Krasniqi.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Ellis, në qoftë se nuk  
18 ka asnjë provë, ju e dini përgjigjen.

19 Z. CAPIN: [Përkthim] Ju lutem, shohim materialin  
20 P0061427-8. Është video. Do lutesha të shihnim dy minutat e  
21 para, deri te sekonda e tetë.

22 Të nderuar Gjykatës, jam në dijeni të kohës, të orës, dhe  
23 do ju them që përveç kësaj videos, do shohim edhe një 30-  
24 sekondësh tjetër, dhe me aq do të përfundoj me videot.

25 PY. Ndërkohë që presim të shfaqet videoja në ekran, z.

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 23

1 Kickert, keni përshkruar një takim të datës 5 mars të vitit  
2 1999 në deklaratën për ZPS-në ku keni negociuar -- më falni,  
3 më falni, ku jeni takuar me disa persona, pas konferencës së  
4 Rambujesë dhe para hapit të radhës së këtij procesi. Ju  
5 kujtohet?

6 PË. Po.

7 PY. Do shohim një video, ua thashë këtë për kontekst se pse  
8 po e shohim këtë video. Nuk na nevojitet me zë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk mund  
10 të -- nuk mund ta shohim me zë, sepse kjo është një video  
11 konfidenciale dhe ne aktualisht jemi në seancë publike, çka do  
12 të thotë se publiku mund ta përcjellë videon.

13 [Luhet videoincizimi]

14 Z. CAPIN: [Përkthim]

15 PY. Vetëm u lutem, i nderuar Gjykatës, [Sipas përkthimit]  
16 kushtoni rëndësi kush po hyn në dhomën aty sepse do t'ju pyes  
17 për pjesëmarrësit kur të përfundojë video.

18 Z. CAPIN: [Përkthim] Për procesverbal, të nderuar  
19 Gjykatës, kjo është pranuar në prova gjyqësore, pra kjo video  
20 është pranuar te prova gjyqësore, me numrin P01221.

21 Ndalojmë këtu ju lutem.

22 PY. Në të në -- në të majtë të ekranit shihni një person që  
23 është me shpinë.

24 PË. Në të majtë?

25 PY. Po në të majtë -- në të majtë nga -- në drejtim të

1 akrepave të orës. Kush është ulur pranë tij?

2 PË. Axel Dittmann, diplomat gjerman. Vijojejmë jam unë.

3 Ambasadori Petritsch, ambasador Pauls.

4 PY. Domethënë, Dittmann është personi të cilin -- Axel

5 Dittmann është personi të cilin nuk e shohim fytyrën. Për

6 proces pra. Në minutën 1 e 48 sekonda është Axel Dittmann.

7 PË. Po.

8 Z. CAPIN: [Përkthim] Vazhdojmë edhe pak këtë video.

9 [Luhet videoincizimi]

10 PY. Kemi ndaluar tani në minutën e dytë të sekondat të tetë

11 [Sipas përkthimit]. A mund të na thoni në të djathtë të

12 ambasadorit Pauls, kështu? Shihni tjetër në këtë fotografi?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni

14 çaktivizuar]

15 Z. CAPIN: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

16 PY. Filloje me ambasadorin Pauls. A është personi që i shohim

17 -- që duket më pak në ekran dhe shohim profilin nga e djathta.

18 Fillojmë në drejtim të akrepave të orës në këtë fotografi, a

19 mund të na thoni kë po shohim?

20 PË. Sylejman Selimin, Jakup Krasniqin, Ramë Bujën, Fatmir

21 Limaj, Rexhep Selimin, dhe Baton Haxhiun që është gazetar.

22 Z. CAPIN: [Përkthim] I lutem tani Sekretares së Gjykatës

23 të nxjerrë edhe titrat e kësaj videoje, që kanë në fakt një

24 numër të provës materiale Prokuroria -- ju kërkoj ndjesë --

25 061427-08-TR-ET.



Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 25

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
2 ngadalësoni sepse nuk po ju ndjekin dot përkthyesit.

3 Z. CAPIN: [Përkthim] Kërkoj falje. Pra është prova  
4 materiale 061427-08-TR-ET. Ka të njëjtin numër të provës  
5 materiale siç ka edhe videoja. Konkretisht me numër P01221-ET.  
6 PY. Dëshmitar, e shihni transkriptimin në -- e shihni  
7 transkriptimin në ekran? A e pe edhe një herë këtë  
8 transkriptim kur u takuam bashkë nja dhjetë ditësh?

9 Tani i lutem Sekretares së Gjykatës që të vendosë në  
10 ekran materialin me numër SPOE00128571 deri në SPOE0012948-ET.  
11 Edhe shqipja fillon me të njëjtin numër dhe përfundon me 12894  
12 -- 954. Ju lutem të shkojmë te faqja që përfundon me numër  
13 8805.

14 PY. Dëshmitar, e njihni dokumentin që keni përballë?

15 PË. Besoj se ma keni treguar, por nuk e di i cilit libër  
16 është.

17 PY. Po, është e vërtetë që ua kam treguar. Kam filluar me  
18 këtë faqe ku thotë "Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-  
19 së -- anëtarët e UÇK-së janë takuar me diplomatët". A ua kam  
20 treguar këtë?

21 PË. Po.

22 PY. A ju lexova këtë faqe dhe faqet në vijim?

23 PË. Po.

24 Z. CAPIN: [Përkthim] A mund t'i kërkoj Sekretares të  
25 gjejë atë -- të shohim të gjitha faqet --

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 26

1 PY. -- sa të familjarizoheni dhe na thoni kur është nevoja të  
2 ndalojë, dhe të na thoni nëse është kjo ajo që kemi lexuar kur  
3 jemi takuar së bashku.

4 Z. CAPIN: [Përkthim] Sekretares së Gjykatës, të ndalojmë,  
5 te faqja që përfundon me 8809. Pra, edhe një faqe tjetër. I  
6 lutem Sekretares të na tregojë fundin e faqes. Shohim edhe  
7 faqen tjetër.

8 Për procesverbal, dua të them që pamë faqet SPOE00128805  
9 deri në SPOE00128809.

10 PY. Z. Kickert, a i keni parë edhe ju këto faqe kur jemi  
11 takuar së bashku?

12 PË. Po.

13 PY. Ky tekst i librit, pra kjo pjesë e librit, a përshkruan  
14 siç duhet takimin e 5 marsit të vitit 1999, që e pamë edhe në  
15 videon me numër P01221?

16 PË. Pasi pashë transkriptimin e takimit mund të them që është  
17 një përshkrim i saktë.

18 Z. CAPIN: [Përkthim] I lutem Sekretares së seancës që në  
19 të njëjtin dokument të shohim faqen SPOE00128885. A mund të  
20 shkojmë në fund të faqes?

21 PY. A i shihni dy fotografitë në fund të faqes që përfundon  
22 me numër 8885?

23 PË. Po.

24 PY. Këto dy fotografi, a përshkruajnë të njëjtët anëtarë që  
25 kanë qenë në takimin -- më falni në momente të atakimit të 5

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Page 27

1 marsit të vitit 1999?

2 PË. Po.

3 PY. Po teksti, diçitura poshtë fotografive, a e ka të saktë  
4 datën dhe vendin e takimit?

5 PË. Besoj se po. Nuk e mbaj mend datën saktësisht më se s'më  
6 -- s'e kam parë më raportin që kur e kam shkruar për këtë  
7 takim, por besoj se është data 5 marsi -- 5 mars.

8 Z. CAPIN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja kërkon  
9 që pranohen faqet sapo -- që sapo i evidentoi dëshmitari, që  
10 janë me numër SPOE00128805 deri në 8809 dhe 8885 dhe do  
11 kërkonim që të bashkëngjiteshin dokumentit që është pjesë e  
12 provave gjyqësore, dhe që kanë numrin P1149. Është thjesht një  
13 pjesë tjetër e të njëjtit libër me këtë numër të provës  
14 materiale.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
16 kundërshtime?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam ndonjë kundërshtim, por më  
19 duket se po shohim të njëjtin transkriptim. Nuk na duket sikur  
20 është ndonjë përshkrim i ndarë. Është e njëjta gjë që pamë  
21 edhe në transkriptim. Nuk mendoj që ka ndonjë vlerë të shtuar  
22 pranimi i këtij dokumenti, meqë transkriptimi përmbante të  
23 njëjtën gjë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni gjë për  
25 të thënë, z. Capin.

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 28

1 Z. CAPIN: [Përkthim] Dëshmitari sapo konfirmoi se kjo  
2 pjesë e librit përshkruan në mënyrë të saktë se çfarë --  
3 kronologjinë e atij takimi, pra. Thjeshtë kjo shërben për të  
4 vërtetuar që ajo që përmban libri është e saktë. Për këtë duam  
5 që të shtojmë edhe këtë pjesë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni gjë  
7 tjetër për të thënë?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Do t'i kundërpërgjigjem. Është i  
9 saktë vetëm për këto faqe të librit, por për faqet e tjera të  
10 librit, është diçka që duhet ta shohim më tej.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
12 Materiali me numër SPOE00128571 në faqet 8805, 8809 pranohen.

13 Sepse përmbush kriteret e rregullës 138.

14 Z. CAPIN: [Përkthim] Përmenda edhe dokumentin me numër  
15 SPOE00128885. Është faqja e fundit. Është konkretisht faqja që  
16 kemi në ekran.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
18 çaktivizuar]

19 Është faji im sepse e thashë numrin gabim. Është  
20 SPOE00128885.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqet me numër  
22 SPOE00128805 deri në SPOE0011 -- 128809 dhe faqja SPOE00128885  
23 do t'i bashkëngjiten provës materiale me numër P01149, dhe ka  
24 klasifikimin publik.

25 Z. CAPIN: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës të

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 29

1 nxjerrë edhe një herë videon në ekran. Është me numër 061427-  
2 08. Edhe një herë nuk na nevojitet audioja. Të lutem të  
3 shihnim nga sekonda e 38 -- më fal ta shihni për 38 sekonda.

4 [Luhet videoincizimi]

5 Z. CAPIN: [Përkthim] Ju lutem vazhdoni pak më përpara, të  
6 shkojmë te sekonda e 38, nga sekonda e 38 vazhdoni dhe do ju  
7 them unë kur të ndaloni.

8 PY. Dëshmitar, teksa shohim videon, do ju lutesha t'i  
9 kushtonit rëndësi ose të shihni me vëmendje bllokun e  
10 shënimeve ku po shkruan z. Selimi.

11 Z. CAPIN: [Përkthim] Ndalojmë këtu. I lutem edhe një herë  
12 Sekretares së seancës të shkojmë edhe një herë te minuta e 47  
13 në sekondën e 28, 47:28. Edhe dy sekonda më mbrapa ju lutem,  
14 te sekonda e 28.

15 Ju lutem edhe një sekondë, edhe një sekondë. Pak, pak  
16 fare më përpara.

17 PY. Dëshmitar, e shihni bllokun e shënimeve që ka përpara z.  
18 Selimi?

19 PË. Si gjithë të tjerët.

20 PY. A ka disa unaza metalike blloku i shënimeve? A mund t'i  
21 numëroni sa janë?

22 PË. Gjashtë --

23 PY. Ka gjashtë por janë të ndara tre e tre?

24 PË. Po.

25 Z. CAPIN: [Përkthim] I lutem Sekretares së seancës që të

1 nxjerrë në ekran materialin me numër P00182, vetëm në gjuhën  
2 shqipe. Do shohim vetëm faqen e parë.

3 PY. Z. Kickert, faqja që kemi përpara a ka të njëjtin -- ka  
4 të njëjtin konfigurim siç kishte blloku i shënimeve që kishte  
5 z. Selimi përpara, në të cilin po merrte shënime?

6 PË. Edhe mundet, por këtu ka një datë tjetër.

7 PY. E lemë datën mënjanë se do ju lexoj -- do ju tregoj edhe  
8 përkthimin në anglisht. Po ju pyes a është i njëjti bllok, a  
9 duket sikur është i njëjti bllok?

10 PË. Unë s'e di -- më falni që po ju them, por pse duhet unë  
11 si dëshmitar të përgjigjem për këtë?

12 PY. Në rregull. vazhdojmë.

13 Z. CAPIN: [Përkthim] Shohim të njëjtën provë materiale në  
14 anglisht. Është me numër P00182, dhe do lutesha të shohim  
15 datën në fjalë. Ju lutem të shohim faqen që përfundon në fund  
16 fare, domethënë, me 6420.

17 PY. Z. Kickert, ditën kur u takuam unë ju pyetja që pasi të  
18 shikonit -- rishikonit transkriptimin e 5 marsit të vitit  
19 1999, të shihnit edhe disa nga shënimet dhe të bënim disa --  
20 dhe përkthimin disa -- përkthimin, më falni, të disa  
21 shënimeve, dhe të bënim disa krahasimeve.

22 PË. Po, ma keni treguar këtë.

23 PY. Dhe a e keni bërë këtë për disa shënime të ndryshme?

24 PË. Po. Besoj se po.

25 PY. Nuk dua që ta përsërisim në fakt, por për Trupin Gjykses

1 -- që t'ia demonstrojmë Trupit Gjykues, doja që të bënim të  
2 njëjtin krahasim.

3 Ju lutem të shikoni faqen që keni përpara ku thuhet që  
4 "Ambasadori gjerman Pauls" fillon këtu dhe pastaj janë gjashtë  
5 rreshta të përkthyer poshtë. Do ju lesoj këtë pjesë të  
6 transkriptimit.

7 Z. CAPIN: [Përkthim] Fillojmë, për procesverbal, dua të  
8 them që është prova materiale P001221 de do të filloj në faqen  
9 --

10 PY. Do fillojmë në faqen 4 të transkriptimit dhe do lexoj  
11 rreshtat 3 deri në 5. Vazhdon:

12 "Z. Christian Pauls, unë jam një diplomat aktualisht dhe  
13 kam ardhur këtu, kam qenë në njësitin -- ish kapiteni i  
14 njësitit gjerman dhe kam ardhur këtu t'u përgjigjem."

15 "Tani do të doja të bëja një konstatim këtu për  
16 Rambouillet. Pata ndjesinë se pala shqiptare nuk e ka kuptuar  
17 çdo të thotë të kesh dy mijë -- 28 mijë trupa të NATO-s në  
18 vendin tënd. Kjo është garancia më e madhe e mundshme që mund  
19 të jepet, sepse vendet perëndimore nuk i sjellim aq kollaj  
20 trupat e tyre ..."

21 Z. CAPIN: [Përkthim] Vazhdojmë --

22 PY. Ju kërkoj ndjesë, se po shikoja faqen e pestë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Capin,  
24 duhet të ngadalësoni patjetër. Është e pamundur t'ju ndjekim.

25 Z. CAPIN: [Përkthim] Për hir të përkthyesve, po rifilloj

1 në rreshtin 22.  
2 PY. "Kjo është garancia më e madhe e mundshme që mund t'ju  
3 japim ne, sa u takon që të respektojmë marrëveshjet që kemi.  
4 Vendet perëndimore nuk i angazhojnë aq lehtë trupat e tyre.  
5 mendojmë se këtu ishte e domosdoshme ta bënim siç bëmë edhe me  
6 Bosnjën. Dhe këto trupa do të qëndrojnë për sa kohë të jetë e  
7 nevojshme, njësoj si edhe në Bosnjë. Askush nuk po thotë që  
8 jemi këtu vetëm për 3 vjet. Si të jetë situata, mund të rrimë  
9 edhe më gjatë."

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë  
11 pushimin -- duhet të bëjmë pushimin.

12 Dëshmitar, do të bëjmë dhjetë minuta pushim. Do kthehemi  
13 rreth orës 10 pa -- 10.10.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 --- Seanca ndërpritet në orën 09.58

16 --- Seanca rifillon në orën 10.11

17 ZNJ. CAPIN: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 Z. CAPIN: [Përkthim] Po përpigësja që t'i shpjegoja  
20 Gjykatës numrat e provave materiale nuk ja arrita që të  
21 shprehesha siç duhet. Prova materiale që ka marrë numrin  
22 P001227 është një pjesë e një libri i cili quhet "Kthesa e  
23 Madhe", "Pika e Madhe e Kthesës". Ndërkohë një pjesë tjetër që  
24 është pranuar në prova materiale është ajo që ka marrë numrin  
25 P00189. Kështu thjesht për ta bërë më të qartë mendova që do



Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 33

1 të ishte më mirë t'ja u sqaroja edhe një herë pjesën e numrit  
2 të provave materiale në mënyrë të tillë që të mund të  
3 vazhdojmë pastaj kur futet dëshmitari në sallë me pyetjet e  
4 radhës.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. A  
6 mund t'i kombinoni këto të dyja, znj. Sekretare?

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.  
8 Faqet me numër ERN-je U015-8743 deri në U015-8842 dhe 8843 do  
9 të shtohen në provën ekzistuese P00189. Ndërkohë që sa i takon  
10 numrit P01227 ky numër tani është i lirë dhe do i caktohet një  
11 provë materiale më vonë gjatë procesit.

12 Z. CAPIN: [Përkthim] Faleminderit.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
15 Dëshmitar, do të vazhdojmë më tej që ka Prokurori për ju.

16 Prokuror, mund të vazhdoni.

17 Z. CAPIN: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem a mund të  
18 paraqisni në ekran dokumentin SPOE00203094 deri në  
19 SPOE00203096.

20 PY. Ndërkohë që Sekretarja paraqet këtë në ekran z. Kickert,  
21 në deklaratën që i keni dhënë ZPS-së në paragrafin 16 keni  
22 thënë që jeni kyçur në Misionin e Kombeve të Bashkuara në  
23 Kosovë, UNMIK, në mes të verës të vitit 1999. A është e saktë  
24 kjo, Dëshmitar?

25 PË. Po.

1 PY. Në çfarë muaji keni filluar punën?

2 PË. Mendoj që ka qenë nga fillimi i gushtit.

3 PY. Çfarë pozicioni keni pasur në UNMIK?

4 PË. Kam qenë këshilltar diplomatik i shefit të UNMIK-ut dhe  
5 përfaqësuesit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm Bernard  
6 Kouchner.

7 PY. A e keni përshkruar vendin tuaj në deklaratën si  
8 këshilltar politik?

9 PË. Po.

10 PY. A ka një dallim në terminologjinë që keni përdorur?

11 PË. Për çfarë terminologjie e keni fjalën?

12 PY. E kam fjalën si diplomat, apo jo?

13 PË. Jo, është këshilltar politik.

14 PY. Në deklaratën që i keni dhënë ZPS-së në paragrafin 61  
15 deri në paragrafin 66 keni përshkruar disa memorandume të  
16 UNMIK-ut që janë hartuar dhe janë kopjuar. A mund të na thoni  
17 se çfarë pozicioni ka pasur Dittman në UNMIK.

18 PË. Po.

19 PY. Çfarë pune ka pasur ai? Mund të na thoni pak ju lutem se  
20 çfarë detyre ka pasur Dittman?

21 PË. Ka qenë këshilltar politik dhe ka qenë pjesë e Kombeve të  
22 Bashkuara, e ekipit të Kombeve të Bashkuara që kanë krijuar  
23 UNMIK-un.

24 PË. Ndoshta ma keni thënë edhe më përpara, por në çfarë muaji  
25 është bërë ai pjesë e UNMIK-ut?

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 35

1 PË. Mendoj që ka qenë nga gushti.

2 PY. Z. Dittman ka punuar në atë kohë atje, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Sapo ndërhyjnë përkthyesit dhe më thanë që të flisja pak  
5 më ngadalë dhe do të mundohem ta respektoj këtë gjë.

6 Atëherë ju thatë -- keni thënë në deklaratën e ZPS-së se  
7 si këshilltar politik i UNMIK-ut detyrat kryesore tuajat kanë  
8 qenë hartimi i memorandumeve dhe i teksteve.

9 PË. Po. Memorandumet kam hartuar por gjithashtu edhe kablllo  
10 informative. Nuk është se kam hartuar ato për sa i takon Nju  
11 Jorkut apo shtabeve tona, por unë ja u dërgoja ato UNMIK-ut  
12 dhe pastaj nga UNMIK-u dërgoheshin ata në shtabe ose në selitë  
13 kryesore tonat.

14 PY. Kur thua "memorandume" a do të thotë kjo që edhe vetë ju,  
15 edhe z. Dittman në disa raste keni shkruar kablllograme të  
16 tilla?

17 PË. Po. Kemi pasur edhe një këshilltar tjetër të tretë  
18 diplomatik që në të njëjtën kohë merrej me të njëjtën natyrë  
19 pune me të cilën jemi marrë edhe ne.

20 Z. CAPIN: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares tani të  
21 paraqesë në ekran dokumentin SPOE00203094 deri në  
22 SPOE00203096.

23 PY. A e kujtoni ta keni parë këtë dokument?

24 PË. Po.

25 PY. A ju kujtohet që e keni parë kur jemi takuar bashkë?

1 PË. Po.

2 PY. A është ky një kabllogram standard i UNMIK-ut në verë të  
3 1999?

4 PË. Po.

5 PY. I kujt -- kujt i është drejtuar ky kabllogram dhe çfarë  
6 teme kryesore ka pasur ky kabllogram? Dhe mund të na thoni po  
7 ashtu se çfarë roli kanë luajtur individët të cilët jepen tek  
8 rreshti i parë aty?

9 PË. Në rregull. Së pari, më lejoni të sqaroj diçka. Në këtë  
10 kohë kur është shkruar ky kabllogram unë nuk kam qenë duke  
11 punuar për UNMIK-un megjithatë kam qenë në cilësinë dypalëshe  
12 në Zyrën Austriake në Prishtinë. Ky është një kabllogram  
13 standard i Kombeve të Bashkuara. I është drejtuar Miyet, që  
14 është shefi i DPKO-së që është Departamenti për Paqeruajtjen,  
15 për Operacionet Paqeruajtëse që është një njësia në  
16 Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork ku raportonte  
17 UNMIK-u. Po ashtu ky dokument i është kopjuar edhe z. Riza, që  
18 ka qenë shefi i kabinetit i Sekretarit të Përgjithshëm Kofi  
19 Annan. Dhe ndërkohë Prendergast ishte shefi i Nënsekretarit të  
20 Përgjithshëm për çështjet politike. Është dërguar në emër të  
21 shefit të përkohshëm të UNMIK-ut Sergio Viera de Mello. Po  
22 ashtu domethënë njoh edhe personin që e ka nënshkruar, e njeh  
23 vetë personalisht këtë person, që është Fabrizioo Hochschild.  
24 Edhe këtë e kam njohur personalisht.

25 Z. CAPIN: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 37

1 te faqja tjetër e këtij dokumenti që është SPOE00203095. Do ju  
2 kërkoja, Dëshmitar, që të përqendrohemi në fillim fare të  
3 kësaj faqeje që keni përpara në ekran.

4 PY. Pyetja që kam për juve, Dëshmitar, është kjo: A e keni  
5 lexuar kohët e fundit këtë dokument? Domethënë, do të doja të  
6 lexonit këtu tek titulli "Takim me Hashim Thaçin më 13  
7 korrik"?

8 PË. Po, ma keni treguar rreth dhjetë ditë më përpara.

9 PY. Në rregull. Tani do të lexoj një pjesë të faqes që keni  
10 përpara.

11 "Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm  
12 (SRDG) e njoftoi e Thaçin se KFOR-i kishte liruar disa serbë  
13 dhe romë që mbaheshin në një shtëpi pranë Prishtinës. Është  
14 fakt shumë shqetësues që disa anëtarë të UÇK-së të  
15 identifikuar qartë nga dokumentet e tyre të KFOR-it kanë  
16 mbërritur tek shtëpia pak më vonë. Ai i kërkoi fuqimisht  
17 Thaçit që të përdorë gjithë ndikimin e tij për të shpërbërë të  
18 gjitha qendrat e ndalimit të UÇK-së. Thaçi premtoi se do të  
19 bëjë sa mundet dhe do të nxjerrë një deklaratë zyrtare."

20 A e lexova saktë këtë, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 Z. CAPIN: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, ne kërkojmë që ky  
23 dokument të pranohet si provë gjyqësore. Dokumenti për  
24 identifikim për Sekretarinë është ERN SPOE00203094 deri  
25 SPOE00203096.

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë private)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 38

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë  
2 kundërshtim?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Kemi një kundërshtim sepse  
4 dëshmitari nuk di asgjë lidhur me këtë takim apo për  
5 përmbajtjen e këtij dokumenti. Dhe kam edhe diçka tjetër që do  
6 të doja ta shtjelloja në seancë private.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretarja,  
8 na kaloni në seancë private,

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë private)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 39

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
15 jemi në seancë publike.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta  
17 përsëris edhe një herë atë çfarë thashë në seancë private. Do  
18 ti caktojmë një numër provizor prove materiale.

19 Z. CAPIN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të bëj të  
20 njëjtën ushtrim ose do të kërkoj të njëjtin informacion nga  
21 dëshmitari. Por, lidhur me një tjetër kabllogram.

22 Znj. Sekretare, do të jap numrin e referencës së  
23 dokumentit që duhet të paraqitet në ekran.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më lejoni  
25 vetëm një çast. Jemi në seancë publike.



Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 41

1 Tani mund të vazhdoni, Prokurori.

2 Z. CAPIN: [Përkthim] Sekretare, a mund të paraqisni në  
3 ekran dokumentin SPOE00246088 deri në 2226093 [Sipas  
4 përkthimit].

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres,  
6 z. Gjykatës. Megjithatë, me çfarë shikoni nga transkripti nuk  
7 bëhet shënimi -- prova materiale që sapo trajtoi Prokurori ka  
8 marrë një numër provizor të provës gjyqësore.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
10 dokument me ERN SPOE00203094 deri në 00203096 dhe përkthimi në  
11 shqip i këtij dokumenti do të marrin numrin provizor të provës  
12 materiale P01227. Klasifikimi është konfidencial.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

14 Z. CAPIN: [Përkthim]

15 PY. Z. Kickert, a e shikoni dokumentin që keni përpara?

16 PË. Po.

17 PY. A e keni parë këtë dokument kur jemi takuar bashkë  
18 përpara dhjetë ditësh?

19 PË. Po, ma treguat ju.

20 PY. A është një kabllogram standard i UNMIK-ut që e keni --  
21 një lloj kabllogrami që kemi parë zakonisht gjatë verës 1999?

22 PË. Po.

23 PY. Çfarë teme ka ose çfarë qëllimi ka ky kabllogram?

24 PË. Mund t'ja u lexoj. Ajo çfarë shkruhet këtu është "Takimi  
25 i parë i Këshillit Provizor të Kosovës më 16 qershor 1996

1 [Sipas përkthimit]".

2 Z. CAPIN: [Përkthim] Ju lutem shkoni te faqja tjetër,  
3 znj. Sekretare.

4 PY. A e shikoni në faqen e parë, z. Kickert që është ky  
5 shënimi këtu "Këshilli i Parë Tranzitor i Kosovës në takimin e  
6 vet me datë 16 korrik". Kush janë përfaqësuesit e UÇK-së në  
7 këtë takim sipas këtij dokumenti?

8 PË. Mund t'jua lexoj:

9 "Janë Hashim Thaçi, Xhavit Haliti, nga UÇK-ja".

10 Z. CAPIN: [Përkthim] A mund të kalojmë te faqja tjetër.  
11 Atëherë doja që t'i kërkoja Sekretares në faqen që përfundon  
12 me 6090. I takon një faqe më poshtë sesa faqja që kemi përpara  
13 në ekran. Këtu, ju lutem. A mund të kalojmë pak më poshtë në  
14 faqe?

15 Ju kërkoj ndjesë, i nderuar Gjykatës, se e çorientova  
16 Sekretaren sa i takon vendit ku duhet të përqendrohet në faqe.  
17 Kështu që do i kërkoja edhe një herë që të kalojë më sipër në  
18 faqe. Ju lutem kaloni në fillimin e faqes pararendëse. Faqes  
19 tjetër, më falni.

20 PY. A e shikoni paragrafin që keni këtu përpara z. Kickert.

21 "Pjesa kryesore e anëtarëve ..."

22 PË. Po.

23 PY. A lexon si më poshtë ky paragraf:

24 "Pjesa dërmuese e anëtarëve kanë bërë deklaratë parimore.  
25 Artemije theksoi pjesa më e madhe e krimeve dhe akteve të

1 dhunës janë kryer kundër serbëve dhe personave të tjetër jo  
2 shqiptarë. Ai i bëri thirrje UÇK-së dhe në veçanti i bëri  
3 thirrje Thaçit që të tërhiqeshin dhe t'i jepnin fund kësaj  
4 gjëje. Thaçi u përgjigj se ata kishin bërë deklaratë shumë të  
5 forta për t'u distancuar nga krime kundër joshqiptarëve.”

6 A shkruan kështu, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 Z. CAPIN: [Përkthim] ZPS-ja kërkon pranimin si provë  
9 gjyqësore të të njëjtit dokument mbi të njëjtat argumente që  
10 unë dhashë edhe më herët lidhur me dokumentin e mëparshëm.  
11 Pra, kemi vërtetuar që ky është një dokument autentik dhe  
12 është po ashtu relevant sipas parashtrimeve të Prokurorisë.  
13 Kështu do të kërkonim që të pranohej si provë gjyqësore.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë dokument konkret nuk kemi  
15 kundërshtim. Edhe unë gjatë kundërpyetjeve do të mbështetëm  
16 tek e njëjta pjesë, tek i njëjti dokument.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 Dokumenti SPOE00246088 deri në 0026093 pranohet në prova  
19 materiale. Ju lutem caktojini një numër prove, Sekretare.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me  
21 ERN SPOE00246088 deri në 00246093 pranohet si provë dhe merr  
22 numrin P01229. Do të klasifikohet si material konfidenciale.

23 Z. CAPIN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi pyetje  
24 të tjera nga Prokuroria.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të kërkoj që ky dokument të

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 44

1 jetë konfidencial?

2 Z. CAPIN: [Përkthim] Besoj që do të jetë më mirë që ta  
3 trajtojmë si konfidencial. Do të jetë më e sigurt kështu.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë do të kërkoja që të ishte  
5 dokument publik sepse nuk është se ka absolutisht asnjë  
6 informacion konfidencial. Kështu që nuk e kuptoj se pse  
7 kërkohet që të klasifikohet si konfidencial.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë  
9 informacion konfidencial këtu?

10 Z. CAPIN: [Përkthim] Më lejoni kohë deri në pushimin a  
11 kafes që të konfirmoj në qoftë se mund ta klasifikojmë si  
12 publik apo jo.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
14 Do të presim deri atëherë. Domethënë në qoftë se nuk ka  
15 kufizime që janë vënë nga ofruesi i dokumentit, atëherë i  
16 takon që duhet që të klasifikohet si publik.

17 Z. CAPIN: [Përkthim] Do t'ju kthejmë një përgjigje pas  
18 pushimit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
20 vazhdon z. Misetic.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

22 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

23 Z. MISETIC: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, mirëmëngjes. Unë jam avokati i Hashim Thaçit.

25 Jam Luka Misetic dhe kam disa pyetje sot për ty paradite dhe

1 pasdite.

2 Do të fillojmë me deklaratën që i keni dhënë ZPS-së, që  
3 është prova materiale P01210. Pyetja që kam për juve është  
4 kjo: Kush a ka përgatitur këtë deklaratë?

5 PË. Deklaratën e ka shkruar dikush nga ZPS-ja.

6 PY. Domethënë, ata e kanë përgatitur deklaratën dhe pastaj ja  
7 u kanë dërguar juve për rishikim dhe për redaktime?

8 PË. Në qoftë se kjo është deklarata e 2020, ata kanë ardhur  
9 në Nju Jork atje ku kam qenë dislokuar në atë kohë dhe ata ma  
10 nisën këtë dokument. Edhe për shembull në qoftë se shikoni  
11 nënshkrimin, nënshkrimi mban një datë të ndryshme nga  
12 intervista ime.

13 PY. Domethënë, Prokuroria e përgatiti deklaratën, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. A keni pas qasje në deklarata të mëhershme që i keni  
16 dhënë TPNJ-së përpara sesa të përgatitej kjo deklaratë, pra  
17 deklarata, e ZPS-së?

18 PË. Mua mu treguan raportet, pashë raportet dhe çdo gjë  
19 tjetër që kam pasur por nuk është se i kam parë deponimin që  
20 kam bërë përpara TPNJ-së.

21 PY. Në rregull. Do ta trajtojmë edhe çështjen e  
22 parashtrimeve. Megjithatë, dua që të filloj me mënyrën se si e  
23 keni kuptuar ju strukturën e UÇK-së në verën e 1989.

24 Në deklaratën që i keni dhënë ZPS-së në vitin 2020 ju  
25 thoni që në vitin 1998 - dhe më ndihmoni pak me emrin - bëhet

1 fjalë për z. Rohan, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Z. Rohan atëherë ka qenë Sekretar i Përgjithshëm i  
4 Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austrisë, vendosi që të  
5 niste negociata me UÇK-në në mënyrë që t'i përfshinte ata në  
6 procesin politik. A është e vërtetë kjo?

7 PË. Po.

8 PY. Si pjesë e këtij procesi keni pasur detyrën që të  
9 identifikoni udhëheqës politikë të UÇK-së që mund të ishin  
10 ndërveprues ose bashkëbisedues për këtë qëllim, apo jo?

11 PË. Po. Takimin e parë e kam organizuar së bashku me z. Rohan  
12 dhe pas këtij takimi pastaj u kërkova që të organizoja të  
13 tjera.

14 PY. Ju i keni thënë konkretisht ZPS-së që nuk keni qenë i  
15 interesuar për udhëheqjen ushtarake të UÇK-së, apo jo,  
16 Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. Domethënë ju nuk keni qenë i interesuar në vendimmarrjen  
19 ushtarake, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Po. Kjo është e saktë.

21 PY. A keni marrë informacion sa i takon strukturës ushtarake  
22 të UÇK-së pavarësisht pozicionit tuaj?

23 PË. Ne donim që të kontaktonim me persona që mund të fliste  
24 në emër të UÇK-së edhe të përfshihej në procesin politik.

25 Sigurisht për të gjetur dikë që kishte kompetencë ose

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 47

1 autoritet në emër të UÇK-së edhe me të cilin mund të flisnim  
2 do të duhej që të merrnim një informacion të përgjithshëm për  
3 UÇK-në ose të paktën të mendoj që kishin një informacion për  
4 të përgjithshëm për UÇK-në.

5 PY. A është e drejtë të thuhet që ju nuk e kishit të qartë se  
6 çfarë strukture kishte UÇK-ja në atë kohë, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe nuk ishit i qartë se si funksiononte ose si operonte  
9 UÇK-ja? A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 PY. Përpara verës së 1998, a është e saktë që ju kishit  
12 informacion të kufizuar ose të cunguar për UÇK-në dhe këto  
13 ishin informacione që ju kishin dhënë ose ndërkombëtarët ose  
14 ndonjë palë tjetër, apo jo?

15 PË. Po, ndërkombëtarët edhe gazetarët lokalë. Nuk e di në  
16 qoftë se mund të më lejoni të shtoj edhe diçka tjetër që prej  
17 majit të 1998, kemi pasur gjithashtu edhe një ekip ECMM-je të  
18 lëvizshëm që punonte në terren që kishte një informacion të  
19 përgjithshëm, megjithatë nuk është se kishte ndonjë  
20 informacion shumë të madh sa i takon frontit politik.

21 PY. Në përpjekjet tuaja për të mësuar lidhur me strukturën e  
22 UÇK-së jemi takuar me individë të ndryshëm, përfshirë këtu  
23 edhe kosovarë dhe diplomatë apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Një prej diplomatëve me të cilët jeni takuar në verën e

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 48

1 1998 ishte Ambasadori Richard Holbrook, apo jo?

2 PË. Nuk është se e kam takuar drejtpërdrejt por ka qenë pjesë  
3 e takimeve ku ka marrë pjesë dhe ai.

4 PY. A ka thënë Ambasadori Holbrook në ato takime që nuk dihej  
5 në qoftë se UÇK-ja e kishte një zinxhir të brendshëm komande  
6 dhe që ai kishte dyshimet e veta lidhur me këtë, apo jo?

7 PË. Besoj që i referoheni një kabllogrami që kam shkruar unë  
8 në fillim të verës, mbase në qershor 1998, apo jo. Po.

9 PY. Ju e keni hedhur këtë informacion në këtë kabllogram apo  
10 jo?

11 PË. Po.

12 PY. Ky është kabllogrami i 7 korrik 1998, a është e vërtetë  
13 kjo, Dëshmitar? Dhe mund ta paraqesim edhe në ekran për ta  
14 parë të gjitha palët.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë do i kërkoja Sekretares të  
16 paraqesë në ekran provën materiale P01215. Ta zmadhojmë pak  
17 tek pjesa që fillon me "Holbrook".

18 PY. Për këtë e kishit fjalën më herët? Domethënë është kjo  
19 pjesa që thotë:

20 "Në lidhje me UÇK-në Holbrook thotë nuk dihet në qoftë se  
21 UÇK-ja ka një zinxhir të brendshëm komande, apo jo. Ai dyshon  
22 që ka një zinxhir të tillë. Ai i ka kërkuar përfaqësuesve të  
23 UÇK-së që të identifikojnë udhëheqësit e tyre në mënyrë që të  
24 sqarohet në qoftë se ata mund të luajnë ndonjë rol në proces  
25 në gjykim ..."



Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 49

1 PY. A është e vërtetë kjo?

2 PË. Po.

3 PY. A ke ndonjë informacion se mbi çfarë baze z. Holbrook  
4 thoshte që ai nuk besonte që UÇK-ja kishte një zinxhir të  
5 brendshëm komandimi?

6 PË. Besoj që amerikanët kishin më shumë informacione  
7 inteligjence sesa ne. Amerikanët kishin edhe një prani në  
8 Prishtinë. Kishin edhe një shërbim informacioni të Shteteve të  
9 Bashkuara që e kam vizituar edhe unë kur kam qenë në  
10 Prishtinë, ndërkohë që ne evropianët nuk kemi pasur prani të  
11 vazhdueshme atje. Kështu mënyra sesi e kemi kuptuar neve  
12 situatën atëherë ishte që prezenca ose prania e Kombeve të  
13 Bashkuara përfshinte gjithashtu -- e Shteteve të Bashkuara -  
14 më falni - përfshinte gjithashtu edhe pjesën e informacionit  
15 inteligjent ose të informimit në përgjithësi.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do të kalojmë tek një  
17 dokument tjetër. Është një kabllogram tjetër që ka marrë  
18 numrin e provës materiale P01212. Ju përmendni në intervistën  
19 e ZPS-së në paragrafin 39 që ka pasur një raport nga Ambasada  
20 Austriake në Beograd që i është dërguar Ministrisë Austriake  
21 të Punëve të Brendshme që mban datën 27 qershor 1998. Nëse  
22 kalojmë tek pjesa e parë, pika e fundit me të zezë.

23 PY. Së pari e njihni këtë raport?

24 PË. Po, është përkthimi në anglisht. Në qoftë se mund ta shoh  
25 në krye të faqes pak. Po.

1 PY. Ju kujtohet a e keni përgatitur këtë raport?

2 PË. Po.

3 PY. E keni përgatitur këtë?

4 PË. Po.

5 PY. Pika e fundit në pjesën 1 lexon:

6 "Struktura komanduese e UÇK-së megjithatë ngelet diçka si  
7 misterioze sipas Shteteve të Bashkuara. Megjithëse UÇK-ja  
8 vepron duke përdorur terma si 'Shtabi i Përgjithshëm' në  
9 pikëpamje të Shteteve të Bashkuara kjo është më shumë një  
10 strukturë e shpërndarë horizontale dhe struktura koordinimi.  
11 Kjo duhet të ishte problematike për të përfshirë UÇK-në në  
12 dialogun politik".

13 A ju kujtohet nga ka ardhur ky informacion?

14 PË. Ka ardhur ana amerikane.

15 PY. A ju kujtohet kush konkretisht nga ana amerikane e ka  
16 siguruar këtë informacion?

17 PY. Nuk e di kush ishte i pranishëm gjatë takimit. Në qoftë  
18 se mund të shoh pak më shumë titullin e raportit pak më sipër.

19 Ka qenë takim i grupit të kontaktit, shefat e Misionit --  
20 misioneve, dhe ndoshta ka qenë ambasadori amerikan,  
21 zëvendësambasadori që ka që ka dhënë këtë informacion.

22 PY. A është e mundur që ka qenë më duket që në deklaratën  
23 tuaj dhënë ZPS-së në paragrafin 50 ju i referoni atasheut  
24 ushtarak. A është e mundur të ketë qenë ai?

25 PË. Mund të ketë qenë edhe ai burimi i këtij informacioni.

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Page 51

1 Unë kam qenë në kontakt me disa atashe ushtarë perëndimorë të  
2 cilët kanë shkuar në Kosovë dhe kishin disa njohuri apo janë  
3 përpjekur që të marrin informacion lidhur me situatën aty.  
4 PY. Kur keni dhënë deklaratë Gjykatën Penale Ndërkombëtare  
5 për ish-Jugosllavinë në nëntor 2004 keni thënë diçka të  
6 ngjashme. Keni deklaruar aty --

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo gjendet në dokumentin U008-  
8 5982 deri në U008-5982. Në qoftë se mund ta shfaqin në ekran.

9 PY. Kjo është dokument nga një seancë përgatitore që keni  
10 bërë me TPNJ-në. Në paragrafin 1 thuhet që keni thënë:

11 "... UÇK-ja në verë të 1998-s nuk kishte një strukturë  
12 hierarkike qendrore të qartë. Megjithëse kishim dëgjuar për  
13 Shtabin e Përgjithshëm të UÇK në atë kohë nuk ishim të bindur  
14 që ky ekzistonte dhe në qoftë se ekzistonte ai kishte dyshime  
15 për masën apo nivelin e kontrollit që kishte mbi forcat e UÇK-  
16 së në Kosovë. Dukej më shumë që bëhej fjalë për udhëheqës  
17 rajonalë në ato rajone sesa një strukturë të centralizuar,  
18 pra."

19 A ju kujtohet që keni thënë këtë në TPNJ në 2004?

20 PË. Po, më kujtohet.

21 PY. A pasqyron kjo në mënyrë të saktë përshtypjet tuaja në  
22 vitin 1998?

23 PË. Po. Ne nuk dinim shumë. Pak fare. Përpiqeshim të kuptonim  
24 se si ishte organizuar dhe strukturuar UÇK-ja. Më kujtohet që  
25 vëzhguesit, vëzhguesit e Bashkimit Evropian kishin përvoja të

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 52

1 ndryshme në pjesë të ndryshme të Kosovës gjatë të kontakteve  
2 të tyre me UÇK-në. Disa ishin më agresivë, disa trajtonin  
3 praninë e vëzhguesve në mënyrë më të q'atë.

4 PY. A mund të sqaroni pjesën ku ju thoni:

5 "Dukej që ishin më shumë rajone apo udhëheqës të atyre  
6 rajoneve, sesa një strukturë e centralizuar."

7 Si e keni krijuar këtë përshtypje?

8 PË. Në atë kohë ndjenja ime ishte që ishte një qendër në  
9 rajonin e Drenicës, por jo që detyrimisht UÇK-ja në pjesën  
10 perëndimore të Kosovës, në zonën e Dukagjinit për shembull,  
11 ishte në të njëjtën strukturë apo e centralizuar në të njëjtën  
12 strukturë.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, parashtroj këtë dëshmi  
14 për t'u pranuar si provë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
16 kundërshtim?

17 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
19 U008-5982 deri në U008-5982 pranohet.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,  
21 dokumenti dhe përkthimi i tij shqip pranohet nën numrin e  
22 provës 1D00137. Dhe klasifikohet si konfidencial.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

24 PY. Një pyetje në lidhje me këtë. Nëse ju kujtohet a keni  
25 patur, është dhënë -- keni patur ndonjë mundësi që të shkoni

1 në ndonjë zonë që ishte nën komandën e një komandanti që  
2 njihej si komandant Remi?

3 PË. Nuk e di. Më duket që Remi ka qenë në zonën, rajonin e  
4 Llapit. Por nuk e di kur mund të kem shkuar në zonën nën  
5 komandën e tij. Nuk e di as se deri ku shtrihej kjo zonë dhe  
6 kemi zhvilluar diskutime në janar 1999 lidhur me ushtarët e  
7 ushtrisë jugosllave. Mund të jetë kjo zona. Nuk e di.

8 PY. A keni shkuar në zonën e Llapit në verën e 1998?

9 PË. Jo.

10 PY. Në dëshminë tuaj në gjykimin kundër Limajt, dhe dokumenti  
11 mban numrin P1209 në faqen 676, në fillim të rreshtit 13 --  
12 fillon me rreshtin 13, pyetja e bërë është:

13 "Referenca që ju përdorni këtu për të -- 'për fraksione  
14 apo pjesë të UÇK-së të ndara' siç duhet në këtë përkthim është  
15 që ky incident specifik ishte thjesht një incident, pra, ky që  
16 sheh, apo e keni konsideruar ju këtë si një problem për UÇK-në  
17 në përgjithësi? Në terma të përgjithshëm."

18 Përgjigja juaj në këtë rast ka qenë:

19 "Nuk mendoj kështu, mendoj që duhet të tregohemi të  
20 kujdesshëm. Luk Haxhiu nuk -- Lum Haxhiu nuk ishte personi që  
21 u shkëput nga UÇK-ja. Ai po fliste me shtypin dhe mendoj që  
22 nuk ishte -- kjo nuk ishte e mirëpritur. Ka qenë problem i  
23 përgjithshëm, e kam kuptuar, apo e kam vlerësuar në atë kohë  
24 që në pjesën perëndimore të Kosovës ka pasur grupe të  
25 armatosura të cilët -- që vepronin sipas mendimit të tyre në

1 kohë të tyre dhe nuk ndisnin detyrimisht ndonjë komandë apo  
2 urdhër të komandave të tjera, pra.”

3 Ju keni bërë këtë referencë pak minuta përpara -- u  
4 referuat pak minuta përpara pjesës perëndimore të Kosovës. Për  
5 çfarë e keni fjalën kur thoni “bënin punët e tyre siç donin  
6 dhe jo detyrimisht ndiqnin urdhrat e ndonjërit tjetër --  
7 komande tjetër?

8 PË. Emri i Lum Haxhiut, mendoj që ka qenë luftëtar i UÇK-së  
9 që është fotografuar me Richard Holbrook kur ai ka shkuar në  
10 Junik, që është në pjesën perëndimore të Kosovës, afër kufirit  
11 me Shqipërinë. Kjo ka qenë hera parë që një takim zyrtar i një  
12 diplomati perëndimor, që një diplomat perëndimor zhvillonte me  
13 UÇK-në. Por ka qenë, me sa kam kuptuar pastaj, takim i rastit  
14 dhe jo dikush ishte në një mënyrë aty për të përfaqësuar UÇK-  
15 në apo që fliste në emër, apo ishte në gjendje -- kishte  
16 mundësinë, pozitën që të fliste në emër të UÇK-së.

17 PY. Në rregull. Por, si e krijuat këtë përshtypje që ata  
18 bënin atë që donin dhe jo detyrimisht ndiqnin urdhrat e  
19 komandës.

20 PË. Nuk e di. Nuk di. Thjesht nuk di më shumë.

21 PY. Në rregull.

22 PË. Por kjo ka qenë përshtypja e përgjithshme që kishim në  
23 vitin 1998, se ishin këto grupe që vepronin në mënyrë autonome  
24 sesa nën një komandë hierarkike.

25 PY. Në rregull. Dhe në të njëjtën dëshmi që keni dhënë në

1 këtë gjykim, në faqen 709, në rreshtin 3 keni thënë:

2 "Tani sipas vlerësimit tim mendoj që gjatë vitit 1998 dhe  
3 nuk e di kur, ka patur, është bërë një përpjekje që të jetë" -  
4 -

5 Më lejoni që të rifilloj. Po bëj pyetjen dhe pastaj  
6 përgjigjen që keni dhënë në këtë kontekst. Pyetja ishte:

7 "Z. Kickert, sipas asaj që keni kuptuar ju duke marrë  
8 parasysh faktin që ju nuk ishit ekspert ushtarak, a e kuptoni  
9 që komanda qendrore e shtabit, apo Shtabi i Përgjithshëm ishte  
10 rajonal në veprim apo mbulonte të gjithë Kosovën?"

11 Dhe përgjigja juaj ka qenë:

12 "Tani, sipas vlerësimit tim mendoj që gjatë vitit 1998  
13 nuk e di kur, ka pasur, është bërë një përpjekje sigurisht që  
14 të shtrihej në të gjithë Kosovën, por përshtypja ime ka qenë  
15 që koordinimi mes rajoneve të ndryshme ishte i vështirë."

16 A ju kujtohet që keni dhënë këtë dëshmi?

17 PË. Po, pasqyron atë që kam menduar në atë kohë. Kam menduar  
18 që kishte më shumë koordinim mes strukturave rajonale sesa një  
19 strukturë hierarkike.

20 PY. A ju kujtohet që keni -- ajo që keni vëzhguar që ju ka  
21 pastaj bërë ju të mendoni apo ta arrini në këtë përfundim?

22 PË. Në përgjithësi, kjo -- fakti është që ne donim që të  
23 merrnim angazhime. Kjo kërkon -- na ka marrur gjithmonë një  
24 kohë të gjatë edhe kishim përshtypjen që nuk kishte koordinim  
25 apo konsultim të nevojshëm. Që nuk kishte një person me të --

- 1 një përfaqësues me të cilin mund të -- nga i cili mund të  
2 merrnim përgjigje të drejtpërdrejtë.
- 3 PY. Në rregull. Tani po flisnim për verën e 1998-s, por kjo  
4 çështje lidhet, çështja e koordinimit apo që duhej të  
5 diskutonit me persona, të bisedonit me persona vendorë. Juve  
6 ju treguan marrjen në pyetje nga ana e Prokurorisë dhe në  
7 seancën përgatitore një video e datës 5 mars 1999 -- takimit  
8 të datës 5 mars 1999 mes Ambasadorit Christian Pauls, Wolfgang  
9 Petritsch, Sylejman Selimi, Ramë Buja, Fatmir Limajt dhe çfarë  
10 është diskutuar aty, ju kujtohet?
- 11 PË. Po.
- 12 PY. Dhe Ambasadori Pauls ishte ambasadori i Gjermanisë, e  
13 saktë?
- 14 PË. Jo, ka qenë në Ministrinë Gjermane përgjegjës për  
15 Ballkanin. Nuk ka qenë ambasador në Beograd.
- 16 PY. Tani ju këtë video e keni parë ju?
- 17 PË. Pjesë të saj, po.
- 18 PY. Ju kujtohet që z. Pauls deklaroi në atë mbledhje që UÇK-  
19 ja "nuk ishte ushtri konvencionale"?
- 20 PË. Po, e kam lexuar këtë.
- 21 PY. Ju ishit i pranishëm kur ai e tha këtë. A kuptuat ju që  
22 ajo që ai donte të thonte se UÇK-ja nuk ishte ushtri  
23 konvencionale?
- 24 PË. Nuk ishte ushtri që përfaqësonte vendin.
- 25 PY. A e kuptuat ju që ai donte të thoshte që ishte më shumë -



1 - se ajo që ai donte të thoshte ishte se bëhej fjalë për më

2 shumë për një forcë guerile sesa një ushtri konvencionale?

3 PË. Jo, nuk do të thoja detyrimisht këtë. Ajo që dua të them

4 është se ishte forcë e armatosur kryengritëse. Kjo ishte e

5 qartë për të gjithë neve.

6 PY. Gjatë seancë përgatitore me ZPS-në keni shpjeguar,

7 sqaruar që ndërkohë që UÇK-ja përpiqej të paraqiste vetveten

8 si një ushtri e mirëorganizuar, duke ekzagjeruar përmasat e

9 saj, strukturën, a është e saktë?

10 PË. Kjo është sigurisht e vërtetë për vitin 1998.

11 PY. Dhe sipas asaj që keni kuptuar, e keni kuptuar ju se pse

12 dëshirojnë ata ndoshta që ta ekzagjeronin këtë gjë?

13 PË. Për të çuar përpara statusin e tyre brenda Kosovës, por

14 edhe për neve në sytë tanë, të ndërkombëtarëve që t'i merrnim

15 ata më seriozisht. Kjo ka qenë tendenca kryesisht në mesin e

16 diplomacisë amerikane për të vënë mënjanë UÇK-në në formimin e

17 platformës politike përfaqësuesve të shqiptarë të Kosovës.

18 Ne evropianët, ne austriakët, ne nuk besonim që kjo ishte

19 e mundur por ishte një përplasje e vazhdueshme.

20 PY. Për sa i përket ekzagjerimit, ata e ekzagjeruan -- e

21 ekzagjeronin këtë gjë, thatë në seancën tuaj përgatitore,

22 përmasat, strukturën; a është e saktë?

23 PË. Përmasat -- nuk kam biseduar ndonjë herë për numrat.

24 PY. Në rregull. Struktura, atëherë.

25 PË. Po, struktura, po.

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 58

1 PY. A e ekzagjeronin -- a e ekzagjerojnë ata organizatën e  
2 tyre?

3 PË. Kjo ishte përshtypja ime, po.

4 PY. A e ekzagjeronin mundësinë apo aftësinë e tyre që të  
5 ishin efikase në terren?

6 PË. Besoj se në verë të vitit 1998 ata e kanë mbivlerësuan  
7 vetveten e tyre, apo aftësitë e tyre. Mendoj që e kanë patur  
8 një përvojë që ju ka dhënë një mësim në një farë forme  
9 ngjarjet e Rahovecit. Dhe kur pala serbe nisi ofensivën mendoj  
10 që ata u detyruan të tërhiqen nga të gjitha vendet ku ne i  
11 takonim më parë.

12 PY. Sa i përket përvojës tuaj të drejtpërdrejt keni shpjeguar  
13 në seancën përgatitore me ZPS-në se ju keni parë pika  
14 kontrolli apo postblloqe të UÇK-së të kontrolluara nga bujq më  
15 shumë sesa ushtarë. Është e saktë?

16 PË. Kjo ka qenë përvoja kur kemi i -- jemi takuar për herë të  
17 parë në Malishevë, kur kemi kaluar nga rruga kryesore tek një  
18 pikë kontrolli që ishte qartësisht mbajtur nga milicë që nuk  
19 ishin të trajnuar apo të stërvitur.

20 PY. Ishin ata bujq?

21 PË. Njerëz të armatosur thjesht.

22 PY. Që t'i kthehemi çështje tjetër. Jeni takuar me z. Thaçi  
23 dhe z. Veseli në korrik 1998, e saktë?

24 PË. E saktë.

25 PY. Dhe ju keni qenë në atë pikë, po interesoheshit për të

1 kuptuar pjesën politike më shumë sesa për të identifikuar

2 udhëheqësit politikë sesa -- dhe jo udhëheqësit ushtarakë?

3 PË. E saktë.

4 PY. Dhe ju e keni konsideruar z. Thaçi si politik më shumë --

5 si figurë politike dhe jo -- më shumë sesa figurë ushtare. A

6 është a saktë?

7 PË. Kjo është e saktë sepse atë po kërkonim edhe neve. Kjo më

8 ishte vënë -- më thënë mua nga një gazetar vendor si

9 personalitet potencial i nivelit të lartë mbi të cilën mund të

10 fliste me autoritet në emër të UÇK-së për procesin politik të

11 cilin ne përpiqeshim të arrinim.

12 PY. Dhe sipas asaj që ju kujtohet ju është e saktë që - më

13 lejoni ta riformuloj këtë. Ju së pari jeni takuar me z.

14 Veseli. Është e saktë?

15 PË. E saktë.

16 PY. Dhe --

17 PË. Me Sekretarin e Përgjithshëm, Rohan.

18 PY. Po. Dhe kjo ishte organizuar nga ekipi monitorues i

19 Bashkimit Evropian?

20 PË. E saktë.

21 PY. Tani a është e saktë të themi sipas asaj që ju kujtohet

22 ju se deri kohëve të fundit, deri në vitin 2020, është momenti

23 pastaj kur jeni takuar me z. Thaçi.

24 PË. Është e saktë.

25 PY. Dhe në qoftë se shohim deklaratën tuaj të vitit 1999.

1           Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të shfaqni në ekran  
2 dokumentin 0081-1091 deri në 0081-1096. Faqe 3, ju lutem. Dhe  
3 është paragrafi që fillon:

4           "Në të njëjtën kohë për afërsisht ..."

5           Mund të kalojmë.

6 PY.   Ju keni deklaruar aty në maj apo qershor të vitit 1999:

7           "U ktheva në Malishevë në fund të korrikut 1998 pas  
8 luftimeve midis UÇK-së dhe forcave serbe në Rahovec. Një  
9 gazetar i Kohës Ditore, Dukagjin Gorani, më shoqëroi gjatë  
10 udhëtimit. Ishte në gjendje që të më vinte në kontakt me z.  
11 Hashim Thaçi dhe pata mundësinë që ta takoja atë disa herë më  
12 vonë më pastaj.

13          "Në të njëjtën kohë për afërsisht, Trojka e Bashkimit  
14 Evropian (që në atë kohë përbëhej nga Mbretëria e Bashkuar,  
15 Gjermania) vizitoi Prishtinën -- vizitoi Prishtinën dhe vende  
16 të tjera në Kosovë."

17          Dhe pastaj vazhdon më tej ku diskutohet takimi që  
18 përfundimisht përfundoi me takimin me z. Kadri Veseli.

19 PË.   Kjo është deklaratë që është dhënë në mënyrë pak të --  
20 përpiluar në mënyrë të përshpejtuar. Por ka qenë deklaratë  
21 është dhënë në mënyrë të përshpejtuar, pra, dhe kur jam  
22 përballur me raportin e Ekipit Monitorues, është raportuar  
23 takimi me z. Rohan dhe z. Kadri Veseli, dhe mendoj që e kemi  
24 vërtetuar tani kronologjinë e këtyre takimeve, datat e  
25 takimeve. Ajo që kam ngatërruar është aty ku fillimisht kam

1 menduar që janë takuar ditën pastaj më vonë me z. Hashim  
2 Thaçi, në fakt tani që po e rimendoj kjo ka ndodhur pas  
3 përpjekjes së dështuar të Trojkës së Bashkimit Evropian për  
4 t'u takuar me përfaqësues të UÇK-së. Ne nuk kemi shkuar -- nuk  
5 kemi kaluar pika kontrolli apo postblloqe.

6 Të nesërmen, është momenti kur unë dhe kolegu im  
7 britanik, David Slinn, kemi shkuar në Kleçkë dhe jemi takuar  
8 me z. Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja dhe Fatmir Limaj. Pra, në  
9 raport kronologjia tani është e saktë dhe nuk -- sepse më parë  
10 ishte ngatërruar pak në kujtesën time.

11 PY. Në rregull. Kronologjia aktuale bazohet në atë që ju --  
12 rindërtimin e ngjarjeve, pra, që ju kujtohet?

13 PË. E saktë.

14 PY. Ju nuk keni memorie të pavarur apo kujtesë të pavarur për  
15 kronologjinë?

16 PË. E saktë.

17 PY. Pra, në qoftë se kalojmë tek dëshmia që keni dhënë në  
18 gjykimin Limaj në vitin 2004, aty ku keni thënë dhe kjo është  
19 në faqen 669 të dëshmisë tuaj, në rreshtin 19, se aty keni  
20 thënë se ju jeni takuar me z. Veseli të nesërmen e takimit  
21 tuaj me z. Thaçi. E saktë?

22 PË. Kjo është gabim tani që e di tani me kohën që ka kaluar,  
23 isha gabim.

24 PY. Në rregull. Por --

25 PË. Po unë e thashë këtë gjë.

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 62

1 PY. Është gabim, por vetëm në kuptimin që dokumentet të cilat  
2 -- dokumentet që i referohen takimit me dikë që ka përfaqësuar  
3 vetveten është Numri 3; e saktë apo jo? Duhet të jeni të  
4 sigurt që Numri 3 ishte Hashim Thaçi me qëllim që të -- jeni  
5 të sigurt që kronologjia e re është -- e takimeve është e  
6 saktë.

7 PË. Po. Por e di që Numri 3, personi që prezantuar vetë si  
8 Numri 3, ishte Hashim Thaçi.

9 PY. Në rregull. Po ju nuk e njihnit Hashim Thaçin në atë  
10 kohë?

11 PË. Më është thënë emri i tij.

12 PY. Më vonë.

13 PË. Në fakt të njëjtën ditë më është thënë emri i tij.

14 PY. Pyetjet do të kalojmë tek kjo pas ca çastesh pas pushimit  
15 të drekës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë  
17 pushimin e drekës.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 --- Seanca ndërpritet në orën 11.01

20 --- Seanca rifillon në orën 11.30

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
22 sillni dëshmitarin në sallë.

23 Misetiç, kishit diçka për të thënë?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Thjesht desha t'ju njoftoja që do  
25 të doja që të flisja për ato që ka parë dëshmitari dhe çfarë

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 63

1 ka raportuar sa u takon krimeve serbe dhe, në qoftë se ju  
2 intereson, unë mund t'ju them që do të doja të diskutoja me  
3 dëshmitarin kur është takuar me z. Thaçi pas korrikut.

4 Dhe së dyti do të doja të diskutoja me të për Konventat e  
5 Gjenevës që ai thotë se ia ka përmendur z. Thaçi dhe i ka  
6 kërkuar UÇK-së që të respektonte Konventat e Gjenevës duke  
7 marrë parasysh ato që kanë ndodhur në gusht dhe në shtator të  
8 1998.

9 Po ua them këtë për kontekst që ta keni të qartë për  
10 çfarë do flas me dëshmitarin.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
12 Ka ndonjë paqartësi nga Trupi Gjykes në lidhje me këtë?

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
15 Dëshmitar, do të vijojmë me pyetjet nga z. Misetic.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

17 PY. Dëshmitar, përpara pushimit e ndërpreme fjalën për një  
18 diskutim për Numrin 3, dhe ju thatë se z. Thaçi nuk u  
19 prezantua me emër, por u prezantua si Treshi, Numri 3.

20 PË. Po.

21 PY. Gjatë kohës që keni qenë në Kosovë, a keni dëgjuar  
22 ndonjëherë ndonjë person tjetër t'i drejtohet z. Thaçi si  
23 Numri 3?

24 PË. Jo domosdoshmërisht për të, por më kanë thënë që kishin  
25 një sistem numerik që përdornin atje dhe m'u kujtua dhe e kam

1 thënë në një nga raportet e mia ku kam përshkruar një takim me  
2 Adem Demaçin, që dhe Adem Demaçi me numra u drejtohej  
3 personave, por nuk e kam lidhur ndonjëherë Numrin 3 me z.  
4 Hashim Thaçi.

5 PY. Pra, asnjëherë para takimit dhe as pas takimit nuk keni  
6 dëgjuar ndonjë gjë, as nuk keni lexuar nëpër gazeta a në  
7 libra, që z. Thaçi ishte, ka qenë, ndonjëherë personi i  
8 referuar si personi Numri 3.

9 PË. Nuk më kujtohet. Ka qenë në një moment, më pas emri i tij  
10 u bë i njohur botërisht, dhe nuk u përdor më sistemi numerik.

11 PY. Tani ju keni përvojë me Kosovën. A keni mësuar ndonjëherë  
12 si e ka pasur emrin, pseudonimin z. Thaçi gjatë luftës?

13 PË. Po.

14 PY. Cili?

15 PË. Gjarpri.

16 PY. Pra, por nuk keni dëgjuar më tej që ai t'i jenë referuar  
17 si personi Numri 3?

18 PË. Po nuk e di. Unë e takova, ai u prezantua si Numri 3, dhe  
19 për mua kjo ishte inkurajuese.

20 PY. E kuptoj, por po bëj pyetje tjetër. Ju e mësuar kur ishit  
21 në Kosovë që ai njihej si Gjarpri?

22 PË. Po.

23 PY. Por ama gjatë kohës që ishit në Kosovë nuk keni dëgjuat  
24 paralelisht që atij t'i drejtoheshin si Numri 3?

25 PË. Jo, nuk më kujtohet diçka e tillë.



1 PY. A e keni kuptuar ju pse përdorej një sistem numerik sipas  
2 jush?

3 PË. Sipas nesh, asokohe, ishte një ilustrim hierarkik me  
4 sistemin numerik, pra takova Numrin 7 fillimisht, pastaj  
5 Numrin 3, dhe kështu unë arrita të kuptoja që kisha, isha në  
6 shkallët më të larta të hierarkisë.

7 PY. Po pse nuk prezantoheshin me emra?

8 PË. Me sa kuptoj unë, ishte çështje sigurie.

9 PY. Nëse ishte çështje, problem sigurie, sipas jush është  
10 problem që të prezantohesh edhe radhën që ke në hierarki, me  
11 numra, sipas teje nuk është problem sigurie?

12 PË. Jo, për mua problemi kryesor apo kërcënimi kryesor është  
13 nëse prezantohesh me emër, qoftë për ty si person, qoftë për  
14 familjen. Edhe është më pak e rrezikshme në qoftë se përdoret  
15 një numër dhe nuk shënjestroresh drejtpërdrejt.

16 PY. Në qoftë se dikush, për shembull, prezantohej si Numri 1,  
17 dhe në qoftë se serbët e mësonin këtë, që ky është Numri 1,  
18 atëherë ky person bëhej dashje pa dashje shënjestër?

19 PË. Po, dhe unë mendoj që Hashim Thaçi ka qenë një nga  
20 shënjestrat kryesore.

21 PY. Dhe nuk mendoni ju se ai po e rrezikonte veten duke u  
22 prezantuar si personi Numër 3?

23 PË. Kjo ka qenë një gjëegjëzë edhe për ne. Nuk e dinim se  
24 kush ishte Numri 1 e kush ishte Numri 2.

25 PY. A ka mundësi që personi të jetë prezantuar si Numri 3 për

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 66

1 të krijuar, për të dhënë, për t'ju dhënë një përshtypje sa i  
2 takon rëndësisë që kishte në sytë tuaj?

3 PË. Jo, nuk besoj kështu. Kur u takuam me Numrin 7, ishte  
4 takim pak paksa i pazakontë, unë po mendoja mos e shpiku ky  
5 Numrin 7? Sepse është edhe 007, James Bond. Po pastaj kur u  
6 takova me Numrin 3 e kuptova që, aha, ka njëfarë vlere ky  
7 sistem numerik, ka njëfarë kuptimi ky sistem numerik. Por mund  
8 ta them këtë me siguri.

9 PY. I keni thënë ZPS-së gjatë seancës përgatitore se sipas  
10 jush, sistemi numerik mbështetet kryesisht në supozime.

11 PË. Po.

12 PY. Dhe ju nuk keni fakte, apo ndonjë njohuri të  
13 drejtpërdrejtë që të ketë ekzistuar vërtet një sistem numerik?

14 PË. Nuk kam parë asnjë dokument, nuk kam parë asnjë nga UÇK-  
15 ja ose më saktë, asnjë nga UÇK-ja nuk ma ka shpjeguar mua  
16 këtë.

17 PY. Z. Thaçi gjatë takimit me ju nuk ju tha ju se për çfarë  
18 ishte përgjegjës.

19 PË. Kështu.

20 PY. Dhe kur i thatë se po kërkonit udhëheqësit e UÇK-së, ai  
21 nuk tha se unë jam një prej tyre.

22 PË. Jo, nuk më kujtohet.

23 PY. Shohim dëshminë që keni dhënë në rastin Djordjeviç.

24 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Ka numrin IT-05-87.1 T2566. Vetëm  
25 një çast, ju lutem. T2566 deri në T2650, në faqen 2614 në

1 fillim të rreshtit 15.

2 PY. Fillojmë me pyetjen, pyetja është kjo:

3 "Po, tani është më e qartë".

4 Presim që të dalë edhe shqipja, më falni. Thuhet kështu,  
5 pyetje:

6 "Në rregull, tani është shumë më e qartë, z. Thaçi ose më  
7 mirë z. Treshi, u prezantua duke thënë unë jam Numri 3 dhe  
8 kompetencat e mia, autoriteti im, funksioni im është X e Y. A  
9 ju tha ai për çfarë ishte përgjegjës dhe pse ishte ai personi  
10 që po fliste me ju?

11 Përgjigja juaj ishte kjo:

12 "Ai e prezantoi veten si Numri 3, por nuk tha për çfarë  
13 ishte përgjegjës. Unë i thashë se ne po kërkonim udhëheqës të  
14 nivelit të lartë të UÇK-së për t'i prezantuar ata me procesin  
15 politik dhe ai na tha se ne jemi të gatshëm ta shqyrtojmë. Por  
16 ai nuk tha nëse do t'i kërkonte dikujt tjetër ose në do të  
17 vendoste ai vetë."

18 Është e saktë?

19 PË. Po.

20 PY. Në deklaratën për ZPS-në keni thënë që nuk e keni ditur  
21 konkretisht çfarë pozite ka pasur z. Thaçi pranë UÇK-së,  
22 kështu?

23 PË. Kështu.

24 PY. Gjithashtu, i keni thënë ZPS-së se gjatë takimit me z.

25 Thaçi keni përmendur Konventat e Gjenevës sepse kishte pasur

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 68

1 pretendime sidomos në shtypin serb se UÇK-ja po burgoste  
2 njerëz.

3 PË. Kështu.

4 PY. Shohim kabllogramin që keni dërguar ju, kabllogramin  
5 lidhur me takimin që keni pasur me Numrin 3.

6 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Ju lutem, të nxirret në ekran  
7 materiali me numër P01217.

8 PY. Fillimisht, a e njihni këtë dokument?

9 PË. Po.

10 PY. A është ky kabllogrami i 24 korrikut në të cilin  
11 raportoni për Numrin 3, Numrin 7, pra takimet që keni pasur me  
12 ta?

13 PË. Po.

14 PY. A keni bërë një shënim në kabllogram se keni përmendur  
15 konventat e Gjenevës?

16 PË. Nuk e mbaj mend, nuk është se kemi pasur ndonjë rend të  
17 caktuar dite për atë takim. Ne thjesht u takuam, unë u takova  
18 me stafin e Kryqit të Kuq në Malishevë përpara takimit sepse  
19 dhe ata po kërkonin një pikë kontakti për UÇK-në në mënyrë që  
20 të flisnin për çështjet që deshën të flisnin, dhe prandaj e  
21 kam përmendur.

22 PY. Doni ta shohim dokumentin bashkë që ta lexojmë edhe këtë?

23 PË. Po.

24 PY. Në rregull. Na thoni kur keni mbaruar që të kalojmë tek  
25 faqja tjetër.

1 PË. Shkoni në faqen tjetër. Poshtë, ju lutem. Nuk e shoh të  
2 jetë përmendur.

3 PY. Në rregull. Për procesverbal doni të thoni që nuk  
4 përmenden Konventat e Gjenevës në dokument?

5 PË. Po.

6 PY. I keni thënë ZPS-së se nuk keni përmendur asnjë pretendim  
7 konkret se nuk kishit ndonjë provë për ndonjë krim që të  
8 kishte ndodhur, dhe se nuk besonit në propagandën serbe. Dhe  
9 këtë e keni thënë në deklaratën për ZPS-në, paragrafi 27,  
10 kështu?

11 PË. Po propagandë kishte nga të dyja anët dhe ishte shumë e  
12 vështirë ta gjeje, ta kuptoje të vërtetën. Por qëllimi në këtë  
13 takim për mua nuk ishte që të flisja për këtë, por unë doja të  
14 kuptoja nëse strukturat e UÇK-së, strukturat më të larta të  
15 UÇK-së, ishin të gatshme të angazhoheshin në një proces  
16 politik.

17 PY. Që të jemi të qartë për procesverbal, nuk keni përmendur  
18 asnjë pretendim konkret të asgjëje gjatë këtij takimi?

19 PË. Jo, nuk kam përmendur asgjë.

20 PY. Gjatë seancës përgatitore, thatë po ashtu, në Shënimin  
21 përgatitor numër 1, që është i paredaktuar, keni përmendur  
22 faktin që mund të mos respektoheshin Konventat e Gjenevës në  
23 Pasan [fonetikisht], kështu?

24 PË. Po. Kjo është tamam ajo që thashë pak më përpara, unë  
25 mendoj se e përmenda, sepse besoja se edhe kjo ishte dhe për

1 hir të personave, personelit të Kryqit të Kuq që ishin në  
2 Malishevë asokohe.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetiç, në fakt  
4 tentativa jua j për të folur në frëngjisht u keqinterpretua në  
5 transkript.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë kujtova se fola mirë  
7 frëngjisht.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shumë mirë frëngjisht në  
9 fakt fole, por u përkthye gabim "en passant", në kalim e  
10 sipër, domethënë dhe doli emri Pasan aty, si emër fshati.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Më shkurajuat fare tani.  
12 Faleminderit, do përpiqem ta korrigjoj.

13 PY. Dëshmitar, keni thënë në paragrafin 27 për ZPS-në se nuk  
14 ju kujtohet konkretisht çfarë ka thënë z. Thaçi, por që ka  
15 thënë se UÇK-ja do t'i respektonte Konventat e Gjenevës.

16 PË. Po. UÇK-ja, ai tha që UÇK-ja është një ushtri, janë të  
17 organizuar, të strukturuar, edhe rrjedhimisht do të  
18 respektonin Konventat e Gjenevës. Kjo u tha në këtë takim.

19 PY. Të flasim tani për Konventat e Gjenevës. Po përpara se të  
20 bëjmë këtë, të kuptojmë kontekstin se si po përpiqej UÇK-ja të  
21 formonte një forcë më të strukturuar. Shkurtimisht, pas  
22 takimit më 23, me Numrin 3 dhe Numrin 7, ndodhi një ofensivë e  
23 madhe serbe. Ju kujtohet?

24 PË. Po.

25 PY. A pajtoheni me mua se ofensiva pati një efekt

1 shkatërrimtar mbi UÇK-në?

2 PË. Nuk e di a pati efekt komplet shkatërrimtar mbi UÇK-në,  
3 por në zonat ku takonim ne më përpara UÇK-në, nuk ishte më e  
4 mundur t'i shihje, dhe ishte e pamundur të kontaktoje me ta.

5 PY. Në rregull.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Do t'ju tregoj një dokument të  
7 KDOM-it, edhe më thoni nëse pajtoheni ju -- të KDOM-it të  
8 Mbretërisë së Bashkuar, dhe më thoni nëse pajtoheni me  
9 vlerësimin që kanë bërë ata. Është me numër SPO00110729 [Sipas  
10 përkthimit]. Ju kërkoj ndjesë, e thashë gabim. Edhe një herë.  
11 Është SPOE00117127 deri në 00117132. Na nevojitet faqja  
12 SPOE00117129. Shkojmë më poshtë, tek paragrafi që fillon me  
13 "UÇK", "KLA".

14 PY. Fillojmë me fjalinë e dytë.

15 "Panorama e përgjithshme e UÇK-së është kryesisht, është  
16 e përbërë kryesisht prej njësive të fragmentuara dhe të  
17 shpërndara të cilët kanë stërvitje dhe pamje të ndryshme."

18 Fillimisht, a pajtoheni me këtë vlerësim?

19 PË. Këta kanë qenë vrojtuesit e terrenit, dhe ishin kryesisht  
20 ushtarakë në këto misione vëzhguese, kështu që edhe merrnim  
21 raportet e tyre dhe pajtohëm me atë që thonin ata.

22 PY. A keni marrë raporte si ky asokohe?

23 PË. Po. Sepse kishte segmente të ndryshëm të KDOM-it dhe një  
24 prej tyre ishte ECMM-ja që ishte po ashtu pjesë e KDOM-it,  
25 ishte pjesa evropiane, ka qenë pjesa amerikane e KDOM-it,

1 madje dhe një pjesë ruse e KDOM-it. Me sa mbaj mend, ne  
2 merrnim kopje fizike në Beograd, jo në mënyrë elektronike. Por  
3 jam takuar dhe personalisht me vëzhguesit.

4 PY. Më poshtë thuhet:

5 "Shumica e grupeve janë tejet të vegjël, grupi më i madh  
6 që ka parë KDOM-i britanik nuk kishte më shumë se 40 persona.  
7 Dhe kishte disa grupe që nuk kishin më shumë se 5 a 6 persona.

8 Gjatë udhëtimeve që keni bërë në Kosovë, ju personalisht,  
9 a keni vëzhguar, pra a keni vënë re diçka të ngjashme sa i  
10 takon grupeve apo përmasave të grupeve të UÇK-së?

11 PË. Nuk kam pasur, nuk kam takuar, nuk kam parë grupe më të  
12 mëdha, por në fakt ne kishim pika kontakti ushtarake për këtë  
13 qëllim. Unë doja më shumë të takohesha me udhëheqësit  
14 politikë.

15 PY. Vijon dhe thuhet:

16 "Që kishte nga seksione të mirorganizuara ku kishim  
17 udhëheqës të dalluar a të spikatur ushtarakë e politikë, dhe  
18 këto ishin anëtarësi që kishin ardhur kryesisht nga diaspora,  
19 dhe kishte grupe të vogla pa pajisje, fshatarë të rinj, të  
20 pasofistikuar të cilët ishin rekrutuar në zonat ku jetonin".

21 Pajtoheni me këtë?

22 PË. Po, pajtohemi.

23 PY. Pra kjo përputhet me atë që keni vëzhguar dhe ju.

24 PË. Po.

25 PY. "Disa prej tyre kishin sofistikim të madh politik, ndërsa



Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 73

1 disa të tjerë ishin disa persona që thjesht bënë disa,  
2 luftonin kundër serbëve për çlirimin e Kosovës”.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që ky  
4 dokument të pranohet si provë gjyqësore.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni  
6 kundërshtime?

7 Z. CAPIN: [Përkthim] Jo.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me  
9 numër SPOE00117127 deri në SPOE00117132, deri në SPOE00117129,  
10 pranohet.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo faqe merr numrin me  
12 numër 1D00138, me klasifikimin konfidencial.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse ZPS-ja nuk ka kundërshtim,  
14 mendoj që mund të jetë një dokument publik.

15 Z. CAPIN: [Mikrofoni çaktivizuar]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të na  
17 informoni dhe për dokumentin që diskutuam përpara.

18 Z. CAPIN: [Përkthim] Po, nuk ka asnjë problem, mund të  
19 jenë publike të dy dokumentet.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
21 Dokumentet riklasifikohen si publike.

22 Vazhdoni.

23 Z. MISETIC: [Përkthim]

24 PY. Tani, pas takimit me 23 korrik, me Numrin 3 dhe Numrin 7,  
25 filloi ofensiva serbe dhe UÇK-ja u dëbua nga Malisheva,

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 74

1 kështu?

2 PË. Kështu.

3 PY. Dhe me sa kuptuat ju, ata shkuan në zonat kodrinore rreth  
4 e rrotull?

5 PË. Kështu e kam kuptuar unë.

6 PY. Me sa patë ju, Malisheva u braktis nga popullata  
7 shqiptare?

8 PË. Absolutisht po.

9 PY. Nga fundi i korrikut, fillimi i gushtit, ju kujtohet të  
10 keni marrë një raport nga monitoruesit tuaj se po ndodhnin  
11 shkatërrime në Malishevë dhe policia po plaçkiste shitoret dhe  
12 po u vinte zjarrin shtëpive?

13 PË. Po.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Do lutesha të vendosej në ekran ky  
15 material dhe mban numrin IT-05-87, përndryshe prova materiale  
16 P02655, ERN-ja është 00811105 deri në 00811106. Është një  
17 kontratë, ky dokument është një kontratë e mars, demarsh, e 4  
18 gushtit 1998.

19 PY. Dëshmitar, është edhe, a ju kujtohet t'ia keni përgatitur  
20 ju këtë për demarsh?

21 PË. Për herë të parë po e shoh pas kaq shumë vitesh, por  
22 qartë, është prej meje.

23 PY. A mbani mend që këtë e keni diskutuar, kjo është  
24 diskutuar në çështjen Djordjevic, në gjykimin Djordjevic, në  
25 2009?

1 PË. Po.

2 PY. Fillimisht, a ju kujtohet çfarë është?

3 PË. Po, është një shënim për demarsh, nuk është ndarë me  
4 Grupin e Kontaktit në vetvete se Rusia nuk është në listën e  
5 marrësve, por është ndarë me anëtarët e grupit perëndimor.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen e radhës.

7 PY. Shohim paragrafin që fillon "Shqetësime madhore", pika 2,  
8 kur thuhet:

9 "Ka raporte për plaçkitje e djegie shtëpish dhe u  
10 vendoset zjarri fushave që kanë ende të korrat e pavjelura nga  
11 forcat e sigurisë të ish-Jugosllavisë."

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Shikojmë fillimisht datën.

13 PY. Është data 4 gusht 1998. A ju kujtohen raportet që keni  
14 bërë që po plaçkiten edhe po digjen shtëpitë dhe po digjen  
15 gjithashtu të korrat?

16 PË. Po.

17 PY. Ju i keni parë vetë apo thjesht keni raportuar për këto?

18 PË. Kam lexuar raporte për to, dhe kam folur për anëtarët e  
19 ECMM-së që e kishin parë me sytë e tyre. Ne dëshmuam vetëm kur  
20 shkuam me trojkën në fund të korrikut, shkuam në një drejtim  
21 dhe u kthyem nga një drejtim tjetër, dhe pamë që fushat me të  
22 mbjella ishin në zjarr e sipër, por nuk e di kush ua vuri  
23 zjarrin.

24 PY. Në rregull. Shkojmë në fund të faqes. Ju keni thënë që:

25 "Inkurajojmë qeverinë jugosllave të mos i lejojë më

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 76

1 forcat që të djegin shtëpitë edhe pronat dhe të ndalohej  
2 plaçkitja".

3 Kështu?

4 PË. Kështu.

5 PY. Pra, është e drejtë të themi që asokohe, në fillim të  
6 gushtit 1998, ju merrnit raporte ku thuhej se forcat  
7 jugosllave po kryenin krime kundër personave dhe pronave të  
8 tyre, kështu?

9 PË. Prona, për pronat këtu e them me siguri. Sa për persona,  
10 mund të them që kishte luftime në atë kohë, por konkretisht  
11 nuk kishim mësuar ende për mizori ndaj civilëve në atë kohë.

12 PY. Në rregull.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
14 pranohet ky dokument si provë gjyqësore.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
16 kundërshtim?

17 Z. CAPIN: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
19 Materiali me numër IT-05-87 P02655 me ERN 00811105 deri  
20 0081106 [Sipas përkthimit] pranohet.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin e  
22 provës materiale 1D00139 dhe është i klasifikuar si publik.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ju  
24 dëgjova mirë.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, është dokument

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 77

1 publik.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

3 PY. A ju kujtohet që në fund të gushtit të 1998, keni shkuar  
4 në Qirez me ambasadorin Petritsch dhe Emma Bonino dhe atje  
5 keni parë një grup të madh personash që ishin zhvendosur?

6 PË. Po.

7 PY. Po a ju kujtohet pse kishte një grup të madh personash të  
8 zhvendosur apo të dëbuar në Qirez në fund të gushtit 1998?

9 PË. Po, sepse forcat serbe dhe jugosllave po avanconin,  
10 populli po largohej, nga gushti e në vijim nuk e kishim më  
11 punën e fokusuar në frontin politik dhe kjo për shkak se  
12 humbëm edhe kontaktin me pikat tona të kontaktit në terren,  
13 por puna jonë u fokusua që të stabilizojmë situatën për mijëra  
14 e mijëra personat që jetonin në male, që ishin pra persona të  
15 zhvendosur, që jetonin në male në atë kohë, në situata të  
16 tmerrshme.

17 PY. Në rregull.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim tani dokumentin tjetër që  
19 ka numrin DHT03913 deri në DHT03914, anglishtja. Varianti  
20 gjermanisht ka numrin DHT03913 në DHT03914.

21 PY. Dëshmitar, do nxjerrim një raport nga ambasada austriake  
22 në Beograd, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në 10  
23 shtator 1998, Ministrisë së Punëve të Jashtme Federale të  
24 Austrisë. A ju kujtohet ky dokument?

25 PË. Po.

1 PY. A mund të na thoni çfarë është?

2 PË. Po raportoja për një takim që pata me ambasadorin Parak,  
3 që ishte shefi i ECMM-së në Sarajevë, edhe atasheun austriak  
4 ushtarak, dhe shkua në pjesën perëndimore të Kosovës.

5 PY. Në këtë raport, keni zbardhur edhe çfarë keni parë gjatë  
6 këtij udhëtimit?

7 PË. Po.

8 PY. Shohim pikën e parë, është një udhëtim që keni bërë më 10  
9 shtator 1998, në pjesën perëndimore të Kosovës. Dhe thoni:

10 "Fshatrat përgjatë magjistrales Prishtinë-Pejë, me  
11 përjashtim të fshatrave serbë, nuk janë më të banuar."

12 A ka qenë kështu asokohe?

13 PË. Po.

14 PY. Në qoftë se do kalojmë te pika e fundit në këtë faqe,  
15 këtu thuhet që:

16 "UÇK-ja nuk është parë fare gjatë gjithë udhëtimit. ECMM-  
17 ja në Pejë supozon që ata janë tërhequr në male, në afërsi të  
18 Shqipërisë..."

19 A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. A është e vërtetë që gjatë udhëtimit ju nuk keni hasur  
22 fare me UÇK-së?

23 PË. Po, mendoj se ashtu ka qenë.

24 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Gjykatës, dëshiroj që të  
25 regjistrohet si provë ky dokument.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë  
2 kundërshtim nga palët?

3 Z. CAPIN: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
5 DHT00 -- dhe pjesa tjetër duhet të pranohet si provë  
6 materiale.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti që sapo  
8 referuat i nderuar Gjykatës, do të marrë numrin e provës  
9 materiale 1D00140, dhe do të shënohet si dokument publik.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Sa i takon faqes së dytë, le të  
11 kalojmë te faqja e dytë e këtij dokumenti.

12 PY. Në fjalinë e parë në këtë faqe thuhet që:

13 "Autokolona e Parakut nuk udhëtoi në afërsi të  
14 Krushovecit ..."

15 Dhe aty thuhet gjithashtu që:

16 "... vlerësohet që të mund të ishin rreth 25 000 persona  
17 të zhvendosur në periferi të Pejës".

18 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

19 PË. Ky është një informacion që besoj që do të ketë ardhur  
20 nga ECMM-ja ose ndonjë organizatë tjetër humanitare.

21 PY. A është e vërtetë që mund të ketë ardhur nga UNHCR-ja si  
22 informacion?

23 PË. Po, është e mundur që të ketë ardhur nga kjo organizatë.

24 PY. Dëshmitar, kemi folur për personat e zhvendosur në Qirez,  
25 edhe në jug të Pejës, kështu që tani dua t'ju tërheq vëmendjen

1 që të shikoni dokumentin P00750, ju lutem.

2       Është Rezoluta 1199 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve  
3 të Bashkuara dhe që mban datën 23 shtator 1998. A ju kujtohet  
4 në qoftë se e keni ditur përmbajtjen e kësaj rezolute në kohën  
5 kur është nxjerrë kjo nga Këshilli i Sigurimit ose më pas?  
6 PË. Sigurisht, domethënë, që nuk kam qenë i përfshirë në  
7 hartimin e kësaj rezolute, por kam qenë në dijeni të  
8 përmbajtjes së saj.

9       Z. MISETIC: [Përkthim] Në fund të kësaj faqeje.

10 PY. Këtu thuhet, te paragrafi i dytë nga fundi, që:

11       "Këshilli i Sigurisë është shumë i shqetësuar sa i takon  
12 luftimeve intensive të kohëve të fundit në Kosovë, dhe në  
13 veçanti përdorimit të tepërt dhe pa diskriminim të forcës nga  
14 forcat e sigurimit serb dhe ushtria jugosllave që ka çuar në  
15 një numër të konsiderueshëm vdekjesh të viktimave, dhe sipas  
16 vlerësimeve të Sekretarit të Përgjithshëm numri i personave të  
17 zhvendosur arrin dreri në 230 000 persona."

18       A është ky vlerësim, pra domethënë këto 230 000 personat  
19 e zhvendosur brendapërbrenda vendit, a mendoni që është në  
20 pajtim kjo në verën e vitit 1999, a mendoni që kjo shifër  
21 është në pajtim me atë çfarë ju keni konstatuar vetë në  
22 terren?

23 PË. Unë nuk flas dot për shifra sot, megjithatë mund të them  
24 që kemi parë shumë persona të zhvendosur që kanë qenë në  
25 situata shumë të rënda në atë kohë.



Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 81

1 PY. A e keni dëgjuar ndonjëherë pretendimin që shumë nga këta  
2 persona të zhvendosur brenda Kosovës kanë qenë viktima të  
3 përdorimit të forcës së tepërt e pa diskriminim të forcave të  
4 sigurimit të Serbisë?

5 PË. Nuk kam njohuri personale lidhur me këtë.

6 PY. Në rregull. Të shohim një tjetër dokument.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Me numër identifikimi IT-05-78  
8 [Sipas përkthimit] që është prova materiale P00557-E,  
9 dokumenti në gjermanisht po ashtu mban të njëjtin numër  
10 identifikimi, por nuk ka E në fund. Ky është dokumenti.  
11 Atëherë, për ta përsëritur për Sekretarinë, dokumenti është  
12 IT-05-78 [Sipas përkthimit] që është prova materiale P00557-E,  
13 ky është versioni në anglisht. Versioni në gjermanisht ka të  
14 njëjtin numër, por nuk ka E në fund.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka një gabim  
16 në transkript, duhet të jetë 87 dhe jo 78. Mund të vazhdoni z.  
17 Misetic.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

19 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet ky dokument?

20 PË. Po.

21 PY. A e dini kush ka hartuar këtë dokument, Dëshmitar?

22 PË. Këtu ka tre autorë: është shefi im, ambasadori Petritsch,  
23 unë vetë, dhe kolegu në ambasadën në Beograd.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të kalojmë  
25 tek pjesa e parë, nën pikën 1.

1 PY. "Demarshimet e CG-së". Janë Grupi i Kontaktit, apo jo, i  
2 takon, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. A ka ardhur ky shënim si rezultat i takimeve që keni  
5 marrë pjesë ju vetë me Presidentin Milosevic?

6 PË. Jo, unë nuk kam qenë asnjëherë i pranishëm në takimet me  
7 Presidentin Milosevic. Duhet të ketë qenë kontributi i  
8 Ambasadorit Petrovic [Sipas përkthimit].

9 PY. Këtu thuhet që Presidenti Milosevic që më 28 shtator  
10 pretendon që:

11 "UÇK-ja është mundur".

12 Dhe flet gjithashtu për:

13 "... mundësinë e amnistisë për grupe të caktuara."

14 A e shikoni këtë pjesë, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. A ju kujtohet në atë kohë në fund të shtatorit të 1998, a  
17 mendonte Serbia që UÇK-ja ishte mundur?

18 PË. Po, ata ishin shumë besimplotë, por edhe përpara të  
19 njëjtën qasje kishin. Pasi shkatërruan kompleksin e Jasharëve,  
20 në pranverën e 1998, më kujtohet që prefekti Leko Dajvic  
21 [fonetikisht] i ka thënë ambasadorit gjerman në atë kohë që  
22 problemi terrorist është zgjidhur tanimë. Pra, me fjalë të  
23 tjera, mendoj se ata ishin disi të bindur që e kishin mundur  
24 UÇK-në në atë fazë, që më pas hapi mundësinë për një prani më  
25 të madhe të ndërkombëtarëve që është Misioni Verifikues i cili

1 u dislokua në Kosovë.

2 PY. Në rregull. Do kalojmë dhe te kjo temë. Megjithatë, dua  
3 që të flasim për këtë dokument.

4 Z. MISETIĆ: [Përkthim] Kështu që do i kërkoja Sekretares  
5 të kalojmë në faqen tjetër.

6 PY. Nën pikën 2, kampet e personave të zhvendosur dhe  
7 riatdhesimet e mundshme, në paragrafin e dytë thuhet si më  
8 poshtë:

9 "Gjatë vizitës në terren, më datë 29 shtator, u inspektua  
10 një kamp i personave të zhvendosur në afërsi të Llapushnikut".

11 PË. U vizitua, jo u inspektua, se është përkthyer gabim nga  
12 gjermanishtja.

13 PY. Po lexoj nga anglishtja, në fakt, jo nga gjermanishtja,  
14 por e pranoj këtë.

15 Më tej teksti thotë që:

16 "Ky kamp i cili gjendej në fund të luginës në një zonë me  
17 pyje, ekzistonte, kishte disa muaj që ekzistonte. Dhe në  
18 kampet aty afër thuhet që t'i kishte në total rreth 2500 deri  
19 në 3000 veta. Vlerësohet që rreth 1000 persona jetonin në  
20 kampet e vizituara nga grupi."

21 "Ndërkoha personat e zhvendosur, familjet, ishin familje  
22 me fëmijë të vegjël, me persona nën moshë, të vjetër, dhe ata  
23 jetonin në gjendje shumë të mjerueshme".

24 Pyetja që kam për juve, është kjo. A i keni vizituar ju  
25 kampet e personave të zhvendosur?

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 84

1 PË. Po.

2 PY. Kjo pjesa këtu, a përshkruan kushtet reale të personave  
3 të zhvendosur?

4 PË. Po, dhe këtë pjesën e kam shkruar unë vetë.

5 PY. A është e vërtetë që në këtë zonë kishte pak a shumë 3000  
6 persona të zhvendosur?

7 PË. Jo, te kampi kryesor ku kemi qenë ne, ne kemi vlerësuar  
8 që do ketë pasur rreth 1000 vetë, ndërkohë që këto shifrat e  
9 tjera kanë të bëjnë me vlerësimet e ambasadave më shumë se sa  
10 vlerësimet tona.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të kalonim  
12 te faqja tjetër e dokumentit.

13 PY. Te paragrafi i parë këtu thuhet, atëherë flitet për një  
14 masakër të pretenduar nga forcat e sigurisë. Thuhet që:

15 "Udhëtimi në terren i çoi ambasadorët e Grupit të  
16 Kontaktit në fshatin Gllogovc në rajonin jugor të Drenicës.

17 Dhe pastaj thuhet:

18 "... (në veri të Kijevës, por për shkak të dëshmitarëve ju  
19 lutem mos e jepni këtë informacion). Ata ndërkohë, jemi, kemi  
20 hasur edhe një person i cili ishte qëlluar me armë dhe që  
21 ishte plagosur, u raportua gjithashtu dhe një masakër e një, e  
22 disa burrave të rinj. U përshkrua gjithashtu edhe një situatë  
23 e tillë nga fshatarët e tjerë ndërkohë që me datën 26 shtator  
24 rreth 15 veta, 15 burra janë ndarë nga një grup, nga personat  
25 e zhvendosur brenda Kosovës dhe janë marrë dhe janë dërguar në

1 një cep tjetër të fshatit, ku një polic pretendohet që t'i  
2 ketë ekzekutuar ata me një armë automatike.

3 Dëshmitar, pyetja që kam për juve është kjo, a keni qenë  
4 ju pjesë e vizitës në terren së bashku me ambasadorët e Grupit  
5 të Kontaktit?

6 PË. Po, në veçanti në këtë rast konkret ka qenë ambasadori  
7 Petritsch që i ka shoqëruar ata.

8 PY. Me sa ju kujtohet juve, ky raportim ose përshkrim a  
9 pasqyron me saktësi rrethanat e masakrave të kryera nga forcat  
10 e sigurimit serb?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe data kur ka ndodhur kjo ka qenë data 26 shtator 1998,  
13 apo jo?

14 PË. Po, në të njëjtin udhëtim, në të njëjtën vizitë në  
15 terren.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do kërkoj që  
17 të paraqitet në provë ky dokument.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
19 kundërshtime?

20 Z. CAPIN: [Përkthim] Jo, nuk ka kundërshtime.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti IT-  
22 05-87, që është P00557, pranohet si provë.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
24 dokumenti dhe përkthimi i tij në anglisht, do të marrin numrin  
25 e provës materiale 1D00141, dhe klasifikimi është publik.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Z. MISETIC: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, sikurse e përmendët dhe vetë para pak  
4 minutash, në këtë kohë ose pas disa javësh pasi kishte ndodhur  
5 kjo që diskutuam pak më herët, ishte periudha kur u negociua  
6 marrëveshja ndërmjet Holbrooke dhe Milosevic, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Domethënë, kjo është një marrëveshje që është negociuar  
9 diku nga mesi i tetorit të 1998, apo jo?

10 PË. Po, pak a shumë në atë kohë.

11 PY. A pajtoheni me mua që rrethanat në të cilat gjendej UÇK-  
12 ja, përfshirë këtu për shembull ofensivën serbe, personat e  
13 zhvendosur, gjithashtu dhe deklaratat dhe dokumentet e  
14 ndryshme të Kombeve të Bashkuara, ka ndodhur diku nga fundi i  
15 korrikut, deri në mes të tetorit 1998, dhe situata ka qenë  
16 goxha kaotike në atë periudhë, a pajtoheni me mua, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni vetëm një moment, ju  
19 lutem.

20 PY. A jeni në dijeni që pas marrëveshjes Milosevic-Holbrooke  
21 dhe pas marrëveshjes Geremek-Jovanovic, besoj që e dini çfarë  
22 është kjo marrëveshje e fundit, apo jo?

23 PË. Pak a shumë, po.

24 PY. Marrëveshja Geremek-Jovanovic ishte marrëveshje e OSBE-  
25 së, që i lejonte Misionit të Verifikimit në Kosovë që të

1 zhvendosej aty. A ju kujtohet kjo marrëveshje, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 PY. Edhe kjo marrëveshje ka ngjarë, ose është zhvilluar në  
4 mes të tetorit të 1998, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. A ju kujtohet që të keni folur me UÇK-në ose a ju  
7 kujtohet që UÇK-ja të ketë pasur një lloj mundësie për të  
8 marrë frymë, në qoftë se do shprehesha figurativisht për shkak  
9 të armëpushimit gjatë kësaj periudhe?

10 PË. Po.

11 PY. A ju kujtohet që këto marrëveshje dhe zhvendosja ose  
12 dislokimi i Misionit të Verifikimit të Kosovës dhe kjo, shefi  
13 i Shtabit i UÇK-së urdhëruan formimin e një gjykate ushtarake,  
14 a keni dëgjuar ndonjëherë lidhur me këtë?

15 PË. Jo.

16 PY. Nuk e keni dëgjuar asnjëherë praninë e një gjykate  
17 ushtarake në UÇK?

18 PË. Jo, kjo nuk ishte pjesë e përgjegjësive të mia.

19 PY. A e njihni një person që quhet Sokol Dobruna?

20 PË. Nuk besoj, në qoftë se më tregoni fotografi mbase edhe e  
21 njoh.

22 PY. Ai ka qenë dikush që ka qenë shefi i gjykatës ushtarake  
23 të UÇK-së. Por nuk është se ju kujtohet, apo jo, Dëshmitar?

24 PË. Jo, nuk besoj se më kujtohet.

25 PY. A jeni në dijeni që pas marrëveshjes Milosevic-Holbrooke

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 88

1 dhe marrëveshjes Geremek-Jovanovic, KNKK-ja ka pasur mundësi  
2 që të ketë qasje në disa prej personave të ndaluar nga UÇK-ja?  
3 PË. Jo.

4 PY. A jeni në dijeni që pas marrëveshjes Geremek-Jovanovic  
5 dhe dislokimit të Misionit të Verifikimit të Kosovës, OSBE-ja  
6 ka pasur mundësi që të ketë qasje tek disa të ndaluar, të  
7 mbajtur nga UÇK-ja?

8 PË. Jo.

9 PY. Tani do t'ju tregoj një dokument të KNKK-së.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Të paraqesim në ekran dokumentin  
11 DHT03010 deri në DHT03089.

12 PY. Dëshmitar, ky është një raport që është hartuar nga KNKK-  
13 ja, Kryqi i Kuq, këshilli i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar. Nuk  
14 besoj se e keni parë këtë dokument më herët, apo jo,  
15 Dëshmitar? Është një dokument i prillit të 2023.

16 PË. Jo, nuk e kam parë.

17 PY. Është një raport për grupet e armatosura joshtetërore dhe  
18 detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim faqen 55 në fund që mban  
20 numrin e identifikimit DHT3064. Po jua tregoj këtë pjesë sepse  
21 keni përmendur Konventat e Gjenevës në deklaratën tuaj, kështu  
22 që thjesht dua t'ju pyes se si i kuptoni ju detyrimet që  
23 rrjedhin nga Konventat e Gjenevës. Në fund të këtij dokumenti  
24 flitet për përcaktimin e kushteve dhe procedurat për shmangien  
25 e ndalimit arbitrar. Thuhet më tej që:



1 "Për të parandaluar që njerëzit të internohen dhe të  
2 ndalohen për arsye të vagullta dhe pa kontroll efektiv, duhet  
3 që të përcaktohen arsyet dhe procedurat për ndalimin dhe ato  
4 duhet që të pasqyrohen në sistemin e brendshëm disiplinor të  
5 grupeve joshtetërore të armatosura. Dhe për këtë arsye grupet  
6 shtetërore jo të armatosura duhej që të japin shkaqe dhe  
7 procedura për ndalimin në rregulloret e tyre të cilat duhet të  
8 pasqyrohen në ligjet e tyre, rregulloret e tyre, kodet e  
9 sjelljes, urdhrat e përgjithshme ose udhëzime të ngjashme.  
10 Përcaktimi i arsyeve dhe procedurave për, duhet gjithashtu të  
11 bëhet për të arritur transparencë dhe për të pasur më shumë  
12 parashikueshmëri njerëzit të cilët janë objekt i ndalimeve, në  
13 veçanti kur flitet për grupe të armatosura joshtetërore."

14 Pyetja që kam për juve është kjo, në verën e vitit 1998,  
15 a i njihnit detyrimet ndërkombëtare që rridhnin nga dokumentet  
16 ndërkombëtare sa i takon ndalimit ose internimit të  
17 paligjshëm?

18 PË. Jo.

19 PY. A keni ndonjë lloj formimi juridik ju vetë si person?

20 PË. Jo, kam një trajnim shumë sipërfaqësor për të drejtën  
21 ndërkombëtare. Dhe nuk është se jam jurist me profesion, nuk  
22 jam person i së drejtës, por kam një njohuri të përgjithshme  
23 për të cilën jam shumë krenar.

24 PY. Në rregull. Tani kalojmë tek pjesa tjetër.

25 "KNKK-ja kupton që në praktikë rregullat duhet që,

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 90

1 kërkojnë kohë, zakonisht për t'u prezantuar, por të paktën  
2 grupet e armatosura joshtetërore në qoftë se nuk i kanë  
3 procedurat dhe shkaqet e tilla për ndalimin e njerëzve, duhet  
4 së paku të marrin hapat e nevojshme sa i takon përkufizimit  
5 dhe zbatimit të tyre pa vonesa."

6 Mbështetur në atë çfarë na thatë si përgjigje pak më  
7 herët, besoj që ju nuk jeni në dijeni se sa kohë i duhet  
8 grupeve të armatosura joshtetërore që të përmbushin dhe të  
9 respektojnë detyrimet ndërkombëtare, apo jo?

10 PË. Po, e saktë.

11 PY. Përderisa nuk e dini që shefi i Shtabit të UÇK-së ka  
12 urdhëruar formimin e Gjykatës ushtarake dhe ka caktuar një  
13 person përgjegjës për këtë gjykatë, ju nuk dini as faktin që  
14 puna e z. Thaçi ka qenë që të mbikëqyrte funksionimin e  
15 gjykatës ushtarake. A është e drejtë kjo të thuhet, Dëshmitar?

16 PË. Po. Nuk kam informacion lidhur me këtë.

17 PY. Dëshmitar, tani kam disa pyetje të tjera vijuese. Le të  
18 shohim deklaratën tuaj në çështjen Limaj.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal është dokumenti  
20 U008-1323 deri U008-1333. Paragrafi 19 në faqen U008-1329.

21 PY. Është deklarata juaj e dëshmitarit, sa për t'ju  
22 orientuar. Domethënë është deklarata juaj si dëshmitar përpara  
23 TPNJ-së. Jo dëshmia që keni dhënë në gjyq, por deklarata. E  
24 qartë?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani le të shkojmë te faqja që

1 sapo citova më herët.

2 PY. Në paragrafin 19, ju përshkruani, ose thoni, që kur  
3 mësuat që z. Thaçi ishte Numri 3, dhe më tej thoni që:

4 "Në takimet që përshkruhen më sipër, që janë realizuar  
5 gjatë korrikut dhe fillimit të gushtit të 1998..."

6 E lexova gabim, ju kërktoj ndjesë. Atëherë:

7 "Pas fillimit të gushtit, ne filluam që të përqendrohemi  
8 në çështjet humanitare. U takova me Hashim Thaçin disa herë në  
9 disa raste. Dhe shpeshherë ai shoqërohej nga komandant Çeliku.  
10 Çeliku zakonisht e shoqëronte Thaçin në takimet me mua, dhe me  
11 të dërguarin e posaçëm të BE-së Wolfgang Petrovic [Sipas  
12 përkthimit]. Këto takime shpesh janë zhvilluar në Banjë ose në  
13 afërsi të Banjës, që ishte fshati i lindjes i Limajt. Kur jam  
14 takuar me Hashim Thaçin në korrik të 1998, takimet janë  
15 organizuar nga personat që unë i njihja që ishin gazetarë.  
16 Thaçi më ishte prezantuar si "Numri 3". Nuk më interesonte  
17 emri i tij, por shumë shpejt gjatë luftës ai më tepër u bë një  
18 figurë politike se sa figurë ushtarake dhe ishte e pamundur të  
19 mos ia dije emrin atij."

20 A ju kujtohet kjo pjesë, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Në këtë dëshmi sugjerohet që ju nuk e keni mësuar emrin e  
23 vërtetë të z. Thaçi deri më 23 korrik të 1999, apo jo?

24 PË. Jo. Mendoj që mua më është thënë emri i tij nga Dukagjin  
25 Gorani, ose para takimit ose pas takimit, i cili ky Dukagjin

1 Gorani e njihte Hashim Thaçin nga universiteti. Megjithatë,  
2 për mua nuk është se kishte rëndësi emri i tij, sepse për mua  
3 ishte e rëndësishme që ai u prezantua si Treshi, si Numri 3.  
4 Emri i tij nuk ishte informacion që e dinte publiku, kështu që  
5 për arsye të raportit, për shkrimin e raportit, thjesht  
6 përdora Numrin 3. Por vetëm kur emri i tij u bë publik atëherë  
7 unë vendosa që të përdorja emrin e tij gjithashtu të plotë.  
8 PY. Po a pajtoheni me mua që në këtë paragrafin ju thoni që  
9 nuk ishit i interesuar për të ditur emrin e tij, megjithatë  
10 shumë shpejt në luftë kur ai u bë figurë politike, nuk kishte  
11 si të mos ia dije emrin atij. Domethënë, ju këtu nuk përmendni  
12 as Dukagjinin as ndokënd tjetër që mund t'ua ketë thënë emrin.  
13 PË. Jo, nuk mund ta shmangia dot emrin e tij dhe atëherë  
14 fillova dhe vetë ta përdorja emrin e tij të plotë. Sikurse e  
15 thashë pas takimit të parë, m'u desh shumë kohë, pra u desh që  
16 të prisnim shumë kohë derisa të organizonim një tjetër takim,  
17 pra takimin e dytë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dua që të  
19 kërkoj pranimin në provë gjyqësore të këtij dokumenti.  
20 Atëherë, për sqarime, dua të them që thjesht dua që kjo faqe  
21 të mund të pranohet si provë gjyqësore.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
23 kundërshtime?

24 Z. CAPIN: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 93

1 U008-1323-U008-1333 do pranohet në provë materiale.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj që edhe faqja ballore duhet  
3 që të pranohet si provë materiale.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po atëherë na  
5 thoni numrin e referencës të kësaj faqeje.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Është U008-1323.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Është e gjithë gama e dokumentit,  
9 të gjitha fletët, të gjitha faqet, por dua vetëm që dy faqe  
10 nga ky dokument të mund të pranohen si prova materiale,  
11 prandaj bëra edhe sqarimin përpara.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të dyja këto  
13 faqe do pranohen në një numër prove.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto dy dokumente, pra  
15 dy faqet e këtij dokumenti, do marrin numrin e provës  
16 materiale P12003 [Sipas përkthimit]. Do të klasifikohen si  
17 konfidenciale.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Ka ndaluar transkripti, i nderuar  
19 Gjykatës. Besoj se kjo është e vërtetë për të gjithë.

20 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës  
21 këshillohen]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj që jemi  
23 në rregull. Mund të vazhdoni, z. Misetiç.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

25 PY. Dëshmitar, atëherë, të flasim për atë çfarë ju po

1 diskutonit, pra takimin me z. Thaçi përpara se sa të na  
2 ndërpriste çështja e transkriptit. Tani do kërkoj që t'i  
3 kushtojmë pak rëndësi asaj çfarë keni thënë përpara Trupit  
4 Gjykues për çështjen Limaj.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë kërkoj që të paraqitet  
6 dokumenti IT-03-66 T667 deri në T767. Ju kërkoj ndjesë se  
7 është provë materiale e pranuar, kështu që do jap numrin e  
8 provës materiale. Është prova materiale P1209. Ndoshta nuk do  
9 na duhet fare, megjithatë do t'ju bëj pyetje në mënyrë të  
10 drejtpërdrejtë.

11 Jo, do ishte më mirë që ta shfaqim në ekran. Për  
12 Sekretaren, paraqisni dokumentin 6, ose faqen 639 [Sipas  
13 përkthimit], duke filluar që nga faqja, nga rreshti 4 [Sipas  
14 përkthimit]. [Korrigjim i përkthyesit: Nga rreshti 24].

15 PY. Atëherë, ju bëjnë pyetje:

16 "Z. Kickert, a vazhduat që të takoheshit me UÇK-në pas  
17 korrikut të 1998?"

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Vazhdojmë tek faqja tjetër.

19 PY. Përgjigja juaj është kjo:

20 "Jo. Këto takime u ndërprejnë sepse nga mesi i korrikut të  
21 1998 forcat e sigurimit serb lançuan një ofensivë. Kështu që  
22 vendet ku zakonisht takohesha me ta, nuk ishin më vende me të  
23 cilat, ku mund të takohesha me ta. Më pas në 1998, në gusht të  
24 1998, ne i kemi përqendruar veprimtaritë tona më tepër te  
25 kriza e personave të zhvendosur. Përgjatë ofensivës së forcave

1 të sigurimit serb, shumë persona u dëbuan nga shtëpitë e tyre,  
2 kështu që në gusht ne u munduam të gjenim se si mund ta  
3 trajtonim këtë çështje. Kështu që në atë kohë u bë një  
4 përpjekje për negociatë me ekipin e përfaqësuesve të LDK-së  
5 nga Shtetet e Bashkuara. Ky vendim u miratua nga Grupi i  
6 Kontaktit. Kështu që UÇK-ja nuk ishte më e mirëpritur në këtë  
7 ekip negocimi.

8 "PY. Megjithatë, pavarësisht kësaj, a keni pasur shumë  
9 mundësi që të takoheshit me komandant Çelikutun sërish gjatë  
10 1998?"

11 Përgjigjja që ju jepni është:

12 "Po, më vonë në vjeshtën e 1998, kur KVM-ja ose Misioni i  
13 Verifikimit të Kosovës së OSBE-së u krijua, ne kemi pasur  
14 kontakte me përfaqësues të UÇK-së përsëri. Kryesisht kemi pas  
15 kontakte me Hashim Thaçin."

16 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

17 PË. Po, më kujtohet.

18 PY. Me si e kuptoj unë dëshminë tuaj, është që jeni takuar  
19 një herë në korrik 1998 me Hashim Thaçin, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe pastaj nuk jeni takuar më derisa u dislokua KVM-ja në  
22 Kosovë, apo jo?

23 PË. Po, kështu e di unë.

24 PY. Po ne e dimë Misioni Verifikues i Kosovës është vendos në  
25 Kosovë në vitin 1998, në gjysmën e dytë të vitit 1998, kështu

1 që i takon që në rastin më të mirë jeni takuar për herë të  
2 dytë me Hashim Thaçin gjatë gjysmës së dytë të 1998, apo jo?

3 PË. Me shumë të ngjarë, po.

4 PY. Te ky fragmenti ju thoni që "takimet janë bërë kryesisht  
5 me përfaqësuesit e LDK-së", dhe thoni këtu që Kombet e  
6 Bashkuara po mundoheshin që të negocionin me përfaqësuesit e  
7 LDK-së në emër të shqiptarëve të Kosovës?

8 PË. Po.

9 PY. Atëherë, qëndrimi i përgjithshëm ka qenë që UÇK-ja ishte  
10 e përjashtuar që të merrte pjesë në takime të tilla apo që të  
11 jepnin kontributet e tyre për negociatat ndërkombëtare?

12 PË. Po, kishte një lloj hezitimi nga disa diplomatë amerikanë  
13 për të përfshirë UÇK-në.

14 PY. Dhe ky ishte qëndrim i Grupit të Kontaktit pastaj?

15 PË. Po. Domethënë, fillimisht ishte mendimi i disa  
16 diplomatëve, pastaj u miratua kjo qasje nga Grupi i Kontaktit,  
17 sepse sigurisht për shkak të faktit që rusët nuk e donin  
18 asnjëherë të përfshirë UÇK-në që në fillim.

19 PY. A ju kujtohet në qoftë se LDK-ja ka pas një qëndrim për  
20 përjashtimin e UÇK-së nga ekipi negociues?

21 PË. Ka pasur një ilustrim me kartona shumë interesant në  
22 *Kohën Ditore* që qarkullonte në atë kohë, ku njëri person ishte  
23 i lidhur me stolin ku ishte ulur, kështu që ata gjithmonë  
24 mundoheshin që një fraksion të mund ta përjashtonin dhe  
25 megjithëse ekzistonte në përgjithësi nevoja ose dëshira që të



1 kishte grupe të ndryshëm dhe fraksione të ndryshme të cilat  
2 ishin të përfshira në negociata për të bërë të mundur dhënien  
3 e qëndrimit të të gjithë shqiptarëve të Kosovës.

4 LDK-ja nuk kishte qasje miqësore ndaj UÇK-së. Në fillim  
5 bilel mohuan edhe ekzistencën e UÇK-së. Ne po ashtu kishim  
6 FARK-un, grupi i armatosur që financohej nga LDK-ja dhe  
7 qeveria e tyre në ekzil. Pra, kishte përplasje, fërkime,  
8 politike, por besoj që këto fërkime ishin edhe në terren.

9 PY. Kur thoni "LDK-ja nuk kishte qasje miqësore ndaj UÇK-së",  
10 a mund të na shpjegoni për çfarë e keni fjalën?

11 PË. Ishin rivalë politikë.

12 PY. Pse LDK-ja e perceptonte UÇK-në si rival?

13 PË. Kërcënim ndaj monopolit të tyre politik.

14 PY. Monopoli i LDK-së, monopoli politik i LDK-së?

15 PË. Po.

16 PY. Faleminderit. Edhe përsëri, pra në gjykimin ndaj Limaj, i  
17 njëjti dokument që kemi në ekran.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë tek  
19 faqja 739. Në qoftë se mund të kalojmë tek rreshti 17.

20 PY. Aty ju bëhet pyetja juve, pyetja është:

21 "Natyrisht ju deklaroni që deri rreth fundit të vitit  
22 1998, ju jeni takuar me z. Limaj bashkë me z. Thaçi", në  
23 Banjë, besoj që do të duhej të ishte.

24 PË. Saktë.

25 PY. Përgjigjja juaj është:

1 "Është e saktë, një takim me ambasadorin Petritsch ku kam  
2 qenë edhe unë i pranishëm."

3 PË. Po.

4 PY. "PY. Ka ndodh edhe kjo rreth nëntorit 1998?"

5 Përgjigje:

6 "Mund të jetë, ka qenë dimër, është e sigurt me mjegull  
7 dhe besoj që ka qenë vonë. Dhe ne u kthyem dhe na thirrën në  
8 telefon ata në celular që të ktheheshim sepse takimi, me  
9 qëllim që takimi të bëhej."

10 A -- a ju kujton, a ju freskon kjo kujtesën lidhur me  
11 takimin, datën, momentin kur është bërë takimi me z. Thaçi dhe  
12 Limaj?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe kjo prapë duket të ketë ndodhur në dimër të 1998, siç  
15 e thatë edhe ju?

16 PË. Po.

17 PY. Më lejoni të tregoj një artikull të gazetës nga --  
18 shqiptimi im në frëngjisht i dobët është, por tani gjermanisht  
19 do të jetë ndoshta edhe më --

20 PË. Edhe më keq.

21 PY. Le ta themi kështu, pra që nuk është i saktë. Por do të  
22 përdor anglishten, *Der Standard*.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Dokumenti është DHT915, në  
24 versionin në anglisht [Sipas përkthimit] dhe DHT915-ET në  
25 anglisht. Është artikull që është publikuar më 14, 15 nëntor

1 1998 kur raportohet takimi që z. Petritsch ka bërë me  
2 përfaqësuesit. Në gjermanisht mund të dalim pak më sipër, ta  
3 shohim pjesën pak më sipër. Është një fotografi shpresoj që ta  
4 zmadhojmë atë që të, pa humbur mundësinë për të lexuar  
5 tekstin. Në pjesën e poshtme të djathtë në ekran ku thuhet  
6 "Kërkesë e z. Petritsch", shiheni. Mund ta lexoni këtë,  
7 Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Aty lexon:

10 "Petritsch u takua me përfaqësues të UÇK-së, përfaqësuesi  
11 i veçantë i BE-së për Kosovën, ambasadori austriak në Beograd  
12 Wolfgang Petritsch, u takua me një delegacion nga lëvizja  
13 klandestine e shqiptarëve të Kosovës, ushtria klandestine,  
14 UÇK-ja. Propozimi për një zgjidhje të përkohshme i paraqitur  
15 nga Shtetet e Bashkuara, u diskutua të enjten. Agjencia e  
16 lajmeve Beta në Beograd raportoi kështu të premtën duke cituar  
17 një raport në gjuhën shqipe, në gazetën në gjuhën shqipe, *Koha*  
18 *Ditore*, pa pjesëmarrjen e ushtrisë klandestine nuk mund të  
19 kishte proces politik të qëndrueshëm, deklaroi Petritsch".

20 Versioni në anglisht pasqyron atë që është në  
21 gjermanisht?

22 PË. Po.

23 PY. A ju kujton kjo juve takimin me z. Thaçi në mes të  
24 nëntorit 1998 dhe z. Petritsch?

25 PË. Mund të jetë ky takim, po.

1 PY. Është në nëntor, thjesht thuhet nëntor, dhe ju sapo thatë  
2 nëntor, në dimër të 1998?

3 PË. Saktë.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Gjykatës, parashtroj këtë  
5 artikull gazete që të pranohet si provë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë  
7 kundërshtim?

8 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
10 DHT03915 në gjermanisht dhe anglisht pranohet.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë  
12 numrin e provës së protokolluar 1D00143, klasifikohet si  
13 publik.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Do t'ju tregoj një artikull tjetër  
17 gazete, Dëshmitar. Dokumenti mban numrin DHT03916, në shqip,  
18 në buletin e LDK-së, dhe në anglisht është DHT03916-ET. Kjo  
19 është e datës 3 dhjetor 1998.

20 PY. Do t'jua lexoj raportin. Aty thuhet -- më lejoni të lexoj  
21 titullin:

22 "Një delegacion i drejtorisë politike të UÇK-së takohet  
23 me Wolfgang Petritsch."

24 Është raport i datës 5 dhjetor, dhe lexon:

25 "Më 3 dhjetor 1998, një delegacion i drejtorisë politike

1 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i përbërë nga Hashim Thaçi  
2 dhe Bardhyl Mahmuti, u takua me z. Wolfgang Petritsch,  
3 komisioneri i Bashkimit Evropian për Kosovën dhe delegacionin  
4 e tij, si dhe z. Jan Kickert, sekretar i ambasadës austriake  
5 në Beograd dhe një delegacion nga Ministria e Punëve të  
6 Jashtme të Austrisë.

7 "Takimi u organizua pas, në bazë të ftesës nga, të z.  
8 Petritsch dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Austrisë.

9 "Gjatë takimit u bisedua, u trajtua, diskutua gjendja  
10 politike në rajon dhe tendenca e përkeqësimit dhe si dhe  
11 provokimet e fundit të forcave serbe që kanë provokuar  
12 seriozisht në mënyrë të rëndë vetëpërmbytjen tonë.  
13 Gjithashtu, u bisedua rreth projektit Hill-Petritsch lidhur me  
14 zgjidhjen për Kosovën, problemin e Kosovës dhe procesin  
15 politik, si një nevojë e pakapërcyeshme për zgjidhjen e  
16 çështjes së Kosovës. Dy palët u pajtuan për nevojën për të  
17 organizuar një konferencë ndërkombëtare për Kosovën, raporton  
18 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së."

19 Tani, Dëshmitar, ju tashmë keni thënë që keni qenë i  
20 pranishëm në këtë takim, ju kujtohet një takim ku z. Thaçi dhe  
21 z. Mahmuti ishin të pranishëm?

22 PË. Po përpiqem të kujtoj se ku është zhvilluar ky takim.

23 PY. Unë, po ju them ky takim është mbajtur në Vjenë.

24 PË. Besoj që keni të drejtë.

25 PY. Në rregull, ju kujtohet që keni zhvilluar një takim me ta

1 në Vjenë?

2 PË. Po, tani që më rifreskuat kujtesën.

3 PY. Ju kujtohet që përmbajtja e bisedimeve, diskutimeve,  
4 është siç është pasqyruar në artikullin e gazetës?

5 PË. Po. Gjithmonë bëhej fjalë për një dokument që është  
6 fillimisht përpiluar nga amerikanët pastaj është bërë dokument  
7 i përbashkët që do të duhej të ishte zgjidhja apo paqësimi apo  
8 sjellja e paqes, zgjidhja e konfliktit.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Gjykatës, dorëzoj këtë dokument  
10 si provë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë  
12 kundërshtim?

13 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk ka.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT616 [Sipas  
15 përkthimit] në shqip dhe anglisht, pranohet.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument merr numrin  
17 1D00144, dhe klasifikohet si publik.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. MISETIC: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, lidhur me çështjen e komunikimeve telefonike  
21 me z. Thaçi, duke patur parasysh se nuk jeni takuar për herë  
22 të dytë deri në mesin të nëntorit 1998, unë them që shkëmbimet  
23 tuaja, komunikimet tuaja telefonike nuk kanë ndodhur përpara  
24 nëntorit 1998.

25 PË. Nuk jam në gjendje t'ju jap një përgjigje.

1 PY. Në rregull. Duke patur parasysh këto bisedën, bisedat që  
2 kemi parë dhe dy artikujt e gazetave që u tregova, a do të  
3 thonit ju që z. Thaçi ishte personi që po përpiqej të gjente  
4 një zgjidhje ushtarake apo politike për konfliktin.

5 PË. Ai ishte pika jonë e kontaktit për zgjidhje politike.

6 PY. Tani t'i kthehemi Rambujesë. Ju keni marrë pjesë në  
7 konferencën e Rambujesë në fillim të 1999.

8 PË. E saktë.

9 PY. Qëllimi juaj, roli juaj kryesor ka qenë që të  
10 ndërlihdeshit me delegacionin e Kosovës dhe të raportoni  
11 pastaj mbi punën e tyre, i raportoni ambasadorit Petritsch?

12 PË. E saktë.

13 PY. Ju i thatë, i keni thënë ZPS-së në deklaratën tuaj në  
14 paragrafin 57 që përshtypja juaj në Rambuje ka qenë se përpara  
15 nënshkrimit të marrëveshjes z. Thaçi duhej të konsultohet me  
16 disa njerëz që, dhe që nuk guxonte të nënshkruante pa u  
17 konsultuar me ta, është e saktë?

18 PË. E saktë.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse mund t'ju tregoj një provë,  
20 një dëshmi tjetër. Dokumenti me numër IT-05-87 P02658 në  
21 versionin origjinal gjermanisht, me të njëjtin numër në  
22 përkthimin anglisht.

23 PY. E njihni këtë dokument, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. A mund të na thoni se çfarë është?

1 PË. Është raport që kam përpiluar në fund të bisedimeve në  
2 Rambuje, duke bërë një përmbledhje të tyre, të këtyre  
3 bisedimeve. Kisha -- doja ta kisha sepse s'e kam parë që kur e  
4 kam përpiluar, me sa më kujtoheshe, shumë mirë që e kam këtu.

5 PY. Do ta shikojmë pastaj. Së pari, do t'ju pyes a jeni ju  
6 autori i këtij dokumenti? E keni përpiluar ju?

7 PË. Po.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në  
9 faqen 2, ju lutem. Këtu jemi.

10 PY. Paragrafi që është i dyti nga fundi, ku fillon me fjalën  
11 "Thaçi", e shikoni këtë? Është në versionin anglisht, kërkoj  
12 ndjesë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është në mes të faqes, z.  
14 Misetic.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, kërkoj ndjesë.

16 PY. Në mes të faqes, e shihni? Mos më kërkonit që ta lexoj në  
17 gjermanisht.

18 PË. Po përpigem të gjej pjesën në gjermanisht.

19 PY. Fillon me: "Delegacioni..."

20 PË. Po.

21 PY. Aty lexon, pra që:

22 "Thaçi, shefi i delegacionit..."

23 PË. Në gjermanisht kam shkruar:

24 "Shefi i delegacionit, Thaçi (UÇK) nuk ishte në gjendje  
25 të -- nuk ishte në nivel të përgjegjësive të tija, përgjegjësi



1 që kishte mbi supe".

2 Pra nuk ishte në gjendje të përballej, të merrte përsipër  
3 këto.

4 PY. Ajo që keni shkruar në gjermanisht është që z. Thaçi  
5 ishte shefi i delegacionit shqiptar dhe që ai vinte nga radhët  
6 e UÇK-së.

7 PË. E saktë.

8 PY. Pastaj, në versionin në anglisht thotë:

9 "... nuk ishte në gjendje të mbante, të merrte përsipër  
10 përgjegjësitë që i kishin rënë mbi supe dhe që i ishin dhënë  
11 atij nga komuniteti, bashkësia ndërkombëtare dhe komandantët e  
12 UÇK-së në terren."

13 PË. Kjo ishte ajo që krijova unë si përshtypje në Rambuje, që  
14 pashë, vërejta ai ishte vazhdimisht në komunikim telefonik.  
15 Dhe ajo që vërejtëm ne, vlerësimi jonë ishte se ai ishte nën  
16 një presion të jashtëzakonshëm që të mos nënshkruante  
17 marrëveshjen në Rambuje.

18 PY. Presion, kush ia bënte këtë presion?

19 PË. Presioni vinte nga UÇK-ja, por edhe nga Adem Demaçi që  
20 ishte një përfaqësues politik apo zëdhënës, përfaqësues  
21 politik nëse mund të themi i UÇK-së, i cili bëri -- ne kemi  
22 edhe organizuar një takim mes z. Thaçi dhe Adem Demaçit në  
23 Lubjanë në Slloveni. Jemi përpjekur me gjithë forcat tona që  
24 ta bindim atë. Biles, kemi sjellur aty edhe fituesin e Çmimit  
25 Nobel për Letërsi, që ta bindë atë. Por ai nuk ishte në një

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 106

1 pozitë që të nënshkruante këtë marrëveshje.

2 PY. A e dini pse komandantët e UÇK-së kundërshtonin  
3 nënshkrimin e këtij, kësaj marrëveshje?

4 PË. Ajo që u pa pastaj më vonë është sepse kishte, përfshinte  
5 edhe zhbërjen e UÇK-së.

6 PY. Në rregull.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani, dorëzoj këtë raport si  
8 provë, z. Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] IT-05-87  
10 P02658 në gjermanisht dhe anglisht pranohet.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Z. Kryetar, këtij  
12 dokumenti i jepet numri ID00145 [Sipas përkthimit] dhe  
13 klasifikohet publik.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

16 PY. Ju thatë që komandantët në terren ishin kundër zhbërjes  
17 së UÇK-së, zhbërjes së UÇK-së. Po ashtu fakt që bashkësia  
18 ndërkombëtare në Rambuje këmbëngulte, ky ishte kushti absolut  
19 i panegociueshëm me qëllim që të arrihej marrëveshja, është e  
20 saktë?

21 PË. E saktë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim një  
23 tjetër korrespondencë diplomatike, mban numrin IT-05-87,  
24 P02660, në versionin origjinal në gjermanisht dhe i njëjti  
25 numër në versionin anglisht.

1 PY. Dëshmitar, e njihni këtë dokument?

2 PË. Po.

3 PY. E çfarë është?

4 PË. Është raport që kam përpiluar në Rambuje. Mënyra se si  
5 kam komunikuar është që i kam komunikuar këtë ambasadës në  
6 Beograd me një kod, me kode të caktuara, dhe pastaj ata ia  
7 kanë dorëzuar këtë rrjetit të Ministrisë së Jashtme, të Punëve  
8 të Jashtme.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në  
10 faqen 2 të dokumentit, ju lutem, i cili mban datën 22 shkurt  
11 1999. Në krye të faqes në version anglisht.

12 PY. Aty thuhet që:

13 "Thaçi thuhet të ketë -- të jetë shprehur në favor të  
14 vazhdimit..."

15 Paragrafi i dytë në gjermanisht, aty është. Paragrafin i  
16 dytë, po. Pra:

17 "Thaçi thuhet të ketë, të jetë shprehur në favor të  
18 vazhdimit të luftës së armatosur të UÇK-së. Nga Tirana ne  
19 mësuam se tani UÇK-ja për herë të parë kishte emëruar  
20 komandantin suprem Sylejman Selimi, i cili deri tani kishte  
21 qenë komandant i zonës, pjesës së Drenicës, që vlerësohej si  
22 ekstremiste. Në një përpjekje të fundit, kosovarët donin që të  
23 hiqnin fjalët apo formulimin "një mekanizëm për", dhe ta  
24 zëvendësonin me "populli", dhe "populli i tij".

25 Dhe pastaj tre objektivat e bisedimeve, janë:

1 "një referendum pas një periudhe të përkohshme,  
2 "vazhdimi, ekzistenca e vazhdueshme e UÇK-së dhe  
3 transformimi i saj në një lloj xhandarmërie... dhe  
4 "stacionimi i trupave të NATO-s."

5 Pastaj vazhdon:

6 "Delegacioni kosovar u informua nga Albright, në mes të  
7 tjerëve, se referendumi dhe ekzistenca e vazhdueshme e UÇK-së  
8 nuk mund të pranoheshin. Gjithashtu, theksoi lidhjen, lidhur  
9 me këtë, theksoi pasojat e rënda dhe të pariparueshme të në  
10 rast se kosovarët apo shqiptarët e [E padëgjueshme] e hidhnin  
11 poshtë apo e refuzonin marrëveshjen paraprake."

12 Z. MISETIC: [Përkthim] E dorëzoj këtë dokument si provë.

13 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] IT-05-87

15 P002660 në gjermanisht dhe anglisht pranohet.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Një korrigjim i vogël.

17 Dokumenti IT-05-87 P002660 do të pranohet si ID00146 [Sipas  
18 përkthimit]. Klasifikimi është publik.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

21 PY. Tani, z. Dëshmitar, do t'ju tregoj një intervistë që z.  
22 Wolfgang Petritsch ka dhënë në 2017 dhe sipas asaj që i  
23 kujtohet atij, lidhur me atë, bisedimet në Rambuje, dhe shohim  
24 nëse kjo përputhet me atë që ju kujtohet juve.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Dokumenti është DHT03918 deri në

1 DHT03940-ET, të njëjtët numra janë në versionin origjinal  
2 gjermanisht, pa ET në fund. Dhe në qoftë se mund të kalojmë te  
3 faqja DHT03932, që duhet të jetë faqja 15 në dokument. Në  
4 qoftë se mund të zbres, të shohim pjesën në fund të faqes në  
5 anglisht.

6 PY. Pra, këtu aty i bëhet pyetja atij:

7 "Hashim Thaçi ishte pjesëtari më i ri i delegacionit të  
8 Kosovës, në atë kohë ishte 29 vjeç. Si e vlerësoni rolin e tij  
9 në atë kohë?

10 Dr. Petritsch përgjigjet:

11 "Mosha e Thaçit dhe mungesa e përvojës ishin dy faktorë  
12 të cilët ne duhej t'i merrnim parasysh. Më kujtohen bisedat e  
13 para personale me të, kur ai filloi të kuptojë ngadalë se  
14 ndoshta ishte përshpejtuar në qëndrimin e tij. Përfundimisht  
15 kjo do të thoshte marrja e përgjegjësisë për fatin jo vetëm të  
16 UÇK-së, por edhe të ardhmes së Kosovës në tërësi. Padyshim që  
17 ishte një barrë e rëndë për një negociator të papërvojë, por  
18 mësoi shumë shpejt.

19 "Dhe drejt fundit të negociatave, kur ministrat e punëve  
20 të jashtme u takuan në Rambuje për të dëgjuar nga shefat e dy  
21 ekipeve negociuese nëse tani mund të pajtoheshin për draftin  
22 në parim, Thaçi ishte i tërhequr, dukej që ishte i tërhequr,  
23 dhe dha përshtypjen që ishte, ishte i mbingarkuar dhe nuk  
24 arriti ta menaxhonte këtë situatë..."

25 E kishit ju këtë përshtypje në këtë pikë në Rambuje gjatë

1 bisedimeve?

2 PË. Po.

3 PY. Pastaj vazhdon dhe thotë.

4 "Në këtë gjendje pak minuta përpara takimit përfundimtar  
5 me ministrat e punëve të jashtme, Joschka Fischer dhe unë,  
6 patëm një -- nuk është ekzagjerim të themi, një bisedë të  
7 tendosur, dramatike me z. Thaçi sepse në -- gjatë, në gjendjen  
8 e panikut që ai gjendej ishte e qartë që ai nuk ishte, nuk  
9 donte të jepte një përgjigje të qartë sa i përket pyetjes  
10 kryesore, vendimtare, thelbësore, për Grupin e Kontaktit të  
11 mbledhur të ministrave të jashtëm, për t'u pajtuar dhe  
12 mundësisht për t'u përballur me një afat kohor për UÇK-në, apo  
13 të refuzonte dhe të shkaktonte dështimin e konferencës.  
14 Shkurtimisht përshkruan skenarët alternativë me të cilët [E  
15 padëgjueshme].

16 "Dhe pastaj kuptova, i dashur mik, se nuk kishit menduar  
17 për pasojat e marrjes përsipër të përgjegjësisë së  
18 lidërshiptit, të udhëheqjes së delegacionit, pra që duhej të  
19 nënshkruanin zhbërjen, zhbërjen e UÇK-së. Kjo ishte dhe pika  
20 kryesore e bisedimeve intensive që kisha me z. Thaçi në qoftë  
21 se ai pajtohej për çarmatimin e UÇK-së, pastaj, atëherë  
22 rrezikohej të shihej apo të vlerësohej si tradhtar i UÇK-së,  
23 dhe nuk ishte i sigurt nëse, as për jetën e tij nëse kthehej."

24 Kishit ju një pasqyrim, a reflekton kjo, pasqyron në  
25 mënyrë të saktë atë që ju keni kuptuar nga qëndrimi i Thaçit

1 në kohën apo pozitën në të cilën ai gjendej?

2 PË. Nuk do të konfirmoja këtë, që ai nuk ishte i sigurt për  
3 jetën e tij, pra këtë pjesë. Por ishte në një presion  
4 jashtëzakonisht të lartë dhe qartësisht nuk ishte në një  
5 pozicion që mund të merrte vendime. Nuk ishte në gjendje të  
6 dëgjonte atë që ne i thonim atij.

7 PY. Dhe arsyeja për këtë cila ishte?

8 PË. Ishte sepse ishte nën presion të jashtëzakonshëm nga të  
9 gjitha anët.

10 PY. A ishte në presion të jashtëzakonshëm që të mos zhbënte  
11 UÇK-në?

12 PË. UÇK-në.

13 PY. Do t'i kthehem tani intervistës në paragrafin ku thuhet,  
14 ku Dr. Petritsch thotë:

15 "Nuk ishte e qartë për neve vija e kuqe për Kosovarët që  
16 -- nuk ishte e qartë për neve që vija e kuqe, ajo që nuk duhej  
17 të tejkalohet, pra kufiri për Kosovarët ishte zhbërja e UÇK-  
18 së, dhe vija e kuqe për Beogradin ishte, ishin garancitë e  
19 sigurimit nga trupat ndërkombëtare në Kosovë, praktikisht  
20 trupa të huaja në territorin e Jugosllavisë."

21 Është e saktë?

22 PË. Është e saktë.

23 PY. Në qoftë se kalojmë në paragrafin e radhës, dua të shohim  
24 fjalinë e fundit në pjesën ku thotë. Pyetja ishte:

25 "A do ta -- lidhur me pritshmëritë pra të komunitetit, të

1 bashkësisë ndërkombëtare?"

2 Dhe pastaj fjalia e fundit lexon:

3 "Duhej, kjo ishte menduar që të ishte një proces  
4 konsultimi, me komandantët duhej të kishin një proces  
5 konsultimi me komandantët vendorë, për t'i bindur ata që të  
6 pajtoheshin me këtë marrëveshje."

7 Mund të lexoni paragrafin në tërësi.

8 PË. Ju lutem.

9 PY. Nëse dëshironi kontekstin.

10 PË. Po.

11 PY. A e kuptoni që në qoftë se do të arrihej një marrëveshje,  
12 duhej që të zhvillohej një proces ku ekipi negociator do të  
13 shkonte në Kosovë dhe të bisedonte me komandantët vendorë për  
14 t'i bindur ata që të pranonin këtë marrëveshje?

15 PË. Ishte e qartë që ne ishim në një pozicion ku, nuk ishim  
16 në një pozicion ku mund të arrijmë një marrëveshje në Rambuje.  
17 Pra ideja që u zhvillua pastaj që të kishte, ishte që kishim  
18 një kohë konsultimi dhe mund të ritakoheshim përsëri pas këtij  
19 konsultimi.

20 PY. Si pjesë e kohës së konsultimit, e pamë në pyetjet e  
21 Prokurorisë, përfshinin edhe z. Dr. Petritsch, dhe diplomatët  
22 e tjerë ndërkombëtarë që do të shkojnë dhe të takoheshin me  
23 komandantë vendorë për t'i bindur ata që të nënshkruanin këtë  
24 marrëveshje?

25 PË. E saktë.



1 PY. Dhe kjo ishte sepse kishit arritur në përfundimin se z.

2 Hashim Thaçi nuk mundej vetë të kishte, nuk kishte pra

3 autoritetin që të nënshkruante në emër të UÇK-së.

4 PË. E saktë.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, shoh që ka ardhur koha

6 e pushimit. Këtë intervistë mund ta dorëzoj si provë pra,

7 intervistën e z. Petritsch.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] E dorëzoj edhe këtë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju vetëm keni

11 renditur një faqe këtu. Do të jetë 33.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Saktësisht kjo është. Dorëzoj

13 DHT03932, dhe DHT03933.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të

15 pranohen.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto dy faqe do të

17 marrin numrin ID00147 [Sipas përkthimit]. Klasifikim

18 konfidencial.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë

20 pushimin e drekës.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

23 --- Seanca rifillon në orën 14.30

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,

25 përafërsisht dhe sa kohë mendoni se ju nevojitet?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Mendoj se do përfundoj brenda një  
2 ore, mbase dhe më pak.

3 Por meqë jam në këmbë dua të trajtoj një aspekt çështje  
4 organizimi. Prova e fundit materiale që u pranua, që ishte  
5 intervista e z. Petritsch me numër 1D147 aktual ka  
6 klasifikimin konfidencial dhe mendojmë që mund të jetë edhe  
7 publike. Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se  
9 Prokuroria nuk ka kundërshtime atëherë riklasifikohet.

10 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
12 Materiali riklasifikohet si material publik.

13 Tani mund të sillni dëshmitarin në sallë.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
16 Dëshmitar. Do të vazhdojmë me pyetjet nga Mbrojtja e Thaçit.

17 Z. Misetic, fjala është për ju.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

19 I lutem Sekretares së Gjykatës të vendosë në ekran provën  
20 materiale 1D145 në faqen 2.

21 Z. MISETIC: [Përkthim]

22 PY. Dhe mirëdita, Dëshmitar.

23 PË. Mirëdita.

24 PY. Do të vendos në ekran një dokument që e ke parë edhe më  
25 përpara. Është një korrespondencë që ka bërë trupi diplomatik

1 austriak. A ju kujtohet dokumenti?

2 PË. Po.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen 2. Shohim pikën  
4 ku fillon me "Marrëveshja bazë...".

5 PY. Në mes të ekranit në anglisht ku thuhet "Marrëveshja  
6 bazë...". E keni gjet në gjermanisht?

7 PË. Jo, nuk e kam gjetur as në gjermanisht.

8 PY. Po ju bëj të gjithëve për të qeshur sot -- një herë flas  
9 në frëngjisht, tani kjo. Do përpiqem ta them dhe këtë:

10 "Kosovarischerseits ..."?

11 PË. Mirë e the.

12 PY. Thotë:

13 "Marrëveshja bazë nga pala kosovare për 'deklaratën'  
14 njëpalëshe e cila u realizua pas një seance përfundimtare  
15 kaotike-dramatike ku Hill bërtiti: 'E doni apo s'e doni NATO-  
16 n?', dhe për këtë Surroi dhe jo Thaçi ka nënshkruar në orën  
17 16.20)".

18 E shihni?

19 PË. Po.

20 PY. Vijon:

21 "Ministria me faksimile më 23 shkurt."

22 "Delegacioni mund ta nënshkruante marrëveshjen vetëm pas  
23 14 ditësh, pasi u konsultuan njerëzit në Kosovë dhe  
24 institucionet në Kosovë."

25 Më pas vijon:

1 "Kosova do të mbante një referendum brenda tre vitesh."

2 Kjo është referendum për pavarësinë?

3 PË. Ky ka qenë qëndrimi i delegacionit të Kosovës,  
4 shqiptarëve të Kosovës.

5 Marrëveshja nuk e përmendte fjalën "referendum", vetë  
6 marrëveshja. Përshkruan në fakt, është në vetvete përshkruan  
7 vullnetin e personave".

8 PY. Dhe pika e tretë thotë:

9 "UÇK-ja synonte të transformohej në përputhje me  
10 marrëveshjen me mbështetje bilaterale (pra, të SHBA-së).

11 Fillimisht ne po flisnim se si komuniteti ndërkombëtar  
12 këmbëngulte që UÇK-ja të shpërbëhej. Në këtë pikë po flitet  
13 për transformim." Në atë kohë çfarë transformimi kanë dashur  
14 të bëjnë, e dini?

15 PË. Nuk e synonin domosdoshmërisht, por ata synonin të  
16 krijonin një forcë policore, pra, që UÇK-ja të kishte një ide,  
17 domethënë, të krijonte një forcë policore ku të drejtoheshin  
18 personat dhe ky ishte një shembull i dhënë nga Ambasadori  
19 Petritsch i mbështetur në përvojën austriake pas Luftës së  
20 Dytë Botërore, ne nuk patëm ushtri, por patëm një forcë  
21 speciale policore e cila më pas u transformua në një ushtri.

22 PY. Dhe thotë pastaj:

23 "... në përputhje me marrëveshjen...".

24 Sipas jush çfarë kanë dashur të thonë ata kur thonë që ky  
25 transformim do të jetë "në përputhje me marrëveshjen"? Ka pas

1 ndonjë dispozitë në marrëveshje për këtë?

2 PË. Nuk është përmendur ndonjë transformim konkret i UÇK-së,  
3 por ideja ishte që brenda marrëveshjes ose më saktë në kuadër  
4 të kësaj marrëveshje SHBA shihte një mundësi për transformimin  
5 e UÇK-së ose të paktën të një pjese të UÇK-së.

6 PY. Në rregull. Të flasim çfarë ndodhi më vonë. Ju keni thënë  
7 se ju dhe z. Petritsch më 5 mars të 1999-s u takuat me  
8 autoritetet lokale të UÇK-së dhe u përpoqët që t'i bindnit ata  
9 që të pajtoheshin me propozimin që ishte shtruar në Rambuje.

10 PË. Mbase nuk kishin UÇK lokale. Ata e shihnin veten madje si  
11 në krye të strukturës së UÇK-së.

12 PY. Në fakt, kur thashë lokale e kisha fjalën që lokal ata që  
13 ishin në Kosovë.

14 PË. Po, ata që ishin në Kosovë.

15 PY. Kam edhe një video të këtyre bisedimeve.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe për këtë doja të shihnim  
17 transkriptin që mban numrin 061427 -- më falni, është prova  
18 materiale P01221, sepse është një material që është pranuar si  
19 provë gjyqësore. Do lutesha të shkonim në faqen 14 të këtij  
20 dokumenti. Fillojmë në rreshtin 7.

21 PY. Është z. Petritsch ky që flet në video. Ju keni qenë i  
22 pranishëm apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Z. Petritsch thotë kështu:

25 "Por...", ia thotë këtë përfaqësuesit të UÇK-së, "...dua

1 të them diçka tjetër për UÇK-në; do të ekzistojë edhe mundësia  
2 që të ruajnë strukturat politike të UÇK-së dhe sa herë dhe  
3 çfarëdolloj zhvillimesh të ketë dhe sa herë që -- dhe kur të  
4 ketë një Kosovë të pavarur, unë besoj se do jeni shumë të  
5 shpejtë ju në krijimin e ushtrisë suaj. Por t'i marrim hap pas  
6 hapi...".

7 Sipas jush çfarë ka dashur të thotë z. Petritsch kur  
8 thotë "do të keni mundësinë ta ruani strukturën politike të  
9 UÇK-së"?

10 PË. Ka dashur të thotë që do të ishin pjesë përbërëse e çdo  
11 strukture politike, çfarë do të thotë, strukturë qeveritare  
12 pas luftës.

13 PY. Sipas jush, në atë kohë, strukturë politike, me strukturë  
14 politike i referoheshin përfaqësimit apo qeverisë së  
15 përkohshme të Kosovës që do të krijohet pas Rambujesë, në  
16 lidhje me këtë ishte qeveria?

17 PË. Përmendeshin, kishte dispozita për një strukturë  
18 qeveritare në marrëveshjen e Rambujesë. Nuk e mbaj mend  
19 përmendsh, sidomos pas 25 vitesh, kur ka pasur dispozita të  
20 tilla në marrëveshje dhe ka qenë dhe një marrëveshje e  
21 ndërmjetme kjo. Kjo nuk ishte një marrëveshje e përfundimtare.

22 PY. Por çfarë shohim në këtu është që z. Petritsch përpiqet  
23 që të bindë komandantët në terren dhe thotë, jepni pëlqimin  
24 për Rambujenë, për shpërbërjen e UÇK-së, sepse do të krijohet  
25 një strukturë tjetër, qeveria e përkohshme e Kosovës dhe aty

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 119

1 mund të vijoni të ekzistoni, por do jeni pjesë e një qeverie  
2 të përkohshme dhe jo pjesë e një ushtarake, jo një pjesë  
3 ushtarake.

4 PË. Një forcë politike. Transformimi në një forcë politike  
5 siç janë transferuar në të shkuarën forcat guerile.

6 PY. Dhe thelbi ishte që të bindeshin komandantët në terren,  
7 që të jepnin pëlqimin e tyre, por që të ndihmohej edhe z.  
8 Thaçi që t'i bindte ata.

9 PË. Po, pikërisht kjo. Sepse ata duhet të zgjidhnin --  
10 qëndrimin e tyre dhe statusin e tyre.

11 PY. Të flasim pak për krijimin e qeverisë së përkohshme të  
12 Kosovës dhe çfarë u diskutua në lidhje me këtë.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do të doja që të shfaqej  
14 në ekran një kabllogram nga trupi diplomatik amerikan. Ka  
15 numrin DHT01535 deri DHT01540, është kabllogram i 12 prillit  
16 1999.

17 PY. Me gjasë nuk e keni më përpara këtë dokument?

18 PË. Të drejtë keni.

19 PY. Mund ta shihni që këtu, përmendet -- thuhet që është e  
20 prillit në fund të ekranit thotë: Pjesëmarrës janë Sekretari i  
21 Shtetit Aleksandër Vershbow, James Dobbins, e dini kush janë  
22 këta persona?

23 PË. Për herë të parë kam parë që e ka përgatitur Larry  
24 Rossin, këtë e njoh kush ka qenë. Po, e kam njohur. Vershbow  
25 ka qenë përfaqësuesi i SHBA-së në NATO.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Në faqen tjetër.

2 PY. James Rubin ka qenë pjesëmarrës, e njihni?

3 PË. Patjetër që po. Ka qenë edhe në Rambuje; ka qenë, mund të  
4 themi, zëdhënësi i Madeleine Albright.

5 PY. David Scheffer, keni dëgjuar për të?

6 PË. Po.

7 PY. Thuhet që ka edhe pjesëmarrës nga UÇK-ja, Jakup Krasniqi  
8 dhe Bilal Sherifi. I shihni këto emra?

9 PË. Po.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

11 PY. Shihni, ju lutem, paragrafin 7 ku thuhet: Z. Krasniqi "ka  
12 bërë tri kërkesa konkrete në emër të shqiptarëve të Kosovës  
13 dhe të UÇK-së", dhe shohim pikën e fundit:

14 "Diplomatike: Njohja e 'Qeverisë së Përkohshme' të  
15 Kosovës së drejtuar nga Hashim Thaçi".

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Më poshtë.

17 PY. "Qeveria është krijuar në bazë të Marrëveshjes së  
18 Rambujesë. Ka edhe vende të rezervuara për Ligën [Sipas  
19 përkthimit] Demokratike të Kosovës, së Rugovës, të cilët  
20 sidoqoftë për shkak të presionit nga Millosheviqi dhe policia  
21 e tij nuk kanë qenë ende në gjendje të emërojnë anëtarët e  
22 tyre. Qeveria e re përbëhet nga të rinj me ide të reja të  
23 cilët kërkojnë një qeveri që është me orientim drejt  
24 perëndimit".

25 Do vazhdoj ta lexoj dokumentin.



1 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe për këtë do doja të shkonim dy  
2 faqe më përpara. Të shohim përgjigjen e Sekretarit. Shohim  
3 fundin e faqes.

4 PY. Thuhet:

5 "Sekretarja Albright theksoi nevojën për qeveri të  
6 përkohshme të shtrirë në gjithë Kosovën. Ishte mirë që kishin  
7 krijuar edhe vende për LDK-në dhe ishte e rëndësishme që të  
8 kontaktohej me Rugovën, por, ndonëse ne nuk mund ta njohim  
9 qeverinë e përkohshme, ne në praktikë duam të punojmë me të.  
10 Jemi të gjithë të paqartë sa i takon statusit të Rugovës. Ai  
11 duhet të ketë qenë nën tryzni, pasi ka bërë këtë deklaratën më  
12 të fundit për mbështetje për një marrëveshje politike..."

13 Keni qenë ju në dijeni për përpjekjet që janë bërë  
14 asokohe që Qeveria e Përkohshme e Kosovës të ishte qeveri e re  
15 e përkohshme qartazi, në vijim të fushatës së NATO-s, pas  
16 fushatës së NATO-s?

17 PË. Nuk më kujtohet të kem qenë pjesë e këtij diskutimi. Unë  
18 dhe Ambasadori Petritsch u larguam nga Beogradi ditën që  
19 filluan bombardimet dhe shkuam në Vjenë, u vendosëm në Vjenë.  
20 Ne kontaktuam -- ne shkuam dy herë në Malin e Zi nga Kroacia  
21 për të folur me Gjukanoviqin. Shpesh unë shkoja në Maqedoni  
22 ose siç quhet tani Maqedonia e Veriut dhe shkoja dhe në  
23 Shqipëri për të mbetur në kontakt me figurat e UÇK-së, si dhe  
24 të kujdesesha për personelin tonë atje të cilët u zhvendosën  
25 në Maqedoni.

1 PY. Në rregull. Kur filloi fushata e NATO-s, kjo ka ndodhur  
2 përpara çdo diskutimi të mundshëm për rezolutën e Këshillit të  
3 Sigurisë së Kombeve të Bashkuara ku do të vendosej më pas që  
4 UNMIK-u do të ishte fuqia ligjvënëse në Kosovë, kështu?

5 PË. Kështu është, por ne nuk kemi qenë të përfshirë me sa më  
6 kujtohet mua në këto -- bisedime, më falni, kur është  
7 diskutuar Rezoluta e Këshillit të Sigurisë nuk ka qenë as  
8 Ambasadori Petritsch. Ka qenë z. Ahtisaari; ai ka qenë personi  
9 përgjegjës.

10 PY. Në rregull, po e bëj kështu pyetjen: Kur UÇK-ja në mars u  
11 pajtua me marrëveshjen e Rambujesë, sipas teje, në bazë të  
12 kësaj marrëveshje çfarë do të ndodhte në Kosovë; çfarë  
13 strukturash qeveritare do të ngriheshin?

14 PË. Të jem i sigurtë në momentin që filloi lufta nuk mendoja  
15 më për këtë gjë. Ka qenë diçka që ishte e paimagjinueshme për  
16 ne. Kështu që nuk mund të them asgjë në lidhje me këtë. Pas  
17 luftës kur e kuptuam që UNMIK-u, domethënë, kur shkua me  
18 UNMIK-un atje e kuptuam që ekzistonte një qeveri e përkohshme  
19 në drejtimin e Hashim Thaçit. Edhe unë mund të them që kjo  
20 ishte në fakt në njëfarë mënyre mbivendosur me Administratën e  
21 Kombeve të Bashkuara, UNMIK-un që ishte përgjegjës për  
22 udhëheqjen e vendit sipas Rezolutës 1244.

23 PY. Po e dini ju që përpara se të bëhej një diskutim për  
24 krijimin e një administrate të OKB-së në Kosovë, ideja kishte  
25 qenë që do të krijohesh një qeveri e përkohshme e Kosovës, ku

1 nuk do të ishte pjesë vetëm UÇK-ja, por edhe parti të tjera  
2 politike.

3 PË. Po kjo ka qenë ideja, por do të ishte një kombinim në  
4 fakt i të gjithë përfaqësuesve të Kosovës dhe jo vetëm një  
5 fraksion i përfaqësuesve të Kosovës nga pikëpamja politike.

6 PY. Po e dinit ju që LDK-ja, siç e lexuam në kabllogram nuk  
7 po merrte pjesë?

8 PË. Gjatë bombardimeve ka qenë një takim ose dhe mbase dy  
9 takime mes z. Rugova dhe z. Millosheviq. Z. Rugova qëndroi në  
10 Kosovë dhe mund të them që u përdor si një rrugë -- u përdor  
11 mbase si vegël mund të themi. LDK-ja, ai ishte pak i  
12 diskretituar dhe këtë e konfirmova dhe i kontaktova pas  
13 bombardimeve kur u ktheva në qershor në 1999 ishin shumë të  
14 pasigurt dhe disa prej tyre madje as nuk deshën të më takonin  
15 dhe nuk shihnin ndonjë rol politik për veten e tyre. Kështu që  
16 ishin në disavantazh nëse mund ta them kështu.

17 PY. Po pse thoni ju që z. Rugova ka qenë një vegël dhe është  
18 diskretituar? Çfarë deshët të thonit me këto fjalë?

19 PË. Sepse kur je në një situatë që të marrin nga Prishtina  
20 dhe të çojnë në Beograd të takosh Millosheviqin, i njëjti  
21 person që po planifikonte Operacionin Patkoi, që u zbulua pas  
22 nga shërbimi informativ, i yni informativ që të spastronte  
23 Kosovën nga shqiptarët e Kosovës. Është e qartë që ai nuk ka  
24 dashur ta bëjë këtë, z. Rugova, pra, dhe as nuk mund ta  
25 shmangte këtë. Sepse ai në një mënyrë ishte një burg në

1 Prishtinë.

2 PY. Në sytë e kujt u diskreditua ai?

3 PË. E qartë që prej UÇK-së, por dhe nga populli i Kosovës në  
4 përgjithësi.

5 PY. Operacioni Patkoi çfarë informacioni keni marrë prej  
6 zbulimit në lidhje me këtë operacion?

7 PË. Informacioni ishte që forcat jugosllave dhe serbe do të  
8 dëbonin popullin shqiptar të Kosovës drejt vendeve fqinje,  
9 konkretisht drejt Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, por në  
10 formën e patkoit, nga qendra drejt periferisë dhe më pas drejt  
11 vendeve fqinje.

12 PY. Ky informacion i përpunuar, ju e morët nga shtetet  
13 partnere?

14 PË. Po, unë të paktën e kam marrë nga atasheu ynë ushtarak  
15 këtë informacion.

16 PY. Faleminderit. Tani do t'ju bëj disa pyetje do t'ju bëj  
17 këtë pyetje: Keni thënë në deklaratën tuaj për ZPS-në se si z.  
18 Thaçi dhe z. Veseli kanë "shprehur gatishmërinë e UÇK-së për  
19 të bashkëpunuar dhe për të krijuar një qeveri të unitetit  
20 kombëtar ose një tryezë të rrumbullakët", kështu?

21 PË. Kështu.

22 PY. Dhe i keni thënë ZPS-së se në takimet që keni pasur më  
23 pas me Jakup Krasniqin, Ramë Bujën dhe Fatmir Limajn më 30  
24 korrik u bë e qartë për ju që UÇK-ja po e diskutonte formimin  
25 e një qeverie, përfshirë këtu fraksione të ndryshme të

1 shqiptarëve të Kosovës, kështu?

2 PË. Kështu.

3 PY. Kjo ka qenë drejt fundit të korrikut 1998, kështu?

4 PË. Po, kështu, por dua të them diçka më shumë. Ideja ishte  
5 që të krijohet një platformë ku merrnin pjesë të gjithë  
6 shqiptarët e Kosovës, përfaqësuesit e ndryshëm të shqiptarëve  
7 të Kosovës; ata mund ta quanin qeveri, çfarë të donin, kjo për  
8 ne nuk ishte rëndësi. Mjaftonte që të ishte një grup i  
9 bashkuar që do të ishte në gjendje që të përfaqësonte vendin  
10 dhe të merrte pjesë në negociata, në negociata me Beogradin.

11 PY. Të flasim për situatën pas fushatës së NATO-s. Ky është  
12 momenti kur u kthyet në Kosovës, kështu?

13 PË. Kështu.

14 PY. Dhe ju çelët zyrën austriake në Prishtinë, saktë?

15 PË. Antena austriake, pra, ishte një degë e ambasadës  
16 austriake në Beograd. Duhet të jemi të kujdesshëm me  
17 emërtimin.

18 PY. Në rregull. Dhe në gusht u bëtë këshilltar politik i  
19 përfaqësuesit të mundshëm i Sekretarit të Përgjithshëm të  
20 UNMIK-ut që është z. Kouchner, kështu?

21 PË. Unë isha një prej këshilltarëve politikë. Ishim dy a tre  
22 këshilltarë politikë në përgjithësi.

23 PY. Edhe ju ishit ende duke shërbyer, pra, ju shërbyet në  
24 cilësinë e ndërlidhjes me palën shqiptare, kështu?

25 PË. Kështu.

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 126

1 PY. Çfarë detyrash kishit ju mes qershorit dhe gushtit kur  
2 punuat për antenën austriake apo degën austriake?

3 PË. Ne punonim në fushën e arsimit; ne kishim OJQ austriake  
4 që punonin në terren; unë po përpiqesha të punoja, të bindja  
5 UNMIK-un, por asokohe ende s'punoja për UNMIK-un, të  
6 financonte disa prej OJQ-ve, sepse UNMIK-u ishte përgjegjës  
7 për kontrollin e një territori pa pasur kurrfarë ideje si ta  
8 bënte këtë punë.

9 Ka qenë një oficer përgjegjës për arsimin në verën e '99-  
10 s. Shkurtimisht para se të fillonte viti shkollor, ku kishte  
11 dhjetëra e mijëra refugjatë që po ktheheshin në vend. OKB-ja  
12 ishte tejet e ngarkuar, por nuk pranonte emërtime dytësore,  
13 sepse nuk e lejonte politika e OKB-së. Kështu që po merresha  
14 me këtë aspekt.

15 Gjithashtu komunikoja me KFOR-in. Austria kishte një  
16 kontingjent të vetin brenda KFOR-it, ndonëse nuk jemi anëtar i  
17 NATO-s. Kështu që shkoja shpesh në Suharekë ku kishim edhe  
18 bazën ushtarake austriake.

19 PY. Përpara se të vijoj më tej, do të doja që të lutesha të  
20 më pranohej kabllogrami i SHBA-së.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Sepse nuk e bëra këtë në kohën e  
22 duhur, siç na ka këshilluar Trupi Gjykues. Kështu që ju lutem  
23 të pranoni dokumentin 015350 [Sipas përkthimit] DHT01540.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
25 kundërshtime?

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 127

1           Z. CAPIN: [Përkthim] Po, ka kundërshtime. Mendoj se  
2           dëshmitari tha që nuk e ka lexuar ndonjëherë këtë kabllogram.  
3           Nuk ka qenë as në Prishtinë në atë kohë edhe nuk ka asgjë për  
4           të thënë në lidhje me këtë dokument.

5           Z. MISETIC: [Përkthim] Po të paktën ai mund të  
6           evidentonte pjesëmarrësit në këtë takim edhe e dinte rolin e  
7           tyre.

8           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me  
9           numër DHT01535 deri në DHT01540 pranohet; do të marrë numrin e  
10          provës materiale.

11          SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin  
12          1D00148 dhe nuk kemi klasifikim të paktën në Legal Workflow  
13          për këtë dokument.

14          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
15          çaktivizuar]

16          Ju lutemi, para se të përfundoni me dëshmitarin desha të  
17          thosha që dokumenti që kishim shënuar për identifikim 1227 do  
18          të pranohet sipas rregullës 138, sepse përmbush kriterin *prima*  
19          *facie*; është autentik, është relevant edhe ka vlerë provuese e  
20          cila nuk tejkalohet nga asnjë efekt cenes. Po jua them këtë  
21          tani në qoftë se doni të bëni ndonjë pyetje në lidhje me këtë  
22          tani.

23          SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti me numër  
24          SPOE00203094 deri 203096 që u shënuar fillimisht për  
25          identifikim merr numrin e provës materiale P01227 dhe

1 klasifikimi është konfidencial.

2 Tani a mund të bëjmë dhe një sqarim ju lutem, sa i takon  
3 statusit të dokumentit 1D00148.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Ky dokument mund të jetë publik.

5 Z. MISETIC: [Përkthim]

6 PY. Dëshmitar, ju kërkojmë ndjesë për këtë ndërprerje. Kur u  
7 kthyet në Kosovë, i ndiqnit lajmet?

8 PË. Sigurisht.

9 PY. Flasim për lajmet në Kosovë.

10 PË. Po.

11 PY. I ndiqnit deklaratat që bënë udhëheqësit shqiptarë?

12 PË. Po.

13 PY. Në deklaratën për ZPS-në keni përshkruar edhe situatën me  
14 pakicat në Kosovë në 1999 dhe thoni se situata e serbëve ishte  
15 relativisht e komplikuar, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Ju thoni se ka pasur një eksod të serbëve nga Kosova,  
18 kështu?

19 PË. Kështu.

20 PY. Në paragrafin 61 të deklaratës për ZPS-në keni thënë,

21 "Sigurisht që kishte disa masa ndëshkimore ndaj serbëve

22 dhe ndaj romëve dhe romët akuzoheshin se ishin

23 kolaboracionistë me serbët në përgjithësi. Edhe gjithashtu

24 mendohej se romët plaçkitnit shtëpitë shqiptare dhe komuniteti

25 shqiptar i dëbonte familjet rome", kështu?



1 PË. Kështu.

2 PY. Çfarë ndëshkimi ose çfarë hakmarrje pati përkundrejt  
3 serbëve, nëse mund të shprehemi kështu?

4 PË. U dëbuan, u larguan, u zhvendosën, ka pasur edhe raste  
5 vrasjesh.

6 PY. Sipas jush, këto akte apo ky ndëshkim ishte në njëfarë  
7 mënyre shpagim për atë që ju kishte ndodhur shqiptarëve prej  
8 serbeve?

9 PË. Ky ishte hamendësimi, supozimi ynë.

10 PY. Duke qenë që keni thënë që keni ndjekur edhe deklaratat e  
11 udhëheqësve të Kosovës në atë kohë, a jeni, keni qenë i  
12 informuar për faktin se z. Thaçi ka bërë disa thirrje herë pas  
13 here sa i takon serbëve dhe qëndrimit të tyre në Kosovës për  
14 të ndërtuar një shoqëri multietnike?

15 PË. Mendoj se po.

16 PY. A ke pasur mundësi që t'i dëgjoni deklaratat të tilla nga  
17 z. Thaçi?

18 PË. Besoj se po, megjithëse nuk më kujtohen konkretisht sot  
19 këto.

20 PY. Tani do t'ju tregoj disa shembuj ilustrues.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Do kërkoj që të paraqitet në ekran  
22 prova materiale P1227, që sapo u pranua si provë e tillë.

23 PY. Titulli i kësaj memoje është "Zhvendosja e kontingjentit  
24 të KFOR-it". Do kërkoja që të kalojmë te pjesa, pas redaktimit  
25 ku thuhet:

1 "Ka pasur gjithashtu demonstrata kundër vendosjes së  
2 rusëve në Rahovec dhe Malishevë. Në Rahovec Administratori i  
3 ynë Mark Baskin është informuar një javë më përpara nga  
4 udhëheqësit shqiptarë se 'në qoftë se stacionohen rusët ata  
5 gjithë do të dërgohen do të nisen për në Shqipëri'.  
6 Shqetësimet sa i takon vendosjes së trupave ruse në veçanti në  
7 Rahovec ishin raporte të pakonfirmuara që lidheshin me disa  
8 krime kundër shqiptarë në mars dhe në qershor të vitit 1999 në  
9 periudhën që quhej ndryshe mercenarët rusë që funksionin në  
10 atë kohë. Jemi raportuar në mënyrë konfidenciale nga Gjenerali  
11 Jackson që ka ende negociata në vijim e sipër sa i takon  
12 vendosjes së këtyre trupave".

13 Data e kësaj memoje është 14 korrik 1999. Pyetja që kam  
14 për ju dëshmitar është në qoftë se keni dijeni për vendosjen e  
15 forcave ruse në zona që populloheshin nga shqiptarët e  
16 Kosovës?

17 PË. Po, jam në dijeni të kësaj gjëje. Rusia bëri goxha grusht  
18 sa i takon futjes së trupave të NATO-s në Shqipëri dhe në  
19 Maqedoni. Domethënë, trupat e NATO-s që erdhën nga Shqipëria  
20 dhe Maqedonia ose Maqedonia e Veriut, sot e kësaj dite. Ata  
21 transportojnë disa prej trupave të tyre në Kosovë, në  
22 Prishtinë më konkretisht, por gjithashtu edhe në zonën e  
23 aeroportit, pra, në aeroportin e Prishtinës. Më pas ka pas  
24 negociata në vijim e sipër të vazhdueshme sa i takon  
25 dislokimit ose vendosjes së tyre apo që të dërgoheshin ata nga

Dëshmitari: Jan Kickert (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 131

1 aeroporti në mënyrë të tillë që të kishin kontroll në aeroport  
2 dhe mbaj mend që ka pasur goxha debate sa i takon vendosjes së  
3 tyre, dislokimit të tyre, domethënë, ideja ishte që ata mund  
4 të vendoseshin në zona ku ka pasur popullsi shqiptare, por në  
5 ato zona të cilat ku ka pasur konflikte dhe ka pasur masakra,  
6 dhe ka pasur goxha fërkime në vitet 1998, 1999.

7 PY. Në rregull. Atëherë i takon që ka pasur goxha rezistencë  
8 etnike nga shqiptarët sa i takon dislokimit të tyre në Kosovë,  
9 apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Po, e saktë.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani kalojmë te prova materiale  
12 P1229.

13 PY. Ky është një kabllogram që mban datën 17 korrik 1999.  
14 Këtu diskutohet takimi i 16 korrikut duhet të ishte 1999,  
15 pavarësisht që është shkruar 16 qershor 1999.

16 Këtu diskutohet për një takim të Këshillit të Përkohshëm  
17 të Kosovës. Na e tregoni pak ju lutem çfarë është ky Këshill?

18 PË. Për procesverbal më lejoni t'ju them që në korrik unë nuk  
19 kam punuar për UNMIK-un. Megjithatë, kisha marrëdhënie me  
20 Këshillin Tranzitor ose të Përkohshëm të Kosovës dhe ideja e  
21 këtij Këshilli ishte që të gjithë aktorë të ndryshëm të mund  
22 të mblidheshin së bashku, politikë, por gjithashtu persona të  
23 pavarur apo etni të ndryshme të cilat jetonin në Kosovë. Dhe  
24 qëllimi kryesor i këtij Këshilli të Përkohshëm të Kosovës ka  
25 qenë që në njëfarë mënyre të krijonte një lloj normalizimi, sa

1 i takon mbërritjes së UNMIK-ut dhe përpjekjeve të tij për  
2 stabilizimin e situatës. Dhe ky Këshill kishte qëllim po ashtu  
3 që të transformonte këtë organ në një fazë më të vonshme në  
4 një institucion ku mund të kishte një lloj bashkëpronësie të  
5 administratës së Kosovës.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë te faqja 4 e këtij  
7 dokumenti.

8 PY. A mund të na thoni se kush është Artemija?

9 PË. Është ortodoks, është personi që ka marrë pjesë në ato  
10 biseda.

11 PY. Këtu thuhet:

12 "Pjesa kryesore e anëtarëve kanë bërë deklaratë në parim.  
13 Artemije theksoi që pjesa më e madhe e krimeve dhe akteve të  
14 dhunës janë kryer kundër serbëve dhe joshqiptarëve të tjerë.  
15 Ai bëri thirrje UÇK-së dhe në veçanti Thaçit që të mund të  
16 përfundonte një praktikë të tillë. Thaçi u përgjigj që ai  
17 kishte bërë deklaratë të forta, duke e distancuar veten nga  
18 krime kundër joshqiptarëve. Këtë gjë ai e kishte bërë nën  
19 presion të madh, ndërkohë që kishte mbi 6 500 apo 7 000  
20 shqiptarë të burgosur politik shqiptarë që ende ishin në  
21 Serbi".

22 A ju kujtohet që kjo të ishte problem i diskutuar në  
23 verën e 1998-s që kishte mijëra shqiptarë politikë, domethënë,  
24 të burgosur politik shqiptarë që ishin në Serbi?

25 PË. Shifrat nuk i caktoj dot, por di të them që kishte shumë

1 të burgosur politik shqiptarë në Serbi, përfshirë këtu dhe  
2 Albin Kurtin që është aktualisht lider kryesor në Kosovë dhe  
3 që ka qenë drejtues-student dhe ka qenë gjithashtu dhe  
4 ndihmësi i Adem Demaçit.

5 PY. Le të kalojmë te pika tjetër e këtij dokumenti. Atëherë  
6 z. Kouchner i falënderon të gjithë për deklaratat e tyre.

7 Pastaj vazhdon më tej:

8 "Është e rëndësishme që të pajtohemi për masa konkrete  
9 për përmirësimin e situatës. Ai propozon që udhëheqësit serbë  
10 dhe shqiptarë...".

11 Dhe pastaj pika e tretë është:

12 "... së bashku me SRSG-në, duhet që të paraqiteshin në  
13 radio dhe në televizion në mënyrë të tillë që të bënin thirrje  
14 për t'i dhënë fund dhunës".

15 PË. Po e shoh.

16 PY. Kjo ishte takim i datës 16 ashtu siç e pamë. Ndërkohë që  
17 me datën 14 ka pas këtë problem, ke pasur problemin që  
18 diskutuam në Rahovec me dislokimin e forcave ruse. Tani do  
19 t'ju tregoj një video të udhëtimit të z. Thaçit një ditë më  
20 pas në Rahovec.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal është dokumenti  
22 1D124. Ju lutem me zë, nëse është e mundur.

23 [Luhet videoincizimi]

24 PËRKTHYESI: "Qyteti juaj ashtu siç ka ditur vazhdimisht,  
25 do të dijë edhe sot të ndajë të mirën, të ndajë të keqen, të

1 ndajë atë të cilën nuk është e gatshme, nuk është e  
2 respektueshme për orientimet tona për të ardhmen. Megjithatë  
3 sot e kemi një kohë ashtu siç e kemi respektuar ne vazhdimisht  
4 për realitetet e reja të krijuara që të mos mendojmë shumë për  
5 hakmarrje, për urrejtje, për ndasi. Sot është kohë bashkimi  
6 dhe në këtë bashkim duhet të luajmë rolin secilin nga ne, në  
7 dashtë qytetari, politikani, dhe të gjitha shtresat popullore  
8 pa dallim përcaktimi politik, ideologjie, krahine, feje apo  
9 ndonjë përcaktimi tjetër. Ne duhet të jemi ata që si kurrë  
10 ndonjëherë në parë të bashkohemi rreth unitetit për pavarësinë  
11 e Kosovës.

12 Ne nuk kemi nevojë për qytet etnik; kemi nevojë t'i  
13 respektojmë të gjitha ata të cilët dëshirojnë të jetojnë në  
14 qytet, por si qytetarë të lirë, si qytetarë që respektojnë  
15 rregullin, rendin, si qytetarë të cilët nuk mendojnë për  
16 konfrontim, si qytetarë të cilët nuk kanë marrë pjesë në  
17 masakrat mbi vëllezërit tonë, mbi motrat tona, mbi prindërit  
18 tonë. Ne do t'i respektojmë të gjithë ata që meritojnë të  
19 respektohen, por nuk do të lejojmë që askush kriminelët në  
20 qytetin e Rahovecit t'i merr në mbrojtje.

21 Nuk do të lejojmë gjithashtu anarki në qytet; nuk do të  
22 lejojmë anarki; nuk do të lejojmë asnjë frymë tejet tolerancës  
23 në Kosovës, sepse ne ashtu siç kemi treguar shpeshherë do të  
24 tregojmë përsëri se ne jemi ata që kemi respektuar dhe  
25 respektojmë rregullat, rendin demokratik ashtu siç kemi

1 respektuar ne do të respektojmë përsëri".

2 Z. MISETIC: [Përkthim]

3 PY. Atëherë, Dëshmitar, para pak çastesh ju thatë që jeni në  
4 dijeni të deklaratave që ka bërë z. Thaçi lidhur me krimet dhe  
5 se këto kanë qenë në pajtim me politikat e tij. A ju kujtohet  
6 që keni thënë këtë gjë?

7 PË. Po.

8 PY. A është kjo video që sapo pamë në pajtim me atë çfarë  
9 keni kuptuar ju që të ketë qenë qëndrimi i z. Thaçi atëherë?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe politikat e tij kanë të bëjnë me të drejtat e  
12 joshqiptarëve për të jetuar në Kosovë, domethënë, etnitë e  
13 tjera joshqiptare që jetonin në Kosovë, apo jo?

14 PË. Po. Problemi ishte që atëherë nuk ekzistonte një sistem  
15 gjyqësor, kështu që ai përmendte që ata që nuk kanë kryer  
16 krime, ata nuk, domethënë, që duhet që të vazhdonin që të  
17 qëndronin aty. Por ky ishte problem sepse UNMIK-u nuk kishte  
18 kapacitete, nuk kishte strukturë, nuk kishte gjyqësor në  
19 mënyrë të tillë që të ndiqte akuzat e krimeve të luftës në atë  
20 kohë.

21 PY. Kush kishte të drejtë për të hetuar dhe për të ndjekur  
22 penalisht krimet e luftës?

23 PË. Duhej të ishin strukturat të cilat krijoheshin, duhet të  
24 krijoheshin nga UNMIK-u.

25 PY. A kishte një arsye se pse UNMIK-u nuk e krijoi këtë

1 strukturë asnjëherë?

2 PË. Sepse ishte shumë i zënë UNMIK-u. Kombet e Bashkuara  
3 asnjëherë nuk kanë bërë administrimin e territorit. Ndërkohë  
4 që procesi ishte goxha i ngadaltë. Për shembull, kam përmendur  
5 më herët fushën e arsimit dhe e vërteta është që Kombet e  
6 Bashkuara ishin tërësisht të papërgatitura për këtë mision.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Le të shohim një tjetër dokument.  
8 SITF40000042 deri në 40000043. Është një kabllogram që mban  
9 datën 26 korrik 1999. Është një raport politik që është  
10 dërguar nga z. Kouchner tek Kombet e Bashkuara në Shtetet e  
11 Bashkuara lidhur me ngjarjet nga 19 deri në 26 korrik. Ju  
12 lutem kalojmë te faqja 2 e këtij dokumenti. Paragrafi i  
13 fundit.

14 PY. Titulli i këtij nënseksioni është "... por të gjithë  
15 bashkëpunimet midis Serbisë dhe shqiptarëve, serbëve dhe  
16 shqiptarëve janë pezull për shkak të masakrës në Gracko".

17 A keni dëgjuar për këtë masakër, Dëshmitar?

18 PË. Po, kjo është një masakër ku fermerë ose bujq serbë që po  
19 merreshin me bujqësi janë vrarë. Bëhet fjalë për një numër të  
20 konsiderueshëm serbësh; nuk më kujtohet tani, por besoj kanë  
21 qenë diku 14.

22 PY. Po, ndërkohë që në këtë paragraf thuhet më tej si më  
23 poshtë:

24 "Masa të tjera për mbrojtjen e godinave në veçanti në  
25 vizitat e përbashkëta serbë, ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve



1 në Gjilan dhe Mitrovicë si dhe takimin tjetër të radhës së  
2 Këshillit të Përkohshëm të Kosovës, planifikuar me datë 26  
3 korrik, u anuluan nga serbët pas masakrës së 14 serbëve në  
4 Gracko. Në jug të Prishtinës më datë 23 korrik. Ndërkohë që  
5 SRSG-ja së bashku me Artemijen vizituan familjet e viktimave  
6 më datë 24 korrik. Grupi premtoi që personalisht do përfshihej  
7 në hetimi. Ai theksoi që komuniteti ose bashkësia  
8 ndërkombëtare nuk e kishte çliruar Kosovën që të jepte një  
9 ombrellë ose të krijonte një ombrellë për krimet kundër  
10 civilëve të pafajshëm. Z. Thaçi dhe Gjenerali Çeku nga UÇK-ja  
11 të dy u distancuan nga një krim i tillë dhe ofruan ndihmën e  
12 tyre në hetimet. Gracko mund të ishte një përpjekje ose mund  
13 të ishte një rast që mund të hidhte në erë përpjekjet e UNMIK-  
14 ut për të krijuar një klimë sigurie dhe bashkëpunimi ndërmjet  
15 bashkësive të ndryshme kombëtare. Është e rëndësishëm që  
16 serbët të mbahen parasysh. Përndryshe ekstremistët do të  
17 arrinin objektivat e tyre".

18 Dëshmitar, ju jeni bërë pjesë e UNMIK-ut pak kohë pasi ka  
19 ndodhur ky incident, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. A jeni ju të informuar ose a jeni në dijeni të ndikimit  
22 që ka pasur ky incident mbi marrëdhëniet midis serbëve dhe  
23 shqiptarëve?

24 PË. Po.

